VENDIM
Nr. 317, datë 2.6.2021

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun I, të vendimit nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 17 shtohen pikat 18 dhe 19, me këtë përmbajtje:

"18. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2013/184, "Për vendosjen e masave kufizuese ndaj Mianmarit/Birmanisë", të ndryshuar, sipas aneksit 18.

19. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2011/235, "Për vendosjen e masave kufizuese kundër personave dhe entiteteve të caktuara, në kuadër të situatës në Iran", të ndryshuar, sipas aneksit 19.".

2. Pas aneksit 17, bashkëlidhur vendimit, shtohen anekset 18 dhe 19, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohen institucionet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 18

VENDIMI I KËSHILLIT 2013/184/PPJS
i datës 22 prill 2013
për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,
Meqë:

(1) Më 26 prill 2010, Këshilli miratoi Vendimin 2010/235/PPJS që ripërtëriu masat shtrënguese ndaj Burmës/ Mianmarit. ([1])

(2) Në funksion të zhvillimeve në Mianmar/Burma dhe si mjet për të nxitur vijimin e ndryshimeve pozitive, të gjitha masat shtrënguese duhet të hiqen me përjashtim të embargos së armëve dhe embargos së pajisjeve që mund të përdoren për shtypje të brendshme.

(3) Vendimi 2010/232/PPJS duhet të shfuqizohet.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

1. Shitja, furnizimi, transferimi apo eksporti i armëve dhe materialeve përkatëse të të gjitha llojeve, përfshirë armët dhe municionet, automjetet dhe pajisjet ushtarake, pajisjet paramilitare dhe pjesët e këmbimit për sa më sipër, si edhe të pajisjeve që mund të përdoren për shtypje të brendshme, në drejtim të Mianmarit/Burmës nga shtetas të Shteteve Anëtare ose nga territoret e Shteteve Anëtare, ose duke përdorur anije ose aeroplanë me flamur të tyre, ndalohet pavarësisht nëse origjinojnë apo jo në territorin e tyre.

2. Ndalohen edhe aktivitetet më poshtë:

(a) dhënia e asistencës teknike, shërbimeve të ndërmjetësimit dhe shërbimeve të tjera që lidhen me aktivitetet ushtarake dhe me ofrimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e armëve dhe materialeve përkatëse të çdo lloji, përfshirë armët dhe municionet, automjetet dhe pajisjet ushtarake, pajisjet paramilitare dhe pjesët e këmbimit për sa më sipër, si edhe të pajisjeve që mund të përdoren për shtypje të brendshme, drejtpërdrejt ose tërthorazi në drejtim të çdo personi fizik apo juridik, subjekti apo organi që ndodhet apo synon t'i përdorë në Mianmar/Burma;

(b) dhënia e financimit ose asistencës financiare në lidhje me aktivitetet ushtarake, duke përfshirë në veçanti grantet, huat dhe sigurim të kreditit të eksportit për çdo shitje, furnizim, transferim ose eksport të armëve dhe materialeve përkatëse, si edhe të pajisjeve që mund të përdoren për shtypje të brendshme, ose për dhënien e asistencës teknike përkatëse, shërbimeve të ndërmjetësimit dhe shërbimeve të tjera, drejtpërdrejt ose tërthorazi në drejtim të çdo personi, subjekti apo organi që ndodhet apo synon t'i përdorë në Mianmar/Burma;

(c) pjesëmarrja me vetëdije dhe qëllimisht në aktivitete objekti apo efekti i të cilave është anashkalimi i ndalimeve të përcaktuara në germat (a) ose (b).

Neni 2

1. Neni 1 nuk zbatohet për aktivitetet më poshtë:

(a) shitja, furnizimi, transferimi apo eksporti i pajisjeve ushtarake jovdekjeprurëse, apo i pajisjeve që mund të përdoren shtypje të brendshme, të destinuara vetëm për përdorim humanitar ose mbrojtës, apo për programe forcimi institucional të OKB-së dhe BE-së, apo i materialeve të destinuar për operacionet e menaxhimit të krizave nga BE-ja dhe OKB-ja.

(b) shitja, furnizimi, transferimi apo eksporti i pajisjeve të çminimit dhe i materialeve të destinuara për përdorim në operacionet e çminimit.

(c) dhënia e financimit dhe asistencës financiare lidhur me pajisje të tilla apo me programe ose operacione të tilla;

[1] OZ L 105, 27.04.2010, fq. 22.

(d) dhënia e asistencës teknike lidhur me pajisje të tilla apo me programe ose operacione të tilla,

me kusht që eksporte të tilla të jenë miratuar paraprakisht nga autoriteti përgjegjës përkatës.

2. Neni i nuk zbatohet për veshjet mbrojtëse, përfshirë xhaketat *flak* dhe helmetat ushtarake, që eksportohen përkohësisht në Mianmar/Burma nga personeli i OKB-së, personeli i BE-së apo i Shteteve Anëtare të saj, përfaqësues të medias dhe punonjës humanitarë dhe zhvillimit si dhe personeli shoqërues i tyre, vetëm për përdorimin e tyre personal;

Neni 3

Ky Vendim zbatohet deri më 30 prill 2014 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

Neni 4

Vendimi 2010/232/PPJS shfuqizohet.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Miratuar në Luksemburg, më 22 prill 2013.

Për Këshillin
Presidenti
C. ASHTON

VENDIMI I KËSHILLIT 2014/214/PPJS
i datës 14 prill 2014
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS. [1]

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2013/184/PPJS, masat shtrënguese duhet të ripërtërihen deri më 30 prill 2015.

(3) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2013/184/PPJS ndryshohet si vijon:

Neni 3 zëvendësohet me formulimin si më poshtë:

"Neni 3
Ky Vendim zbatohet deri më 30 prill 2015 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Luksemburg, më 14 prill 2014.

Për Këshillin
Presidenti
C. ASHTON

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ) L 111, 23.4.2013, fq. 75.

VENDIMI I KËSHILLIT 2015/666/PPJS
i datës 28 prill 2015
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Më 14 prill 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/214/PPJS ([2]) që ripërtërin masat shtrënguese deri më 30 prill 2015.

(3) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2013/184/PPJS, masat shtrënguese duhet të ripërtërihen deri më 30 prill 2016.

(4) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Neni 3 i Vendimit 2013/184/PPJS zëvendësohet me formulimin si më poshtë:

"Neni 3
Ky Vendim zbatohet deri më 30 prill 2016 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 28 prill 2015.

Për Këshillin
Presidenti
E. RINKEVIČ

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ) L 111, 23.4.2013, fq. 75.
[2] Vendimi 2014/214/PPJS i datës 14 prill 2014 që ndryshon vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës (GZ L 111, 15.4.2014, fq. 84).

VENDIMI I KËSHILLIT 2016/627/PPJS
i datës 21 prill 2016
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Larë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Më 28 prill 2015, Këshilli miratoi Vendimin (PPJS) 2015/666 ([2]) që ripërtërin masat shtrënguese deri më 30 prill 2016.

(3) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2013/184/PPJS, masat shtrënguese duhet të ripërtërihen deri më 30 prill 2017.

(4) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Neni 3 i Vendimit 2013/184/PPJS zëvendësohet me formulimin si më poshtë:

> "Neni 3
> Ky Vendim zbatohet deri më 30 prill 2017 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur".

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Luksemburg, më 21 prill 2016.

Për Këshillin
Presidenti
G.A. VAN DER STEUR

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ) L 111, 23.4.2013, fq. 75.
[2] Vendimi (PPJS) 2015/666 i datës 28 prill 2015 që ndryshon vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës (GZ L 111, 29.4.2014, fq. 14).

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2017/734
i datës 25 prill 2017
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Larte të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Më 21 prill 2016, Këshilli miratoi Vendimin (PPJS) 2016/627 ([2]) që ripërtërin masat shtrënguese deri më 30 prill 2017.

(3) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2013/184/PPJS, masat shtrënguese duhet të ripërtërihen deri më 30 prill 2018.

(4) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Neni 3 i Vendimit 2013/184/PPJS zëvendësohet me formulimin si më poshtë:

> "Neni 3
> Ky Vendim zbatohet deri më 30 prill 2018 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur".

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Luksemburg, më 25 prill 2017.

Për Këshillin
Presidenti
I. BORG

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ) L 111, 23.4.2013, fq. 75.
[2] Vendimi (PPJS) 2016/627 i datës 21 prill 2016 që ndryshon vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës (GZ L 106, 22.4.2016, fq. 23).

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2018/655
i datës 26 prill 2018
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS [1] për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Më 26 shkurt 2018, Këshilli miratoi përfundimet ku dënon shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në mënyrë të vazhdueshme, të përhapur dhe sistematike të kryera nga forcat ushtarake dhe të sigurisë të Mianmarit/Burmës dhe i bën thirrje qeverisë së Mianmarit/Burmës dhe forcave të sigurisë që të garantojnë sigurinë, shtetin e së drejtës dhe llogaridhënien në shtetet Rakhine, Kachin dhe Shan. Përfundimet konfirmuan rëndësinë e embargos ekzistuese për armët dhe pajisjet që mund të përdoren për shtypje të brendshme dhe miratuan ripërtëritjen e këtyre masave shtrënguese. Gjithashtu, Këshilli bëri thirrje për masa konkrete për forcimin e embargos aktuale dhe propozime për masa të shënjestruara kundër oficerëve të lartë ushtarakë të forcave të armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) që janë përgjegjës për shkelje të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut.

(3) Në këto rrethana, është e përshtatshme t'i vendosen masa të mëtejshme shtrënguese Mianmarit/Burmës në formën e ndalimit të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë për përdoruesit fundorë ushtarakë dhe për Policinë e Rojës Kufitare, kufizime për eksportin e pajisjeve që shërbejnë për monitorimin e komunikimeve të cilat mund të përdoren për shtypje të brendshme, si edhe për trajnimet ushtarake dhe bashkëpunimin ushtarak.

(4) Për më tepër, masat shtrënguese të shënjestruara duhet të vendosen ndaj personave fizikë të caktuar nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, për shembull për nxitje të dhunës, për diskriminim dhe dhunë ndaj personave që u përkasin pakicave në Rakhine dhe për pengimin e kthimit vullnetar dhe të sigurt të personave të zhvendosur nga shteti Rakhine për në vendin e tyre të origjinës, si edhe ndaj personave, subjekteve apo organeve që kanë të bëjnë me to. Masat shtrënguese të shënjestruara duhet të vendosen edhe ndaj disa personave fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për pengimin e asistencës humanitare për civilët në nevojë, apo përgjegjës për pengimin e hetimeve të pavarura për abuzime apo shkelje të rënda të pretenduara të të drejtave të njeriut, si edhe ndaj personave, subjekteve apo organeve që kanë të bëjnë me to.

(5) Nuk duhet të pengohet kalimi i asistencës humanitare për civilët në nevojë, objekt i kontrollit të palëve në konflikt dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare humanitare. Prandaj, është e përshtatshme të zbatohen kufizime ndaj personave fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) që janë përgjegjës për pengimin e kalimit të shpejtë dhe pa pengesa të asistencës humanitare për civilët në nevojë. Këto kufizime nuk duhet të cenojnë pa shkak ofrimin e asistencës humanitare dhe duhet të zbatohen në respekt të plotë të legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe rregullat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

(6) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRËTON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2013/184/PPJS ndryshohet si vijon:
(1) formulimi më poshtë shtohet para nenit 1:

"KREU I
KUFIZIMET NË EKSPORT

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ L 111, 23.4.2013, fq. 75).

(2) Neni me formulimit më poshtë shtohet:

"Neni 1a

1. Shitja, furnizimi, transferimi apo eksporti direkt apo indirekt i çdo malli dhe teknologjie me përdorim të dyfishtë të listuar në Shtojcën I të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 428/2009 [2] për përdorim ushtarak në Mianmar /Burma, apo për çdo përdorues fundor ushtarak apo për Policinë e Rojës Kufitare në Mianmar /Burma nga shtetas të Shteteve Anëtare ose nga territoret e Shteteve Anëtare apo anijeve dhe avionëve që mbajnë flamurin e tyre, ndalohet pavarësisht nëse origjinojnë nga territoret e tyre.

2. Ndalohen aktivitetet e mëposhtme:

(a) dhënia e asistencës teknike, shërbimeve të ndërmjetësimit dhe shërbimeve të tjera që lidhen me mallra dhe teknologji të përcaktuara në pikën 1 dhe me ofrimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e këtyre mallrave dhe teknologjive, drejtpërdrejtë apo tërthorazi në drejtim të çdo përdoruesi fundor ushtarak apo Policisë së Rojës Kufitare në Mianmar/Burma, ose për përdorim ushtarak në Mianmar /Burma;

(b) dhënia e financimit ose asistencës financiare që lidhen me mallra dhe teknologji të përcaktuara në pikën 1, duke përfshirë në veçanti grantet, huat dhe sigurim të kreditit të eksportit për çdo shitje, furnizim, transferim ose eksport të këtyre mallrave dhe teknologjive, ose me dhënien e asistencës teknike përkatëse, shërbimeve të ndërmjetësimit dhe shërbimeve të tjera, drejtpërdrejt ose tërthorazi në drejtim të çdo përdoruesi fundor ushtarak apo Policisë së Rojës Kufitare në Mianmar/Burma, ose për përdorim ushtarak në Mianmar /Burma;

3. Ndalimi në pikat 1 dhe 2 nuk cenon ekzekutimin e kontratave të lidhura para 27 prillit 2018 apo të kontratave mbështetëse të nevojshme për ekzekutimin e kontratave të tilla.

(3) Neni 2 zëvendësohet me formulimin më poshtë:

1. Neni 1 nuk zbatohet për aktivitetet më poshtë:

(a) shitja, furnizimi, transferimi apo eksporti i pajisjeve ushtarake jovdekjeprurëse, apo i pajisjeve që mund të përdoren shtypje të brendshme të listuara në Shtojcën I të Rregullores (KE) 428/2009, të destinuara vetëm për përdorim humanitar ose mbrojtës, apo për programe forcimi institucional të OKB-së dhe BE-së, apo i materialeve të destinuar për operacionet e menaxhimit të krizave nga BE-ja dhe OKB-ja.

(b) shitja, furnizimi, transferimi apo eksporti i pajisjeve të çminimit dhe i materialeve të destinuara për përdorim në operacionet e çminimit.

(c) dhënia e financimit dhe asistencës financiare lidhur me pajisje të tilla apo me programe ose operacione të tilla;

(d) dhënia e asistencës teknike lidhur me pajisje të tilla apo me programe ose operacione të tilla,

me kusht që eksporte të tilla të jenë miratuar paraprakisht nga autoriteti përgjegjës përkatës.

2. Nenet 1 dhe 1a nuk zbatohen për veshjet mbrojtëse, përfshirë xhaketat *flak* dhe helmetat ushtarake, që eksportohen përkohësisht në Mianmar/Burma nga personeli i OKB-së, personeli i BE-së apo i Shteteve Anëtare të saj, përfaqësues të medias dhe punonjës humanitarë dhe zhvillimit si dhe personeli shoqërues i tyre, vetëm për përdorimin e tyre personal;

(4) Neni 3 zëvendësohet nga formulimi më poshtë:

"Neni 3

Ndalohet shitja, furnizimi, transferimi, apo eksporti i pajisjeve dhe softuerëve që synohen të përdoren ekskluzivisht nga qeveria e Mianmarit/Burmës apo në emër të saj për monitorimin apo përgjimin e internetit dhe komunikimeve telefonike celulare apo fikse në Mianmar/Burma, përfshirë dhënien e asistencës financiare dhe teknike për

---

[2] Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 428/2009 e datës 5 maj 2009 që vendos një regjim Komunitar për kontrollin e eksporteve, transferimeve, ndërmjetësimeve dhe transitit të mallrave me përdorim të dyfishtë (GZ L 134, 29.5.2009, fq. 1).

instalimin, operimin apo përditësimin e pajisjeve, softuerëve apo teknologjive të tilla, nga shtetas të Shteteve Anëtare ose nga territoret e Shteteve Anëtare.

2. Me shmangie nga pika 1, Shtetet Anëtare mund të autorizojnë shitjen, furnizimin, transferimin apo eksportin e pajisjeve, teknologjive apo softuerëve, përfshirë dhënien e shërbimeve të telekomunikimit apo monitorimit të internetit dhe përgjimit të çfarëdo lloji, si edhe dhënien e asistencën financiare dhe teknike lidhur me to, referuar në pikën 1, nëse kanë shkaqe të arsyeshme për të konstatuar se këto pajisje, teknologji apo softuerë nuk do të përdoren për shtypje të brendshme nga qeveria e Mianmarit/Burmës, organet publike, korporatat dhe agjencitë, apo çdo person apo subjekt që vepron në emër të tyre ose në drejtim të tyre.

Shtetet Anëtare në fjalë informojnë Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin për çdo autorizim të dhënë sipas kësaj pike, brenda katër javësh nga dhënia e autorizimit.

Neni 3

3. Bashkimi Evropian merr masat e nevojshme për të përcaktuar elementët përkatës për të cilat gjen zbatim ky nen".;

(5) Shtohen nenet dhe krerët si vijon:

"KREU II

KUFIZIMET PËR TRAJNIMET USHTARAKE DHE BASHKËPUNIMIN USHTARAK

Neni 4

1. Ndalohet ofrimi i trajnimit ushtarak apo bashkëpunimi ushtarak me Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policinë e Rojës Kufitare.

2. Ndalimi në pikën 1 nuk zbatohet për trajnimin apo bashkëpunimin që synon të forcojë parimet demokratike, shtetin e së drejtës apo respektimin e të drejtës ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në Mianmar/Burma.

KREU III

KUFIZIMET PËR PRANIMIN

Neni 5

1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen apo kalimin transit në territorin e tyre për:

(a) personat fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tadmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Mianmar/Burma;

(b) personat fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tadmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për pengimin e dhënies së asistencës humanitare civilëve në nevojë;

(c) personat fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tadmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për pengimin e hetimeve të pavarura për shkeljet dhe abuzimet e pretenduara me të drejtat e njeriut; ose

(d) personat fizikë që kanë lidhje me personat fizikë të përcaktuar në germat (a), (b) dhe (c),

siç renditen në Shtojcë.

2. Pika 1 nuk detyron një Shtet Anëtar të refuzojë hyrjen e shtetasve të tyre në territorin e vet.

3. Pika 1 nuk cenon rastet kur një Shtet Anëtar ka një detyrim në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, konkretisht:

(a) si vend pritës i një organizate ndërkombëtare ndërqeveritare;

(b) si vend pritës i një konference ndërkombëtare të thirrur nga, ose nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara;

(c) sipas një marrëveshjeje shumëpalëshe që jep privilegje dhe imunitete; ose

(d) në përputhje me Traktatin e Pajtimit të vitit 1929 (Pakti i Lateranit) i nënshkruar nga Selia e Shenjtë (Qytet-Shteti i Vatikanit) dhe Italia.

4. Pika 3 gjen zbatim edhe në rastet kur një Shtet Anëtar është vend pritës i Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE).

5. Këshilli informohet rregullisht në të gjitha rastet kur një Shtet Anëtar jep një përjashtim sipas pikës 3 ose 4.

6. Shtetet Anëtare mund të japin përjashtime nga masat e vendosura sipas pikës 1, kur udhëtimi justifikohet për arsye të një nevoje urgjente humanitare, ose për shkak të pjesëmarrjes në takime ndërqeveritare ose takime të promovuara ose të organizuara nga BE-ja apo të pritura nga një Shtet Anëtar që mban kryesimin e OSBE-së, ku zhvillohet një dialog politik që promovon drejtpërdrejt objektivat e masave shtrënguese, përfshirë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në Mianmar/Burma.

7. Një Shtet Anëtar që dëshiron të japë përjashtime sipas pikës 6, njofton Këshillin me shkrim. Përjashtimi konsiderohet i dhënë përveçse nëse një ose më shumë anëtarë të Këshillit ngrenë një kundërshtim me shkrim brenda dy ditëve pune nga marrja e njoftimit për përjashtimin e propozuar. Nëse një ose më shumë anëtarë të Këshillit ngrenë një kundërshtim, Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, mund të vendosë të japë përjashtimin e propozuar.

8. Kur një Shtet Anëtar, sipas pikave 3, 4, 6 apo 7 autorizon hyrjen ose kalimin transit në territorin e vet të personave të renditur në Shtojcë, autorizimi vlen vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë dhe vetëm për personat e interesuar drejtpërdrejtë.

KREU IV
NGRIRJA E FONDEVE DHE E BURIMEVE EKONOMIKE

Neni 6

1. Të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që posedohen, zotërohen, mbahen ose kontrollohen nga:

(a) personat fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tadmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Mianmar/Burma;

(b) personat fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tadmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për pengimin e dhënies së asistencës humanitare civilëve në nevojë;

(c) personat fizikë në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tadmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për pengimin e hetimeve të pavarura për shkeljet dhe abuzimet e pretenduara me të drejtat e njeriut; ose

(d) personat fizikë që kanë lidhje me personat fizikë të përcaktuar në germat (a), (b) dhe (c),

siç renditen në Shtojcë, duhet të ngrihen.

2. Asnjë fond ose burim ekonomik nuk do të vihet në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të personave apo subjekteve të renditur në Shtojcë.

3. Autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare mund të autorizojnë lëshimin e disa fondeve ose burimeve ekonomike të ngrira, ose vënien në dispozicion të disa fondeve ose burimeve ekonomike, sipas kushteve që i konsiderojnë të përshtatshme, pasi konstatojnë se fondet ose burimet ekonomike në fjalë janë:

(a) të nevojshme për të përmbushur nevojat bazë të personave fizikë ose juridikë, subjekteve apo organeve të renditura në Shtojcë, dhe familjarëve nën përgjegjësinë e personave të tillë fizikë, duke përfshirë pagesat për ushqim, qira ose hipotekë, ilaçe dhe trajtim mjekësor, taksa, prime sigurimi dhe faturat e shërbimeve publike;

(b) të destinuara ekskluzivisht për pagimin e tarifave të arsyeshme profesionale ose rimbursimin e shpenzimeve të që lidhen me ofrimin e shërbimeve juridike;

(c) të destinuara ekskluzivisht për pagimin e tarifave të shërbimit për mbajtjen apo mirëmbajtjen rutinë të fondeve apo burimeve ekonomike të ngrira;

(d) të nevojshme për shpenzime përjashtimore, me kusht që autoriteti përgjegjës përkatës të ketë njoftuar autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare të tjera dhe Komisionin për shkaqet mbi të cilat mendon se duhet të jepet një autorizim specifik, të paktën dy javë para autorizimit; ose

(e) të paguhet në ose nga një llogari e një misioni diplomatik ose konsullor ose një organizate ndërkombëtare që gëzon imunitet sipas të drejtës ndërkombëtare, për aq sa pagesa të tilla synohet të përdoren për qëllime zyrtare të misionit diplomatik ose konsullor apo të organizatës ndërkombëtare.

Shtetet Anëtare në fjalë informojnë Shtete Anëtare të tjera dhe Komisionin për çdo autorizim të dhënë sipas kësaj pike.

4. Me shmangie nga pika 1, autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare mund të autorizojnë lëshimin e disa fondeve ose burimeve ekonomike të ngrira, kur përmbushen kushtet në vijim:

(a) fondet ose burimet ekonomike janë objekt i një kompensimi gjyqësor, administrativ apo arbitrazhi të njohur para datës në të cilën personi apo subjekti i përmendur në pikën 1 të renditej në Shtojcën I, ose i një vendimi gjyqësor, administrativ apo arbitrazhi të dhënë para asaj date;

(b) fondet ose burimet ekonomike do të përdoren ekskluzivisht për të përmbushur pretendimet e garantuara nga këto kompensime apo të njohura si të vlefshme nga një vendim i tillë, brenda kufijve të përcaktuar nga ligjet dhe aktet normative në fuqi që rregullojnë të drejtat e personave që kanë pretendime të tilla;

(c) kompensimi apo vendimi nuk është në dobi të një personi apo subjekti të renditur në Shtojcë; dhe

(d) njohja e kompensimit apo vendimit nuk është në kundërshtim me politikën publike në Shtetin Anëtar në fjalë.

Shtetet Anëtare në fjalë informojnë Shtete Anëtare të tjera dhe Komisionin për çdo autorizim të dhënë sipas kësaj pike.

5. Pika 1 nuk ndalon një person fizik apo juridik, subjekt ose organ të renditur në Shtojcë të bëjë një pagesë sipas një kontrate të lidhur apo sipas një detyrimi që ka lindur për personin fizik apo juridik, subjektin ose organ që figuron në Shtojcë para se të listohej në Shtojcë, me kusht që Shteti Anëtar në fjalë të konstatojë që pagesa nuk është në shkelje të pikës 3.

6. Pika 2 nuk zbatohet për kreditimet në llogaritë e ngrira:

(a) të interesave apo përfitimeve të tjera për shkak të këtyre llogarive;

(b) të pagesave për shkak të kontratave, marrëveshjeve ose detyrimeve që janë lidhur ose kanë lindur para datës në të cilën ato llogari janë bërë objekt i masave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2; ose

(c) të pagesave sipas vendimeve gjyqësore, administrative apo arbitrazhi që merren në BE apo që janë të ekzekutueshme në Shtetet Anëtare në fjalë,

me kusht që këto interesa, përfitime apo pagesa të mbeten objekt i masave të përcaktuar anë pikën 1.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 7

1. Këshilli, duke vepruar me unanimitet, me propozimin e një Shteti Anëtar ose të Përfaqësuesit të Lartë për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, krijon dhe ndryshon listën e përcaktuar në Shtojcë.

2. Këshilli ia njofton vendimin e përmendur në pikën 1, bashkë me shkaqet/arsyet e futjes në listë, personit fizik ose juridik, subjektit apo organit përkatës, ose drejtpërdrejt nëse dihet adresa, ose përmes shpalljes së një njoftimi, duke i dhënë personit fizik ose juridik, subjektit apo organit mundësinë që të depozitojë kundërshtime.

3. Kur depozitohen kundërshtime apo paraqiten prova të reja thelbësore, Këshilli rishikon vendimin e përcaktuar në pikën 1 dhe rrjedhimisht informon personin fizik ose juridik, subjektin apo organin përkatës.

Neni 8

1. Shtojca përfshin shkaqet për futjen në listë të personave fizikë ose juridikë, subjekteve ose organeve të përmendura në nenin 5, pika 1 dhe nenin 6, pika 1.

2. Shtojca përmban, kur është e mundur, informacionin e nevojshëm për të identifikuar personat fizikë ose juridikë, subjektet apo organet në fjalë. Në lidhje me personat fizikë, ky informacion mund të përmbajë: emrat dhe pseudonimet; datëlindjen dhe vendlindjen; shtetësinë; numrin e pasaportës dhe letërnjoftimit; gjininë; adresën, nëse dihet; dhe funksionin ose profesionin. Në lidhje me personat juridikë, subjektet ose organet, ky informacion mund të përmbajë: emrat; vendin dhe datën e regjistrimit; numrin e regjistrimit; dhe vendin e biznesit.

Neni 9

Ndalohet pjesëmarrja me vetëdije dhe qëllimisht në aktivitete objekti apo efekti i të cilave është anashkalimi i masave të përcaktuara në këtë Vendim.

Neni 10

Nuk pranohet asnjë pretendim në lidhje me ndonjë kontratë ose transaksion, përmbushja e të cilave është prekur drejtpërdrejtë apo tërthorazi, plotësisht apo pjesërisht, prej masave të vendosura sipas këtij Vendimi, përfshirë pretendime për dëmshpërblim ose ndonjë pretendim tjetër të këtij lloji, si p.sh. pretendim për kompensim ose pretendim tjetër në kuadrin e një garancie, në veçanti ato për shtyrjen apo pagimin e një detyrimi, garancie apo dëmshpërblimi, sidomos një garanci financiare apo dëmshpërblim financiar i çfarëdo forme, kur bëhen nga:

(a) persona fizikë ose juridikë, subjekte apo organe të renditura në Shtojcë;

(b) çdo person fizik ose juridik, subjekt apo organ që vepron përmes ose për llogari të njërit prej personave fizikë ose juridikë, subjekteve apo organeve të përmendura në germën (a).

Neni 11

Me qëllim maksimizimin e ndikimit të masave të përcaktuara në këtë Vendim, BE-ja inkurajon Shtetet e treta që të miratojnë masa shtrënguese të ngjashme me ato të parashikuara në këtë Vendim.

Neni 12

Ky vendim zbatohet deri më 30 prill 2019 dhe mbahet nën rishikim konstant. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur".

(6) Nenet 4 dhe 5 rinumërohen përkatësisht si nenet 13 dhe 14;

(7) Këtij Vendimi i shtohet Shtojca bashkëlidhur.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 26 prill 2018.

Për Këshillin
Presidenti
E. ZAHARIEVA

SHTOJCA

"SHTOJCA

Lista e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në nenin 5, pika 1 dhe nenin 6, pika 1".

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2018/900
i datës 25 qershor 2018
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Më 26 shkurt 2018, Këshilli miratoi përfundimet ku dënon shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në mënyrë të vazhdueshme, të përhapur dhe sistematike të kryera nga forcat ushtarake dhe të sigurisë të Mianmarit/Burmës. Përfundimet bënin thirrje për propozime për masa shtrënguese të shënjestruara ndaj ushtarakëve të lartë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw).

(3) Më 26 prill 2018, Këshilli miratoi Vendimin (PPJS) 2018/655 ([2]) që miraton një kuadër ligjor për masa shtrënguese të shënjestruara ndaj personave fizikë të caktuar në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, për pengimin e dhënies së asistencës humanitare civilëve në nevojë dhe për pengimin e hetimeve të pavarura për pretendimet për shkelje dhe abuzime të rënda me të drejtat e njeriut.

(4) Në funksion të situatës në Mianmar/Burma dhe duke pasur parasysh përgjegjësinë për shkeljet e të drejtave të njeriut nga pjesë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare, shtatë persona duhet të përfshihen në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që janë objekt i masave shtrënguese në Shtojcën e Vendimit 2013/184/PPJS.

(5) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit 2013/184/PPJS ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Luksemburg, më 25 qershor 2018.

Për Këshillin
Presidenti
F. MOGHERINI

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ L 111, 23.4.2013, fq. 75).
[2] Vendimi i Këshillit (PPJS) 2018/655 i datës 26 prill 2018 që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës (GZ L 108, 27.4.2018, fq. 29).

SHTOJCA

Personat e mëposhtëm i shtohen listës së personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve të përcakturara në Shtojcën e Vendimit 2013/184/CFSP:

	Emri	Informacioni Identifikues	Arsyet	Data e listimit
1.	Aung Kyaw Zaw	Data e lindjes: 20 gusht 1961 Pasaporta : DM000826 Data e lëshimit :22 nëntor 2011 Data e skadimit: 21 nëntor 2021 Numri Kombëtar i Identifikimit: BC 17444	Gjeneral-lejtnant Aung Kyaw Zaw është Komandant i Byrosë së Operacioneve Speciale Nr. 3 të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) nga gushti 2015 deri në fund të vitit 2017. Byroja e Operacioneve Speciale Nr. 3 mbikëqyri Komandën Perëndimore dhe, në atë kontekst, Gjeneral Lejtnant Aung Kyaw Zaw është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioza të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine nga Komanda Perëndimore gjatë asaj periudhe. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018

2.	Maung Maung Soe	Data e lindjes: Mars 1964 Numri Kombëtar i Identifikimit: Tatmadaw Kyee 19571	Gjeneral Majori Maung Maung Soe është Komandant i Komandës Përëndimore të Forcave të Armatosura të Myanmar (Tatmadaw) nga tetori 2016 deri më 10 nëntor 2017 dhe mbikëqyri operacionet ushtarake në shtetin Rakhine. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine nga Komanda Përëndimore gjatë asaj periudhe. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018
3.	Than Oo	Data e lindjes: 12 tetor 1973 Numri Kombëtar i Identifikimit: BC 25723	Gjeneral brigade Than Oo është Komandanti i Divizionit të 99-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Myanmarit (Tatmadaw). Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga Divizioni i 99-të i Këmbësorisë së Lehtë. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018

4.	Aung Aung	Numri Kombëtar i Identifikimit: BC 23750	Gjeneral brigade Aung Aung është Komandanti i Divizionit të 33-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw). Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga Divizioni i 33-të i Këmbësorisë së Lehtë. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018
5.	Khin Maung Soe		Gjeneral major Khin Maung Soe është Komandanti i Divizionit të 15-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw), nën të cilin Batalioni i Këmbësorisë Nr. 564. Në këtë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingya në shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga Divizioni i 15-të i Këmbësorisë së Lehtë, veçanërisht nga Batalioni i Këmbësorisë Nr. 564. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018
6.	Thura San Lwin	Data e lindjes: 1957	Gjeneral Brigade Thura San Lwin ishte Komandant i Policisë së Rojës Kufitare nga Tetori 2016 deri në fillim të Tetorit 2017. Në këtë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera ndaj popullatës Rohingya në shtetin Rakhine nga Policia e Rojës Kufitare gjatë kësaj periudha Këto përfshijnë vrasje të paligjshme dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018
7.	Thant Zin Oo		Thant Zin Oo është Komandanti i Batalionit të 8-të të Policisë së Sigurisë. Në këtë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga Batalioni i 8-të i Policisë së Sigurisë. Shkeljet serioze të të drejtave të njeriut përfshijnë vrasje të paligjshme dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya. Këto shkelje u kryen në bashkëpunim me dhe në mbështetje të drejtpërdrejtë të Divizionit të 33-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) të udhëhequr nga Gjeneral Brigade Aung Aung. Prandaj, Thant Zin Oo është i lidhur me personin e listuar, Gjeneral Brigade Aung Aung.	25.6.2018

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2018/1126
i datës 10 gusht 2018
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Më 25 qershor 2018, Këshilli miratoi Vendimin (PPJS) 2018/900 ([2]) që shtoi shtatë persona në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që janë objekt i masave shtrënguese në Shtojcën e Vendimit 2013/184/PPJS.

(3) Informacion i përditësuar është marrë për disa persona apo subjekte.

(4) Shtojca e Vendimit 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit 2013/184/PPJS ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 10 gusht 2018.

Për Këshillin
Presidenti
G. BLÜMEL

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ L 111, 23.4.2013, fq. 75).
[2] Vendimi i Këshillit (PPJS) 2018/900 i datës 25 qershor 2018 që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës (GZ L 160 I, 25.6.2018, fq. 9).

SHTOJCA

Hyrjet 1, 3, 4 dhe 5 në listën e personave dhe entiteteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2013/184 / CFSP zëvendësohen me shënimet e mëposhtme

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
1.	Aung Kyaw Zaw	Data e lindjes: 20 gusht 1961 Pasaporta : DM000826 Data e lëshimit :22 nëntor 2011 Data e skadimit: 21 nëntor 2021 Numri Kombëtar i Identifikimit: BC 17444	Gjeneral-lejtnant Aung Kyaw Zaw ishte Komandant i Byrosë së Operacioneve Speciale Nr. 3 të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) nga gushti 2015 deri në fund të vitit 2017. Byroja e Operacioneve Speciale Nr. 3 mbikëqyri Komandën Perëndimore dhe, në atë kontekst, Gjeneral Lejtnant Aung Kyaw Zaw është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine nga Komanda Perëndimore gjatë asaj periudhe. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018
3.	Than Oo	Data e lindjes:		25.6.2018

		12 tetor 1973 Numri Kombëtar i Identifikimit: BC 25723	Gjeneral brigade Than Oo është Komandanti i Divizionit të 99-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Myanmarit (Tatmadaw). Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga Divizioni i 99-të i Këmbësorisë së Lehtë. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	
4.	Aung Aung	Numri Kombëtar i Identifikimit: BC 23750	Gjeneral brigade Aung Aung është Komandanti i Divizionit të 33-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw). Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga Divizioni i 33-të i Këmbësorisë së Lehtë. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018
5.	Khin Maung Soe		Gjeneral majori Khin Maung Soe është Komandanti i Divizionit të 15-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw), nën të cilin Batalioni i Këmbësorisë Nr. 564. Në këtë kontekst, ai është përgjegjës për mizoritë dhe shkeljet serioze të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingya në shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga Divizioni i 15-të i Këmbësorisë së Lehtë, veçanërisht nga Batalioni i Këmbësorisë Nr. 564. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunë seksuale dhe djegie sistematike të shtëpive dhe ndërtesave Rohingya.	25.6.2018

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2018/2054
i datës 21 dhjetor 2018
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Më 26 prill 2018, Këshilli miratoi Vendimin (PPJS) 2018/655 ([2]) që miraton një kuadër ligjor për masa shtrënguese të shënjestruara ndaj personave fizikë të caktuar në Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare që janë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, për pengimin e dhënies së asistencës humanitare civilëve në nevojë dhe për pengimin e hetimeve të pavarura për pretendimet për shkelje dhe abuzime të rënda me të drejtat e njeriut.

(3) Me 25 qershor 2018, Këshilli miratoi Vendimin (PPJS) 2018/900 ([3]) që përfshiu në listë shtatë ushtarakë të lartë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare, për shkak të përfshirjes apo bashkëpunimit në mizoritë dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut ndaj popullatës Rohingya në shtetin Rakhine.

(4) Më 17 shtator 2018, Misioni Faktmbledhës i pavarur ndërkombëtar (FFM) i Këshillit të OKB-së për Të Drejtat e Njeriut publikoi raportin e hollësishëm për Mianmarin ku konstatonte se janë kryer dhunime dhe abuzime të rënda me të drejtat e njeriut në shtetet Kachin, Rakhine dhe Shan, sidomos nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policia e Rojës Kufitare dhe se shumica e shkeljeve kualifikoheshin si krime të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare.

(5) Në funksion të konstatimeve të FFM-së dhe duke pasur parasysh përgjegjësinë për shkeljet e të drejtave të njeriut nga pjesë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) dhe Policisë së Rojës Kufitare, shtatë persona duhet të përfshihen në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që janë objekt i masave shtrënguese në Shtojcën e Vendimit 2013/184/PPJS.

(6) Shtojca e Vendimit 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit 2013/184/PPJS ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 21 dhjetor 2018.

Për Këshillin
Presidenti
F. MOGHERINI

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ L 111, 23.4.2013, fq. 75).
[2] Vendimi i Këshillit (PPJS) 2018/655 i datës 26 prill 2018 që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës (GZ L 108, 27.4.2018, fq. 29).
[3] Vendimi i Këshillit (PPJS) 2018/900 i datës 25 qershor 2018 që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës (GZ L 160 I, 25.6.2018, fq. 9).

SHTOJCË

Personat e mëposhtëm shtohen në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2013/184 / CFSP:

	Emri	Informacioni Identifikues	Arsyet	Data e listimit
8.	Ba Kyaw		Ba Kyaw është një Rreshter i Stafit në Batalionin e 564-t të Këmbësorisë së Lehtë (LIB) të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Ai ka kryer mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, përfshirë vrasje, dëbime dhe tortura kundrejt popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017. Në veçanti, ai është identifikuar si një nga autorët kryesorë të Masakrës në Maung Nu më 27 Gusht 2017.	21.12.2018
9.	Tun Naing		Tun Naing është Oficeri Komandues i bazës së Policisë së Rojës Kufitare (BGP) në Taung Bazar. Në atë cilësi, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine nga ana e BGP-së në Taung Bazar përpara, gjatë dhe pas 25 Gushtit 2017, duke përfshirë ndalime të dhunshme, keqtrajtimin dhe torturën.	21.12.2018
10.	Khin Hlaing	Data e lindjes: 2 Maj 1968	Gjeneral Brigade Khin HLaing është ish-Komandanti i Divizionit të 99-të të Këmbësorisë së Lehtë (LID) dhe Komandanti aktual i Komandës Veri-Lindore të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Si Komandant i LID 99, ai mbikëqyri operacionet ushtarake të ndërmarra në Shtetin Shan në vitin 2016 dhe në fillim të vitit 2017. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe	21.12.2018

			shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër fshatarëve që i përkisnin pakicave etnike në Shtetin Shan përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 nga ana e LID 99. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, ndalimet e dhunshme dhe shkatërrimin e fshatrave.	
11.	Aung Myo Thu		Majori Aung Myo Thu është Komandant i Njësisë në Terren të Divizionit të 33-të të Këmbësorisë së Lehtë (LID) të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Në cilësinë e Komandantit të Njësisë në Terren LID 33, ai mbikëqyri operacionet ushtarake të ndërmarra në Shtetin Rakhine në 2017. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingy në Shtetin Rakhine përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 nga ana e LID 33. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunën seksuale dhe ndalimet e dhunshme.	21.12.2018
12.	Thant Zaw Win		Thant Zaw Win është një Major në Batalionin e 564-të të Këmbësorisë së Lehtë (LIB) të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Në këtë cilësi, ai mbikëqyri operacionet ushtarake të kryera në Shtetin Rakhine dhe është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut kundrejt popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine nga ana e LIB 564, veçanërisht në dhe përreth fshatit Maung Nu më 27 gusht 2017. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunën seksuale dhe djegien sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	21.12.2018
13.	Kyaw Chay		Kyaë Chay është një Tetar në Policinë e Rojes Kufitare (BGP). Më parë ai ishte i stacionuar	21.12.2018

			në Zay Di Pyin dhe ishte Oficeri Komandues i bazës së BGP-së në Zay Di Pyin gjatë periudhës rreth 25 gushtit 2017 kur një seri shkeljesh të të drejtave të njeriut janë kryer nga ana e BGP-së nën komandën e tij. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nga BGP të kryera ndaj popullsisë Rohingya në Shteti Rakhine gjatë asaj periudhe. Ai gjithashtu ka marrë pjesë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Këto shkelje përfshijnë keqtrajtimin e të ndaluarve dhe torturën.	
14.	Nyi Nyi Swe		Gjeneral Majori Nyi Nyi Swe është ish-Komandanti i Komandës Veriore të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Në atë cilësi, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në Shtetin Kachin nga maji i vitit 2016 deri në Prill 2018 (deri në emërimin e tij si Komandanti i Komandës Jug-Perëndimore) nga ana e Komandës Veriore, përfshirë keqtrajtimin e civilëve. Ai është gjithashtu përgjegjës për pengimin e sigurimit të ndihmave humanitare për civilët në nevojë në Shtetin Kachin në atë periudhë, në veçanti bllokimin e transportit të ushqimeve.	21.12.2018

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2019/678
i datës 29 prill 2019
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2013/184/PPJS, masat shtrënguese duhet të ripërtërihen deri më 30 prill 2020.

(3) Informacion i përditësuar është marrë për dy listime si edhe për të gjithë personat e listuar duhet të shënohet edhe gjinia.

(4) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2013/184/PPJS ndryshohet si vijon:

(1) Neni 12 zëvendësohet m formulimin si më poshtë:

> *"Neni 12*
> Ky Vendim zbatohet deri më 30 prill 2020 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur".

(2) Shtojca ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 29 prill 2019.

Për Këshillin
Presidenti
G. CIAMBA

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ L 111, 23.4.2013, fq. 75).

SHTOJCË

Hyrjet 1 deri në 14 në listën e personave dhe subjekteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2013/184 / CFSP zëvendësohen me shënimet e mëposhtme:

	Emri	Informacioni Identifikues	Arsyet	Data e listimit
1.	Aung Kyaw Zaw	Data e lindjes: 20 Gusht 1961 Gjinia: mashkull Nr i pasaportës: DM000826 Data e lëshimit: 22 Nëntor 2011 Data e skadencës: 21 Nëntor 2021 Numri i identifikimit Ushtarak: BC 17444	Gjeneral-Lejtnant Aung Kyaw Zaw ishte Komandant i Byrosë së Operacioneve Speciale Nr. 3 të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) nga gushti 2015 deri në fund të 2017. Byroja e Operacioneve Speciale Nr. 3 mbikëqyri Komandën Perëndimore dhe, në atë kontekst, Gjeneral-Lejtnant Aung Kyaw Zaw është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundrejt popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine nga ana e Komandës Perëndimore gjatë asaj periudhe. Këto përfshijnë akte të vrasjeve të paligjshme, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	25.06.2018
2.	Maung Maung Soe	Data e lindjes: Mars 1964 Gjinia: mashkull Numri Kombëtar i Identifikimit: Tatmadaw Kyee 19571	Gjeneral Majori Maung Maung Soe ishte Komandanti i Komandës Perëndimore të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) nga Tetor 2016 deri më 10 Nëntor 2017 dhe mbikëqyri operacionet ushtarake në Shtetin Rakhine. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundrejt popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine nga ana e Komandës Perëndimore gjatë asaj periudhe. Këto përfshijnë akte të paligjshme të vrasjeve, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	25.06.2018
3.	Than Oo	Data e lindjes: 12 Tetor 1973 Gjinia: mashkull Numri i identifikimit Ushtarak: BC 25723	Gjeneral Brigade Than Oo ishte Komandant i Divizionit të 99-të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundrejt	25.06.2018

			popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga ana e Divizionit të 99-të të Këmbësorisë së Lehtë. Këto përfshijnë akte të vrasjeve të paligjshme, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	
4.	Aung Aung	Gjinia: mashkull Numri i Identifikimit Ushtarak: BC 23750	Gjeneral Brigade Aung Aung Komandant i Divizionit të 33-të të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut kundër popullates Rohingya në Shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të 2017 nga Divizioni i 33-të i Këmbësorisë së Lehtë. Këto përfshijnë akte të vrasjeve të paligjshme, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	25.06.2018

5.	Khin Maung Soe	Data e lindjes: 1972 Gjinia: mashkull	Gjeneral Brigade Khin Maung Soe është Komandanti i Komandës 15 të Operacioneve Ushtarake, i njohur gjithashtu edhe si Divizioni i 15-të i Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), ndën të cilin përfshihet dhe Batalioni i Këmbësorisë Nr. 564. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullatës Rohingya në Shtetin Rakhine përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 nga ana e Komandës 15 të Operacioneve Ushtarake, në veçanti nga Batalioni i Këmbësorisë Nr. 564. Këto përfshijnë akte të vrasjeve të paligjshme, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	25.06.2018
6.	Thura San Lwin	Data e lindjes: 17 Mars 1959 Gjinia: mashkull	Gjeneral Brigade Thura San Lwin ishte Komandanti i Policisë së Rojës Kufitare nga Tetori 2016 deri në fillim të Tetorit 2017. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine nga ana e Policisë së Rojës Kufitare gjatë kësaj periudhe. Këto përfshijnë	25.06.2018

			akte të vrasjeve të paligjshme, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	
7.	Thant Zin Oo	Gjinia: mashkull	Thant Zin Oo është Komandanti i Batalionit 8 të Policisë së Sigurisë. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 nga ana e Batalionit 8 të Policisë së Sigurisë. Këto përfshijnë akte të vrasjeve të paligjshme, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya. Këto shkelje u kryen në bashkëpunim me dhe në mbështetje të drejtpërdrejtë të Divizionit të 33-të të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) të udhëhequr nga Gjeneral Brigade Aung Aung. Prandaj Thant Zin Oo është i lidhur me personin e listuar Gjeneral Brigade Aung Aung.	25.06.2018
8.	Ba Kyaw	Gjinia: mashkull	Ba Kyaw është një Rreshter I Stafit në Batalionin e 564-t të Këmbësorisë së Lehtë (LIB) të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Ai ka kryer mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, përfshirë vrasje, dëbime dhe tortura kundrejt popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017. Në veçanti, ai është identifikuar si një nga autorët kryesorë të Masakrës në Maung Nu më 27 Gusht 2017.	21.12.2018
9.	Tun Naing	Gjinia: mashkull	Tun Naing është Oficeri Komandues i bazës së Policisë së Rojës Kufitare (BGP) në Taung Bazar. Në atë cilësi, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine nga ana e BGP-së në Taung Bazar përpara, gjatë dhe pas 25 Gushtit 2017, duke përfshirë ndalime të dhunshme, keqtrajtimin dhe torturën.	21.12.2018
10.	Khin Hlaing	Data e lindjes: 2 Maj 1968	Gjeneral Brigade Khin HLaing është ish-Komandanti I Divizionit të 99-të të	21.12.2018

		Gjinia: mashkull	Këmbësorisë së Lehtë (LID) dhe Komandanti aktual i Komandës Veri-Lindore të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Si Komandant i LID 99, ai mbikëqyri operacionet ushtarake të ndërmarra në Shtetin Shan në vitin 2016 dhe në fillim të vitit 2017. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër fshatarëve që i përkisnin pakicave etnike në Shtetin Shan përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 nga ana e LID 99. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, ndalimet e dhunshme dhe shkatërrimin e fshatrave.	
11.	Aung Myo Thu	Gjinia: mashkull	Majori Aung Myo Thu është Komandant i Njësisë në Terren të Divizionit të 33-të të Këmbësorisë së Lehtë (LID) të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Në cilësinë e Komandantit të Njësisë në Terren LID 33, ai mbikëqyri operacionet ushtarake të ndërmarra në Shtetin Rakhine në 2017. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundër popullsisë Rohingy në Shtetin Rakhine përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 nga ana e LID 33. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunën seksuale dhe ndalimet e dhunshme.	21.12.2018
12.	Thant Zaw Win	Gjinia: mashkull	Thant Zaw Win është një Major në Batalionin e 564-të të Këmbësorisë së Lehtë (LIB) të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Në këtë cilësi, ai mbikëqyri operacionet ushtarake të kryera në Shtetin Rakhine dhe është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut kundrejt popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine nga ana e LIB 564, veçanërisht në dhe përreth fshatit Maung Nu më 27 gusht 2017. Këto përfshijnë vrasje të paligjshme, dhunën seksuale dhe djegien sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	21.12.2018

13.	Kyaw Chay	Gjinia: mashkull	Kyaw Chay është një Tetar në Policinë e Rojes Kufitare (BGP). Më parë ai ishte i stacionuar në Zay Di Pyin dhe ishte Oficeri Komandues i bazës së BGP-së në Zay Di Pyin gjatë periudhës rreth 25 gushtit 2017 kur një seri shkeljesh të të drejtave të njeriut janë kryer nga ana e BGP-së nën komandën e tij. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nga BGP të kryera ndaj popullsisë Rohingya në Shteti Rakhine gjatë asaj periudhe. Ai gjithashtu ka marrë pjesë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Këto shkelje përfshijnë keqtrajtimin e të ndaluarve dhe torturën.	21.12.2018
14.	Nyi Nyi Swe	Gjinia: mashkull	Gjeneral Majori Nyi Nyi Swe është ish-Komandanti i Komandës Veriore të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Në atë cilësi, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në Shtetin Kachin nga maji i vitit 2016 deri në Prill 2018 (deri në emërimin e tij si Komandanti i Komandës Jug-Perëndimore) nga ana e Komandës Veriore, përfshirë keqtrajtimin e civilëve. Ai është gjithashtu përgjegjës për pengimin e sigurimit të ndihmave humanitare për civilët në nevojë në Shtetin Kachin në atë periudhë, në veçanti bllokimin e transportit të ushqimeve.	21.12.2018

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2020/563
i datës 23 prill 2020
që ndryshon Vendimin 2013/184/PPJS për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/PPJS ([1]) për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës.

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2013/184/PPJS, masat shtrënguese duhet të ripërtërihen deri më 30 prill 2021.

(3) Informacion i përditësuar është marrë për një listim.

(4) Vendimi 2013/184/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2013/184/PPJS ndryshohet si vijon:

(1) Neni 12 zëvendësohet m formulimin si më poshtë:

> *"Neni 12*
> Ky Vendim zbatohet deri më 30 prill 2021 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur".

(2) Shtojca ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 23 prill 2020.

Për Këshillin
Presidenti
G. GRLIĆ-RADMAN

---

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/PPJS i datës 22 prill 2013 për masat shtrënguese ndaj Mianmarit/Burmës dhe që shfuqizon Vendimin 2010/232/PPJS (GZ L 111, 23.4.2013, fq. 75).

SHTOJCË

Hyrja 3 në listën e personave dhe entiteteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2013/184 / CFSP zëvendësohet me shënimin vijues:

	Emri	Informacioni Identifikues	Arsyet	Data e listimit
3.	Than Oo	Data e lindjes: 12 Tetor 1973 Gjinia: mashkull Numri i Identifikimit Ushtarak: BC 25723	Gjeneral Brigade Than Oo ishte Komandant i Divizionit të 99-të Këmbësorisë së Lehtë të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) deri në maj 2018. Në atë kontekst, ai është përgjegjës për mizori dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera kundrejt popullsisë Rohingya në Shtetin Rakhine në gjysmën e dytë të vitit 2017 nga ana e Divizionit të 99-të të Këmbësorisë së Lehtë. Këto përfshijnë akte të vrasjeve të paligjshme, dhunës seksuale dhe djegies sistematike të shtëpive dhe ndërtesave të popullsisë Rohingya.	25.06.2018

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2021/482

I datës 22 Mars 2021

për ndryshimin e Vendimit 2013/184/CFSP në lidhje me masat kufizuese kundrejt Mianmarit/Birmanisë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin e Bashkimit Evropian dhe, në veçanti, nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 Prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/CFSP [1] në lidhje me masat kufizuese kundrejt Mianmarit/Birmanisë.

(2) Më 22 Shkurt 2021, Këshilli miratoi konkluzione në të cilat dënoi me termat më të ashpër puçin ushtarak të kryer në Mianmar/Birmani në 1 Shkurt 2021. Ai bëri thirrje për çpërshkallëzim të krizës përmes dhënies fund në mënyrë të menjëhershme të gjendjes së jashtëzakonshme, rivendosjes së qeverisë legjitime civile dhe hapjes së parlamentit të zgjedhur rishtazi.

(3) Këshilli gjithashtu u bëri thirrje autoriteteve ushtarake të lirojnë Presidentin, Këshilltarin e Shtetit dhe të gjithë ata që janë ndaluar ose arrestuar në lidhje me grushtin e shtetit. Këshilli këmbënguli që duhet të sigurohet telekomunikacioni pa pengesa, të garantohen liria e shprehjes, shoqërimit dhe tubimit, si edhe qasja në informacion, dhe të respektohen rendi ligjor dhe të drejtat e njeriut. Ai dënoi shtypjen ushtarake dhe policore të demonstruesve paqësorë ndërsa bëri thirrje për përmbajtje maksimale nga ana e autoriteteve dhe shmangien e dhunës nga të gjitha palët, në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

(4) Përfundimet e Këshillit nënvizuan gatishmërinë e Unionit për miratimin e masave kufizuese si përgjigje ndaj puçit ushtarak.

(5) Duke marrë parasysh situatën e rëndë, Këshilli vlerëson se kriteret përcaktuese duhet të ndryshohen për të mundësuar zbatimin e masave të targetuara kufizuese kundrejt personave fizike ose juridikë, entiteteve ose organizmave aktivitetet e të cilëve cënojnë demokracinë dhe rendin ligjor në Mianmar/Birmani, si edhe personave juridikë, entiteteve ose organizmave që janë në pronësi të apo të kontrolluara nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), apo që gjenerojnë të ardhura për, japin mbështetje për apo kanë përfitime nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) dhe që kësisoj kontribuojnë në apo përfitojnë nga aktivitete të cilat cënojnë demokracinë dhe rendin ligjor ose shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Mianmar/Birmani.

(6) Duke marrë në konsideratë situatën në Mianmar/Birmani, vlerësohet me vend ndryshimi i titullit të Vendimit 2013/184/CFSP.

(7) Vendimi 2013/184/CFSP duhet kësisoj të ndryshohet përkatësisht,

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2013/184/CFSP ndryshohet siç më poshtë vijon:

(1) titulli zëvendësohet si më poshtë:

'Vendimi i Këshillit 2013/184/CFSP në lidhje me masat kufizuese referuar situatës në Mianmar/Birmani';

[1] Vendimi i Këshillit 2013/184/CFSP i datës 22 Prill 2013 në lidhje me masat kufizuese ndaj Mianmarit/Birmanisë dhe shfuqizimin e Vendimit 2010/232/CFSP (OJ L 111, 23.4.2013, f. 75).

(2) Neni 5(1) zëvendësohet me sa më poshtë vijon:

'Neni 5

1. Shtetet Anëtare do të ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen në, ose tranzitin nëpër territoret e tyre, të:

(a) personave fizikë nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), Forca e Policisë së Mianmarit dhe Policia e Rojës së Kufirit përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Mianmar/Birmani;

(b) personave fizikë veprimet, politikat apo aktivitetet e të cilëve minojnë demokracinë ose rendin ligjor në Mianmar/Birmani, ose të cilët përfshihen në, apo sigurojnë mbështetje për veprime që kërcënojnë paqen, sigurinë ose stabilitetin e Mianmarit/Birmanisë;

(c) personave fizikë nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), Forca e Policisë së Mianmarit dhe Policia e Rojës së Kufirit përgjegjës për pengimin e dhënies së ndihmës humanitare civilëve në nevojë;

(d) personave fizikë nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), Forca e Policisë së Mianmarit dhe Policia e Rojës së Kufirit përgjegjës për pengimin e kryerjes së hetimeve të pavarura për raste të ngritura të shkeljeve ose abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut; ose

(e) personave fizikë të lidhur me personat fizikë të përmendur në pikat (a) deri në (d).

sikundër listohen në Shtojcë.';

(3) Neni 6(1) zëvendësohet me sa më poshtë vijon:

'Neni 6

1. Të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që i përkasin apo janë në pronësi të, mbahen apo kontrollohen prej:

(a) personave fizikë nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nga Forca e Policisë së Mianmarit dhe nga Policia e Rojës së Kufirit përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Mianmar/Birmani;

(b) personave fizikë veprimet, politikat apo aktivitetet e të cilëve minojnë demokracinë ose rendin ligjor në Mianmar/Birmani, ose që përfshihen në, apo sigurojnë mbështetje për veprime që kërcënojnë paqen, sigurinë ose stabilitetin e Mianmarit/Birmanisë;

(c) personave fizikë nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), Forca e Policisë së Mianmarit dhe Policia e Rojës së Kufirit përgjegjës për pengimin e dhënies së ndihmës humanitare civilëve në nevojë;

(d) personave fizikë nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), Forca e Policisë së Mianmarit dhe Policia e Rojës së Kufirit përgjegjës për pengimin e kryerjes së hetimeve të pavarura për raste të ngritura të shkeljeve ose abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut;

(e) personave juridikë, entiteteve ose organizmave në pronësi të apo të kontrolluar nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), apo që gjenerojnë të ardhura për, japin mbështetje për apo përfitojnë nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*); ose

(f) personave fizikë ose juridikë, entiteteve ose organizmave që lidhen me ato të përmendur në pikat (a) deri në (e).

sikundër listohen në Shtojcë, do të ngrihen.';

(4) Neni i mëposhtëm shtohet:

'Neni 6a

1. Përmes pezullimit të neneve 6 (1) dhe (2), autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar mund të autorizojnë lirimin e fondeve të ngrira ose burimeve ekonomike të caktuara që i përkasin një personi fizik ose juridik, entiteti ose organizmi të listuar në Shtojcë, ose vënien në dispozicion të fondeve ose burimeve ekonomike të caktuara një personi fizik ose juridik, entiteti ose organizmi të renditur në Shtojcë, në rastin e plotësimit të kushteve të cilat autoritetet kompetente i vlerësojnë si të përshtatshme, pasi të kenë përcaktuar që garantimi i të tilla fondeve ose burimeve ekonomike është i nevojshëm për qëllime humanitare, si shpërndarja ose lehtësimi i shpërndarjes së ndihmës, përfshirë furnizimet mjekësore dhe ushqimin, për transferimin e punonjësve humanitarë dhe asistencës përkatëse apo për evakuime nga Mianmari/Birmania.

2. Shteti Anëtar në fjalë do të informojë Shtetet e tjera Anëtare dhe Komisionin për çdo autorizim dhënë sipas këtij Neni brenda katër javësh nga dhënia e autorizimit.'.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e botimit të tij në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Bërë në Bruksel, më 22 Mars 2021.

Për Këshillin

Presidenti

J. BORRELL FONTELLES

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2021/483

i datës 22 Mars 2021

për ndryshimin e Vendimit 2013/184/CFSP në lidhje me masat kufizuese kundrejt Mianmarit/Birmanisë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin e Bashkimit Evropian dhe, në veçanti, nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 22 Prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/CFSP ([1]) në lidhje me masat kufizuese kundrejt Mianmarit/Birmanisë.

(2) Më 22 Shkurt 2021, Këshilli miratoi konkluzione në të cilat dënoi me termat më të ashpër puçin ushtarak të kryer në Mianmar/Birmani në 1 Shkurt 2021. Ai bëri thirrje për ç-përshkallëzim të krizës përmes dhënies fund në mënyrë të menjëhershme të gjendjes së jashtëzakonshme, rivendosjes së qeverisë legjitime civile dhe hapjes së parlamentit të zgjedhur rishtazi.

(3) Këshilli gjithashtu u bëri thirrje autoriteteve ushtarake të lirojnë Presidentin, Këshilltarin e Shtetit dhe të gjithë ata që janë ndaluar ose arrestuar në lidhje me grushtin e shtetit. Këshilli këmbënguli që duhet të sigurohet telekomunikacioni pa pengesa, të garantohen liria e shprehjes, shoqërimit dhe tubimit, si edhe qasja në informacion, dhe të respektohen rendi ligjor dhe të drejtat e njeriut. Ai dënoi shtypjen ushtarake dhe policore kundër demonstruesve paqësorë ndërsa bëri thirrje për përmbajtje maksimale nga ana e autoriteteve dhe shmangien e dhunës nga të gjitha palët, në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

(4) Përfundimet e Këshillit nënvizuan gatishmërinë e Unionit për miratimin e masave kufizuese si përgjigje ndaj puçit ushtarak.

(5) Më 28 Shkurt 2021, pas goditjes së dhunshme kundër protestave paqësore në të gjithë vendin, Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dënoi shtypjen brutale dhe u bëri thirrje autoriteteve ushtarake që të ndalojnë menjëherë përdorimin e forcës kundër civilëve dhe që të lejojnë popullatën të shprehë të drejtën që ajo ka për t'u shprehur dhe tubuar lirisht.

(6) Në këtë kontekst, dhe duke marrë parasysh vazhdimin e situatës së rënduar në Mianmar/Birmani, 11 persona duhet të përfshihen në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që u nënshtrohen masave kufizuese në Shtojcën e Vendimit 2013/184/CFSP.

(7) Shtojca e Vendimit 2013/184/CFSP duhet kësisoj të ndryshohet përkatësisht,

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit 2013/184/CFSP ndryshohet siç përcaktohet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim do të hyjë në fuqi në datën e botimit në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

([1]) Vendimi i Këshillit 2013/184/CFSP i datës 22 Prill 2013 në lidhje me masat kufizuese ndaj Mianmarit/Birmanisë dhe shfuqizimin e Vendimit 2010/232/CFSP (OJ L 111, 23.4.2013, f. 75).

Bërë në Bruksel, më 22 Mars 2021.

Për Këshillin

Presidenti

J. BORRELL FONTELLES

SHTOJCA

Personat e mëposhtëm i shtohen listës së personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit 2013/184/CFSP:

	Emri	Informacioni Identifikues	Arsyet	Data e listimit
'15.	Min Aung Hlaing	Data e lindjes: 3 Korrik 1956 Vendi i lindjes: Tavoy, Mianmar/ Birmani Kombësia: Mianmar Numri Kombëtar i Identifikimit: 12 / SAKHANA (N) 20199 Gjinia: mashkull	Min Aung Hlaing është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) që nga viti 2011. Ai është Kryetar i Këshillit të Administratës Shtetërore (SAC) dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të Mbrojtjes dhe Sigurisë (NDSC). Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), të udhëhequra nga Komandanti i Përgjithshëm Min Aung Hlaing, bënë një grusht shteti në Mianmar/Birmani duke mos pranuar rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura më 8 Nëntor 2020 dhe duke përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Si pjesë e grushtit të shtetit, Zëvendës-Presidenti Myint Swe, duke vepruar në cilësi të Presidentit në Detyrë, shpalli në 1 Shkurt gjendjen e jashtëzakonshme dhe transferoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Gjeneralli i Lartë Min Aung Hlaing. Më 2 shkurt, SAC u krijua për ushtrimin e këtyre kompetencave, duke mos lejuar që qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike të përmbushë mandatin e saj. Duke përqendruar të gjitha pushtetet dhe si Kryetar i SAC, Komandanti i Përgjithshëm Min Aung Hlaing ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë dhe përgjegjës për vendime në lidhje me funksionet e shtetit dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Për më tepër, SAC miratoi vendime për kufizimin e të drejtave për lirinë e shprehjes, përfshirë qasjen në informacion, dhe tubimin paqësor. Forcat ushtarake dhe autoritetet që veprojnë nën kontrollin e SAC kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut që nga 1 Shkurt 2021, duke vrarë protestues civilë dhe të paarmatosur, duke kufizuar lirinë e tubimit dhe të shprehjes, përfshirë kufizimin e qasjes në internet, dhe përmes arrestimeve arbitrare dhe ndalimit të liderëve të opozitës dhe kundërshtarëve të grushtit të shtetit. Si Kryetar i SAC, Komandanti i Përgjithshëm Min Aung Hlaing është drejtpërdrejt përgjegjës për këto vendime represive dhe shkeljet të rënda të të drejtave të njeriut. Në vitin 2018, OKB-ja dhe gjithashtu organizata ndërkombëtare të shoqërisë civile raportuan shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në shtetet Kachin, Rakhine dhe Shan kundër popullatës Rohingya nga ana e forcave ushtarake dhe policore që nga viti 2011, dhe arritën në përfundimin se shumë nga këto shkelje përbëjnë krime nga më të rëndat sipas ligjit ndërkombëtar. Si Komandant i Përgjithshëm i *Tatmadaw* që nga viti 2011, Min Aung Hlaing është drejtpërdrejt përgjegjës për këto shkelje të rënda dhe abuzime ndaj popullatës Rohingya.	22.03.2021

16.	Myint Swe	Data e lindjes: 24 Maj 1951 Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjeneral-lejtnant Myint Swe është anëtar i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) dhe ishte Zëvendës Presidenti i emëruar nga *Tatmadaw* deri më 1 Shkurt 2021. Në atë datë, Myint Swe mori pjesë në një Takim të Këshillit Kombëtar të Mbrojtjes dhe Sigurisë (NDSC) me të tjerë anëtarë të *Tatmadaw*. Takimi i NDSC-së ishte antikushtetues për shkak të mospërfshirjes së anëtarëve të tij civilë. Gjatë këtij takimi, Myint Swe u shpall President në Detyrë. Myint Swe në vijim shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe dorëzoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Min Aung Hlaing. Procedura për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme u shkel pasi, në bazë të Kushtetutës, vetëm Presidenti ka autoritetin të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Duke pranuar emërimin e tij si President në Detyrë dhe duke transferuar kompetencat legjislative, gjyqësore dhe ekzekutive tek Komandanti i Përgjithshëm, Myint Swe kontribuoi në përmbysjen e qeverisë së zgjedhur në mënyrë demokratike dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani.	22.03.2021
17.	Soe Win	Data e lindjes: 1 Mars 1960 Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Soe Win ka qenë Zëvendës-Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) që nga viti 2011. Ai është Nën-kryetar i Këshillit të Administratës Shtetërore (SAC) dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të Mbrojtjes dhe Sigurisë (NDSC). Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nën udhëheqjen e Komandantit të Përgjithshëm Min Aung Hlaing, realizuan një grusht shteti në Mianmar duke mos njohur rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura në 8 Nëntor 2020 dhe duke përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Si pjesë e grushtit të shtetit, Zëvendës-Presidenti Myint Swe, në cilësi të Presidentit në Detyrë, në 1 Shkurt shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe transferoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Gjeneral i Lartë Min Aung Hlaing. Më 2 Shkurt, SAC u krijua për të ushtruar këto kompetenca, duke mos lejuar që qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike të përmbushë mandatin e saj. Si Nën-kryetar i SAC, Zëvendës-Komandanti i Përgjithshëm Soe Win ka qenë i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe është përgjegjës për vendimmarrje në lidhje me funksionet e shtetit dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Për më tepër, SAC miratoi vendime kufizuese ndaj të drejtave të lirisë së shprehjes, përfshirë qasjen në informacion, dhe tubimin paqësor. Që nga 1 Shkurti 2021 forcat ushtarake dhe autoritetet që kanë vepruar nën kontrollin e SAC kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke vrarë protestues civilë dhe të paarmatosur, duke kufizuar lirinë e tubimit dhe të shprehjes, përfshirë kufizimin e qasjes në internet, dhe përmes arrestimeve arbitrare dhe ndalimit të liderëve të opozitës dhe kundërshtarëve të grushtit të shtetit. Si Nën-kryetar i SAC, Zëvendës-Komandanti i Përgjithshëm Soe Win është drejtpërdrejt përgjegjës për këto vendime shtypëse dhe për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.	22.03.2021

			Në vitin 2018, OKB-ja dhe gjithashtu organizata ndërkombëtare të shoqërisë civile raportuan shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në shtetet Kachin, Rakhine dhe Shan kundër popullatës Rohingya nga ana e forcave ushtarake dhe policore që nga viti 2011, dhe arritën në përfundimin se shumë nga këto shkelje përbëjnë krime nga më të rëndat sipas ligjit ndërkombëtar. Si Zëvendës Komandant i Përgjithshëm i *Tatmadaw* që nga viti 2011, Soe Win është drejtpërdrejt përgjegjës për këto shkelje të rënda dhe abuzime ndaj popullatës Rohingya.	
18.	Sein Win	Data e lindjes: 24 Korrik 1956 Vendi i lindjes: Pyin Oo Lwin, Mianmar/Birmani Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjeneral-Lejtnant Sein Win është një anëtar i *Tatmadaw* dhe ish-Ministër i Mbrojtjes (midis datës 24 Gusht 2015 dhe datës 1 Shkurt 2021). Më 1 Shkurt, ai mori pjesë në një Takim të Këshillit Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes (NDSC) me anëtarë të tjerë të *Tatmadaw*. Takimi i NDSC-së ishte antikushtetue për shkak të mospërfshirjes së anëtarëve të tij civilë. Gjatë atij takimi, Myint Swe u shpall President në Detyrë. Myint Swe në vijim shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe dorëzoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Min Aung Hlaing. Procedura për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme u shkel pasi, në bazë të Kushtetutës, vetëm e Presidenti ka autoritetin të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Me pjesëmarrjen e tij në mbledhjen e NDSC-së, gjatë së cilës u vendos shpallja gjendjes së jashtëzakonshme dhe transferimi i kompetencave legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes, Sein Win kontribuoi në mosnjohjen e rezultateve të zgjedhjeve të mbajtura më 8 Nëntor 2020 dhe përmbysjen e qeverisë së zgjedhur në mënyrë demokratike. Prandaj ai është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Në vitin 2018, OKB-ja dhe gjithashtu organizata ndërkombëtare të shoqërisë civile raportuan shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në shtetet Kachin, Rakhine dhe Shan kundër popullatës Rohingya nga ana e forcave ushtarake dhe policore që nga viti 2011, dhe arritën në përfundimin se shumë nga këto shkelje përbëjnë krime nga më të rëndat sipas ligjit ndërkombëtar. Si Ministër i Brendshëm nga data 24 Gusht 2015 deri në datën 1 Shkurt 2021, Sein Win është drejtpërdrejt përgjegjës për këto shkelje të rënda dhe abuzime ndaj popullatës Rohingya.	22.03.2021
19.	Thein Soe (a.k.a. U Thein Soe)	Data e lindjes: 23 Janar 1952 Vendi i lindjes: Kani, Mianmar/Birmani Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Thein Soe u emërua Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Unionit (UEC) më 2 shkurt 2021. Duke pranuar këtë emërim pas grushtit të shtetit ushtarak të 1 Shkurtit 2021, dhe përmes veprimeve të tij në cilësinë e Kryetarit të UEC, në mënyrë të veçantë anulimin e rezultateve të zgjedhjeve në mungesë të çfarëdo prove për mashtrime zgjedhore, Thein Soe ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në veprime që minojnë demokracinë dhe rendin ligjor në Mianmar.	22.03.2021

20.	Mya Tun Oo	Data e lindjes: 4 ose 5 Maj 1961 Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjenerali Mya Tun Oo është anëtar i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Ai u emërua Ministër i Mbrojtjes në 1 Shkurt 2021 dhe është anëtar i Këshillit Administrativ Shtetëror (SAC). Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nën udhëheqjen e Komandantit të Përgjithshëm Min Aung Hlaing, realizuan një grusht shteti në Mianmar duke mos njohur rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura në 8 Nëntor 2020 dhe duke përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Si pjesë e grushtit të shtetit, Zëvendës-Presidenti Myint Swe, në cilësi të Presidentit në Detyrë, në 1 Shkurt shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe transferoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Gjeneral i Lartë Min Aung Hlaing. Më 2 Shkurt, SAC u krijua për të ushtruar këto kompetenca, duke mos lejuar që qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike të përmbushë mandatin e saj. Si anëtar i SAC, Gjenerali Mya Tun Oo ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë në dhe është përgjegjës për vendime në lidhje me funksionet e shtetit dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Për më tepër, SAC miratoi vendime kufizuese ndaj të drejtave të lirisë së shprehjes, përfshirë qasjen në informacion, dhe tubimin paqësor. Që nga 1 Shkurt 2021 forcat ushtarake dhe autoritetet që kanë vepruar nën kontrollin e SAC kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke vrarë protestues civilë dhe të paarmatosur, duke kufizuar lirinë e tubimit dhe të shprehjes, përfshirë kufizimin e qasjes në internet, dhe përmes arrestimeve arbitrare dhe ndalimit të liderëve të opozitës dhe kundërshtarëve të grushtit të shtetit. Si anëtar i SAC, Gjenerali Mya Tun Oo është drejtpërdrejt përgjegjës për këto vendime shtypëse dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Në vitin 2018, OKB dhe gjithashtu organizata ndërkombëtare të shoqërisë civile raportuan shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në shtetet Kachin, Rakhine dhe Shan kundër popullatës Rohingya nga ana e forcave ushtarake dhe policore që nga viti 2011, dhe arritën në përfundimin se shumë nga këto shkelje përbëjnë krime nga më të rëndat sipas ligjit ndërkombëtar. Mya Tun Oo ishte Shefi i Përbashkët i Shtabit të Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), pozicioni i tretë më i lartë në *Tatmadaw*, nga Gushti 2016 deri në emërimin e tij si Ministër i Mbrojtjes. Në atë cilësi, ai mbikëqyri operacionet ushtarake të kryera në Shtetin Rakhine dhe bashkërendoi forcat e ndryshme të armatosura, duke përfshirë Ushtrinë, Flotën Detare dhe Forcat Ajrore, si dhe përdorimin e artilerisë. Për këto arsye ai është përgjegjës për këto shkelje të rënda dhe abuzime kundrejt popullatës Rohingya.	22.03.2021
21.	Dwe Aung Lin	Data e lindjes: 31 Maj 1962 Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjeneral-Lejtnant Dwe Aung Lin është anëtar i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) dhe Sekretari i Këshillit të Administratës Shtetërore (SAC). Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nën udhëheqjen e Komandantit të Përgjithshëm Min Aung Hlaing, realizuan një grusht shteti në Mianmar duke mos njohur rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura në 8 Nëntor 2020 dhe duke përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Si pjesë e grushtit të shtetit, Zëvendës-Presidenti Myint Swe, në cilësi të Presidentit në	22.03.2021

			Detyrë, në 1 Shkurt shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe transferoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Gjeneral i Lartë Min Aung Hlaing. Më 2 Shkurt, SAC u krijua për të ushtruar këto kompetenca, duke mos lejuar që qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike të përmbushë mandatin e saj. Gjeneral-Lejtnant Dwe Aung Lin u emërua Sekretar i SAC në 2 Shkurt 2021 dhe ai ka lëshuar urdhra të SAC-ut. Ndër të tjera, ai urdhëroi largimin nga detyra të individëve të emëruar nga qeveria e zgjedhur në mënyrë të ligjshme, si dhe në ndërrrimin e stafit të Komisionit Zgjedhor të Mianmarit. Si Anëtar dhe Sekretar i SAC, Gjeneral-Lejtnant Dwe Aung Lin ka qenë drejtpërsëdrejtë i përfshirë në dhe është përgjegjës për vendime në lidhje me funksionet e shtetit dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Për më tepër, SAC miratoi vendime kufizuese ndaj të drejtave të lirisë së shprehjes, përfshirë qasjen në informacion, dhe tubimin paqësor. Që nga 1 Shkurt 2021 forcat ushtarake dhe autoritetet që kanë vepruar nën kontrollin e SAC kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke vrarë protestues civilë dhe të paarmatosur, duke kufizuar lirinë e tubimit dhe të shprehjes, përfshirë kufizimin e qasjes në internet, dhe përmes arrestimeve arbitrare dhe ndalimit të liderëve të opozitës dhe kundërshtarëve të grushtit të shtetit. Si anëtar dhe Sekretar i SAC, Gjeneral Lejtnant Dwe Aung Lin është drejtpërdrejt përgjegjës për këto vendime represive dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.	
22.	Ye Win Oo	Data e lindjes: 21 shkurt 1966 Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjeneral-Lejtnant Ye Win Oo është një anëtar i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) dhe Sekretari i Përbashkët i Këshillit të Administratës Shtetërore (SAC). Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nën udhëheqjen e Komandantit të Përgjithshëm Min Aung Hlaing, realizuan një grusht shteti në Mianmar duke mos njohur rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura në 8 Nëntor 2020 dhe duke përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Si pjesë e grushtit të shtetit, Zëvendës Presidenti Myint Swe, në cilësi të Presidentit në Detyrë, në 1 Shkurt shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe transferoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Gjeneral i Lartë Min Aung Hlaing. Më 2 Shkurt, SAC u krijua për të ushtruar këto kompetenca, duke mos lejuar që qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike të përmbushë mandatin e saj. Gjeneral-Lejtnant Ye Win Oo u emërua Sekretar i Përbashkët i SAC në 2 Shkurt 2021. Si Anëtar dhe Sekretar i Përbashkët i SAC, Gjeneral-Lejtnant Ye Win Oo ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë në dhe është	22.03.2021

			përgjegjës për vendime në lidhje me funksionet e shtetit dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Për më tepër, SAC miratoi vendime kufizuese ndaj të drejtave të lirisë së shprehjes, përfshirë qasjen në informacion, dhe tubimin paqësor. Që nga 1 Shkurt 2021 forcat ushtarake dhe autoritetet që kanë vepruar nën kontrollin e SAC kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke vrarë protestues civilë dhe të paarmatosur, duke kufizuar lirinë e tubimit dhe të shprehjes, përfshirë kufizimin e qasjes në internet, dhe përmes arrestimeve arbitrare dhe ndalimit të liderëve të opozitës dhe kundërshtarëve të grushtit të shtetit. Si Anëtar dhe Sekretar i Përbashkët i SAC, Gjeneral-Lejtnant Ye Win Oo është drejtpërdrejt përgjegjës për të këto vendime represive dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.	
23.	Maung Maung Kyaw	Data e lindjes: 23 Korrik 1964 Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjenerali Maung Maung Kyaw është anëtar i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) dhe anëtar i Këshillit të Administratës Shtetërore (SAC). Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nën udhëheqjen e Komandantit të Përgjithshëm Min Aung Hlaing, realizuan një grusht shteti në Mianmar duke mos njohur rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura në 8 Nëntor 2020 dhe duke përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Si pjesë e grushtit të shtetit, Zëvendës-Presidenti Myint Swe, në cilësi të Presidentit në Detyrë, në 1 Shkurt shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe transferoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Gjeneral i Lartë Min Aung Hlaing. Më 2 Shkurt, SAC u krijua për të ushtruar këto kompetenca, duke mos lejuar që qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike të përmbushë mandatin e saj. Si anëtar i SAC, gjenerali Maung Maung Kyaw ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë në dhe është përgjegjës për vendime në lidhje me funksionet e shtetit dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Për më tepër, SAC miratoi vendime kufizuese ndaj të drejtave të lirisë së shprehjes, përfshirë qasjen në informacion, dhe tubimin paqësor. Që nga 1 Shkurt 2021 forcat ushtarake dhe autoritetet që kanë vepruar nën kontrollin e SAC kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke vrarë protestues civilë dhe të paarmatosur, duke kufizuar lirinë e tubimit dhe të shprehjes, përfshirë kufizimin e qasjes në internet, dhe përmes arrestimeve arbitrare dhe ndalimit të liderëve të opozitës dhe kundërshtarëve të grushtit të shtetit. Si anëtar i SAC, gjenerali Maung Maung Kyaw është drejtpërdrejt përgjegjës për këto vendime represive dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.	22.03.2021

24.	Moe Myint Tun	Data e lindjes: 24 Maj 1968 Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjeneral-Lejtnant Moe Myint Tun është anëtar i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) dhe anëtar i Këshillit Administrativ Shtetëror (SAC). Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nën udhëheqjen e Komandantit të Përgjithshëm Min Aung Hlaing, realizuan një grusht shteti në Mianmar duke mos njohur rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura në 8 Nëntor 2020 dhe duke përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Si pjesë e grushtit të shtetit, Zëvendës-Presidenti Myint Swe, në cilësi të Presidentit në Detyrë, në 1 Shkurt shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe transferoi kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të Shtetit tek Komandanti i Përgjithshëm i Shërbimeve të Mbrojtjes Gjeneral I Lartë Min Aung Hlaing. Më 2 Shkurt, SAC u krijua për të ushtruar këto kompetenca, duke mos lejuar që qeveria e zgjedhur në mënyrë demokratike të përmbushë mandatin e saj. Si anëtar i SAC, Gjeneral Lejtnant Moe Myint Tun ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë në dhe është përgjegjës për vendime lidhur me funksionet e shtetit dhe për këtë arsye është përgjegjës për minimin e demokracisë dhe rendit ligjor në Mianmar/Birmani. Për më tepër, SAC miratoi vendime kufizuese ndaj të drejtave të lirisë së shprehjes, përfshirë qasjen në informacion, dhe tubimin paqësor. Që nga 1 Shkurt 2021 forcat ushtarake dhe autoritetet që kanë vepruar nën kontrollin e SAC kanë kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke vrarë protestues civilë dhe të paarmatosur, duke kufizuar lirinë e tubimit dhe të shprehjes, përfshirë kufizimin e qasjes në internet, dhe përmes arrestimeve arbitrare dhe ndalimit të liderëve të opozitës dhe kundërshtarëve të grushtit të shtetit. Si anëtar i SAC, Gjeneral Lejtnant Moe Myint Tun është drejtpërdrejt përgjegjës për këto vendime represive dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Në vitin 2018, OKB-ja dhe gjithashtu organizata ndërkombëtare të shoqërisë civile raportuan shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në shtetet Kachin, Rakhine dhe Shan kundër popullatës Rohingya nga ana e forcave ushtarake dhe policore që nga viti 2011, dhe arritën në përfundimin se shumë nga këto shkelje përbëjnë krime nga më të rëndat sipas ligjit ndërkombëtar. Gjeneral Lejtnant Moe Myint Tun shërbeu si Komandant i Byrosë së Operacioneve Speciale (BSO)-6 dhe ishte Shef Shtabi (Ushtria) i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*) deri në vitin 2019. Në atë cilësi, ai mbikëqyri operacionet në Shtetin Rakhine. Prandaj ai është përgjegjës për këto shkelje serioze dhe abuzime kundër popullsisë Rohingya.	22.03.2021
25.	Than Hlaing	Data e lindjes: Kombësia: Mianmar Gjinia: mashkull	Gjeneral-Lejtnant Than Hlaing është një anëtar i Forcave të Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*). Ai u emërua Zëvendës Ministër i Punëve të Brendshme, Shefi i Policisë në 2 Shkurt 2021. Më 1 Shkurt 2021, Forcat e Armatosura të Mianmarit (*Tatmadaw*), nën udhëheqjen e Komandantit të Përgjithshëm Min Aung Hlaing, realizuan një grusht shteti në Mianmar duke mos njohur rezultatet e	22.03.2021'

21.	MOHSENI-EJEI Gholam-Hossein	Vendlindja: Ejiyeh Datëlindja: 1956	.Prokurori i Përgjithshëm i Iranit që nga shtatori 2009 dhe Zëvendës Shefi dhe Zëdhënësi i Gjyqësorit. Ish-ministri i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009. Ndërsa ai ishte ministër i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009, agjentët e inteligjencës nën komandën e tij ishin përgjegjës për ndalimin, torturimin dhe nxjerrjen e rrëfimeve të rreme nën presionin e qindra aktivistëve, gazetarëve, disidentëve dhe politikanëve reformistë. Për më tepër, figurat politike u detyruan të bënin rrëfime të rreme nën marrje në pyetje të padurueshme, të cilat	12.4.2011

			përfshinin tortura, abuzime, shantazhe dhe kërcënime ndaj anëtarëve të familjes.	
22.	MORTAZAVI Said	Vendlindja: Meybod, Yzad (Iran) Datëlindja: 1967	Ish-Prokurori i Përgjithshëm i Teheranit deri në gusht 2009. Si Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit, ai lëshoi një urdhër batanije të përdorur për ndalimin e qindra aktivistëve, gazetarëve dhe studentëve. Në janar 2010, një hetim parlamentar e bëri atë drejtpërdrejt përgjegjës për ndalimin e tre të burgosurve që vdiqën më pas në paraburgim. Ai u pezullua nga detyra në gusht 2010 pas një hetimi nga drejtësia iraniane për rolin e tij në vdekjen e tre burrave të ndaluar me urdhër të tij pas zgjedhjeve. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjet e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane.	12.4.2011
23.	PIR-ABASSI Abbas		Gjykatësi, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ai është i ngarkuar me çështjet paszgjedhore, ai lëshoi dënime me burg të gjatë gjatë gjykimeve të padrejta kundër aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe ka lëshuar disa dënime me vdekje për protestuesit.	12.4.2011
28.	YASAGHI Ali-Akbar		Gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Ish-Kryetari i Gjykatës, Gjykata Revolucionare e Mashhad. Gjykimet nën juridiksionin e tij janë kryer në mënyrë të përmbledhur dhe brenda seancave të mbyllura, pa respektimin e të drejtave themelore të të akuzuarit. Ndërsa vendimet e ekzekutimit ishin lëshuar në masë, dënimet me vdekje ishin lëshuar pa respektimin e duhur të procedurave të dëgjimit të drejtë.	12.4.2011
30.	ESMAILI Gholam -Hossein		Shefi i Gjyqësorit të Teheranit. Ish Shefi i Burgjeve të Iranit Organizimi. Në këtë cilësi, ai ishte bashkëpunëtor në arrestimin masiv të protestuesve politikë dhe fshehjen e abuzimeve kryhet në sistemin e burgimit.	12.4.2011
34.	AKBARSHAHI Ali-Reza		Drejtori i Përgjithshëm i Shtabit Anti-Narkotik të Iranit. Ish Komandant i Policisë së Teheranit. Nën udhëheqjen e tij, forca policore ishte përgjegjëse për përdorimin e forcës jashtëgjyqësore ndaj të dyshuarve gjatë arrestimit dhe paraburgimit. Policia e Teheranit ishte gjithashtu e implikuar në bastisjet në konviktet e universitetit të Teheranit në qershor 2009, kur sipas një komisioni të Iranit Majlis, më shumë se 100 studentë u plagosën nga policia dhe Basiji. Aktualisht shef i policisë hekurudhore.	10.10.2011
36.	AVAEE Seyyed Ali-Reza (alias AVAEE Seyyed Alireza)		Këshilltar pranë Gjykatës Disiplinore për Gjyqtarët që nga prilli 2014. Ish-Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit. Si Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit, ka qenë përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut, arrestime arbitrare, mohim të të drejtave të të burgosurve si dhe një numër të lartë ekzekutimesh.	10.10.2011
37.	BANESHI Jaber		Këshilltar i Gjyqësorit në Iran. Ish-Prokurori i Shirazit deri në vitin 2012. Ai ishte përgjegjës për përdorimin e tepruar dhe në rritje të	10.10.2011

			dënimit me vdekje duke dhënë dhjetëra dënime me vdekje. Prokurori gjatë çështjes së bombardimeve në Shiraz në 2008, e cila u përdor nga regjimi për të dënuar me vdekje disa kundërshtarë të regjimit.	
40.	HABIBI Mohammad Reza	Gjinia: mashkull	Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Isfahanit. Ish-Kryetar i Zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd. Ish- Zv.Prokuror i Isfahanit. Bashkëpunëtor në procedura që mohojnë gjykimin e drejtë të të pandehurve – si psh. Abdollah Fathi, ekzekutuar në maj 2011 pasi e drejta për t'u dëgjuar dhe problemet me shëndetin mendor u injoruan nga Habibi gjatë gjykimit të tij në mars 2010. Kështu, ishte bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në një rritje të lartë të ekzekutimeve në vitin 2011.	10.10.2011
41.	HEJAZI Mohammad	Vendlindja: Ispahan Datëlindja: 1956	Nënkryetari i Forcave të Armatosura, ai ka luajtur një rol kryesor në frikësimin dhe kërcënimin e 'armiqve' të Iranit dhe bombardimin e fshatrave Kurde Irakiane. Ish Shefi i Korpusit Sarollah të IRGC në Teheran dhe ish Shefi i Forcave Basij, ai luajti një rol qendror në shtypjen pas-zgjedhore të protestuesve.	10.10.2011
47.	KHALILOLLAHI Moussa (Aka: KHALILOLLAHI Mousa, ELAHI Mousa Khalil)		Prokurori i Tabrizit. Ai ishte i përfshirë në çështjen Sakineh Mohammadi-Ashtiani dhe është bashkëpunëtor në shkeljet e rënda të së drejtës për proces të rregullt ligjor.	10.10.2011
48.	MAHSOULI Sadeq (Aka: MAHSULI, Sadeq)	Vendlindja: Oroumieh (Iran) Datëlindja: 1959/60	Këshilltar i ish Presidentit dhe anëtar aktual i Këshillit të Përvojës Mahmoud Ahmadinexhad dhe anëtar i Frontit të Këmbënguljes. Ministër i Mirëqenies dhe Sigurimeve Shoqërore midis 2009 dhe 2011. Ministër i Brendshëm deri në Gusht 2009. Si Ministër i Brendshëm, Mahsouli kishte autorizim mbi të gjitha forcat e policisë, agjentët e sigurimit të ministrisë së brendshme dhe agjentët e rrobave civile. Forcat nën drejtimin e tij ishin përgjegjëse për sulmet ndaj konvikteve të Universitetit të Teheranit në 14 qershor 2009 dhe torturat e studentëve në bodrumin e Ministrisë (niveli famëkeq i bodrumit 4). Protestues të tjerë u abuzuan rëndë në Qendrën e Paraburgimit Kahrizak, e cila operohej nga policia nën kontrollin e Mahsouli	10.10.2011
49.	MALEKI Mojtaba		Prokurori i Kermanshah. Ka luajtur një rol në rritjen dramatike të dënimeve me vdekje që po kalohen në Iran, duke përfshirë ndjekjen penale të çështjeve të shtatë të burgosurve të dënuar për trafik droge të cilët u varën në të njëjtën ditë në 3 Janar 2010 në burgun qendror të Kermanshah.	10.10.2011

52.	KHODAEI SOURI Hojatollah	Vendlindja: Selseleh (Iran) Datëlindja: 1964	Anëtar i Komitetit të Sigurisë Kombëtare dhe Politikës së Jashtme. Deputet parlamentar për Provincën Lorestan. Anëtar i Komisionit Parlamentar për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë. Ish-kreu i burgut të Evin deri në 2012. Tortura ishte një praktikë e zakonshme në burgun e Evin ndërsa Souri ishte kreu i tij. Në Repartin 209, shumë aktivistë u mbajtën për aktivitetet e tyre paqësore në kundërshtim me qeverinë në pushtet.	10.10.2011
53.	TALA Hossein (aka: TALA Hosseyn)		Ish Guvernatori i Përgjithshëm ('Farmandar') i Provincës së Teheranit deri në Shtator 2010, ai ishte përgjegjës për ndërhyrjen e forcave të policisë dhe për këtë arsye për shtypjen e demonstratave. Ai mori një çmim në dhjetor 2010 për rolin e tij në shtypjen paszgjedhore.	10.10.2011
54.	TAMADDON Morteza (alias TAMADON Morteza)	Vendlindja: Shahr Kord-Isfahan (Iran) Datëlindja: 1959	Shef i Këshillit Provincial të Sigurisë Publike në Teheran. Ish-Guvernator i Përgjithshëm i IRGC-së në Provincën e Teheranit. Në cilësinë e tij si guvernator dhe kryetar i Këshillit të Sigurisë Publike provinciale të Teheranit, mbante përgjegjësi të përgjithshme për të gjitha aktivitetet shtypëse të ndërmarra nga IRGC në provincën e Teheranit, përfshirë shtypjen e protestave politike që nga qershori 2009.	10.10.2011
57.	HAJMOHAM- MADI Aziz		Gjyqtar në Gjykatën Penale Provinciale të Teheranit. Ish gjyqtar në dhomën e parë të Gjykatës Evin. Ai zhvilloi disa gjykime të demonstruesve, ndër të tjera, atë të Abdol-Reza Ghanbari, një mësues i arrestuar në janar 2010 dhe i dënuar me vdekje për aktivitetet e tij politike. Gjykata e shkallës së parë Evin u krijua brenda mureve të burgut Evin, një fakt i mirëpritur nga Jafari Dolatabadi në Mars 2010. Në këtë burg disa persona të akuzuar janë mbyllur, keqtrajtuar dhe detyruar të bëjnë deklarata të rreme.	10.10.2011
59.	BAKHTIARI Seyyed Morteza		Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm, përgjegjës për çështjet politike dhe të sigurisë. Ish Ministri i Drejtësisë nga 2009 në 2013. Gjatë kohës së tij si Ministër i Drejtësisë, kushtet e burgjeve brenda Iranit ranë shumë më poshtë se standardet e pranuara ndërkombëtare, dhe kishte keqtrajtim të përhapur ndaj të burgosurve. Për më tepër, ai luajti një rol kryesor në kërcënimin dhe ngacmimin e diasporës iraniane duke njoftuar krijimin e një gjykate speciale për t'u marrë posaçërisht me iranianët që jetojnë jashtë vendit. Ai gjithashtu mbikëqyri një rritje të mprehtë të numrit të ekzekutimeve në Iran, duke përfshirë ekzekutime të fshehta që nuk u njoftuan nga qeveria, dhe ekzekutime për vepra të lidhura me drogën.	10.10.2011
60.	HOSSEINI Dr Mohammad (alias HOSSEYNI, Dr Seyyed Mohammad; Seyed, Sayyed and Sayyid)	Vendlindja: Rafsanjan, Kerman Datëlindja: 1961	Këshilltar i ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe zëdhënës i YEKTA, një fraksion politik i vijës së ashpër. Ministër i i Kulturës dhe Direktivave Islamik (2009– 2013). Si ish-IRGC, ishte bashkëpunëtor në shtypjen e gazetarëve.	10.10.2011

61.	MOSLEHI Heydar (Aka: MOSLEHI Heidar; MOSLEHI Haidar)	Vendlindja: Isfahan (Iran) Datëlindja: 1956	Shef i organizatës për botime mbi rolin e klerit në luftë. Ish-Ministri i Inteligjencës (2009-2013). Nën udhëheqjen e tij, Ministria e Inteligjencës vazhdoi praktikat e ndalimit dhe persekutimit arbitrar të protestuesve dhe disidentëve. Ministria e Inteligjencës drejton Repartin 209 të Burgut Evin, ku shumë aktivistë janë mbajtur për shkak të aktiviteteve të tyre paqësore në kundërshtim me qeverinë në pushtet. Hetuesit nga Ministria e Inteligjencës i kanë nënshtruar të burgosurit në Repartin 209 të rrahjeve dhe abuzimit mendor dhe seksual.	10.10.2011
62.	ZARGHAMI Ezzatollah	Vendlindja: Dezful (Iran) Datëlindja: 22 Korrik 1959	Shefi i Transmetimit të Republikës Islamike të Iranit (IRIB) deri në Nëntor 2014. Ka të ngjarë që aktualisht të jetë në një proces të rivendosjes në një funksion tjetër. Nën mandatin e tij në IRIB, ai ishte përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. IRIB ka transmetuar rrëfime të detyruara të të paraburgosurve dhe një seri 'gjyqesh shfaqje' në gusht 2009 dhe dhjetor 2011. Këto përbëjnë një shkelje të qartë të dispozitave ndërkombëtare për gjykimin e drejtë dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.	23.3.2012
63.	TAGHIPOUR Reza	Vendlindja: Maragheh (Iran) Datëlindja: 1957	Anëtar i Këshillit të Qytetit të Teheranit. Ish-Ministër për Informimin dhe Komunikimet (2009-2012). Si Ministër i Informacionit, ai ishte një nga zyrtarët më të lartë të ngarkuar me censurimin dhe kontrollin e veprimtarive të internetit dhe gjithashtu të gjitha llojet e komunikimeve (në veçanti telefonat mobil). Gjatë marrjes në pyetje të të paraburgosurve politikë, hetuesit përdorin të dhënat personale të të burgosurve, postën dhe komunikimet. Në disa raste pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2009 dhe gjatë demonstratave në rrugë, linjat celulare dhe mesazhet me tekst u bllokuan, kanalet televizive satelitore u bllokuan dhe interneti u pezullua në vend ose të paktën u ngadalësua.	23.3.2012
64.	KAZEMI Toraj		Kolonel i policisë së teknologjisë dhe komunikimit, ai njoftoi një fushatë për rekrutimin e hakerave qeveritarë në mënyrë që të arrijë kontroll më të mirë të informacionit në internet dhe të sulmojë faqet 'të rrezikshme'.	23.3.2012
65.	LARIJANI Sadeq	Vendlindja: Najaf (Irak) Datëlindja: 1960 ose gusht 1961	Shefi i Gjyqësorit. Nga Shefi i Gjyqësorit kërkohet që të pajtohet dhe të nënshkruajë çdo kisas (ndëshkim), hodoud (krime kundër Zotit) dhe ta'zirat (krime kundër shtetit) dënimit. Kjo përfshin dënime që tërheqin dënimin me vdekje, fshikullime dhe amputime. Në këtë drejtim, ai personalisht ka nënshkruar dënime të shumta me dënime me vdekje, duke kundërshtuar standardet ndërkombëtare, përfshirë gurëzimin, ekzekutimet me mbytje pezullimi, ekzekutimin e të miturve dhe ekzekutimet publike të tilla si ato ku të burgosurit ishin varur nga urat	23.3.2012

			përpara turmave të mijëra. Ai gjithashtu ka lejuar dënime fizike si amputime dhe pikim acidi në sytë e të dënuarit. Që kur Sadeq Larijani mori detyrën, arrestimet arbitrare të të burgosurve politikë, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe pakicat u rritën dukshëm. Ekzekutimet gjithashtu u rritën ndjeshëm që nga viti 2009. Sadeq Larijani gjithashtu mban përgjegjësi për dështimet sistematike në procesin gjyqësor iranian për të respektuar të drejtën për një gjykim të drejtë.	
66.	MIRHEJAZI Ali		Pjesë e rrethit të ngushtë të Udhëheqësit Suprem, një nga ata që janë përgjegjës për planifikimin e shtypjes së protestave që është zbatuar që nga viti 2009, dhe shoqërohet me ata që janë përgjegjës për shtypjen e protestave.	23.3.2012
68.	RAMIN Mohammad-Ali	Vendlindja: Dezful (Iran) Datëlindja: 1954	Sekretari i Përgjithshëm i Fondacionit Botëror të Holokaustit, i themeluar në Konferencën Ndërkombëtare për të Rishikuar Vizionin Global të Holokaustit në 2006, të cilin Ramin ishte përgjegjës për organizimin në emër të Qeverisë Iraniane. Figura kryesore përgjegjëse për censurimin si Zëvendës Ministër i ngarkuar me shtypin deri në dhjetor 2013, duke qenë drejtpërdrejt përgjegjës për mbylljen e shumë gazetave reformuese (Etemad, Etemad-e Melli, Shargh, etj.), Mbylljen e Sindikatës së Pavarur të Shtypit dhe frikësimi ose arrestimi i gazetarëve.	23.3.2012
69.	MORTAZAVI Seyyed Solat	Vendlindja: Farsan, Tchar Mahal-o-Bakhtiari (Jug) – (Iran) Datëlindja: 1967	Kryebashkiak i qytetit të dytë më të madh të Iranit, Mashhad, ku ekzekutimet publike ndodhin rregullisht. Ish-zv.Ministër i Brendshëm për Çështjet Politike, i emëruar në 2009. Në këtë cilësi, ai ishte përgjegjës për drejtimin e shtypjes së personave që flisnin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes. Më vonë u emërua Kryetar i Komitetit Zgjedhor Iranian për zgjedhjet parlamentare në 2012 dhe për zgjedhjet presidenciale në 2013.	23.3.2012
73.	FAHRADI Ali		Prokuror i Karajt. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjykime në të cilat u dha dënimi me vdekje. Gjatë periudhës kur ishte prokuror, në rajonin Karaj pati një numër të lartë ekzekutimesh.	23.3.2012
74.	REZVANMA-NESH Ali		Prokurori. Përgjegjës për shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut, përfshirë përfshirjen në ekzekutimin e një të mituri.	23.3.2012
75.	RAMEZANI Gholamhossein		Shefi i Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes. Ish Shefi i Mbrojtjes dhe Sigurisë në IRGC deri në Mars 2012. Ish- Komandanti i Inteligjencës së IRGC deri në Tetor 2009. Përfshirë në shtypjen e lirisë së shprehjes, përfshirë këtu duke u shoqëruar me ata që ishin përgjegjës për arrestimet e blogerëve / gazetarëve në 2004 dhe raportohet të ketë pasur një rol në shtypjen e protestave paszgjedhore në 2009.	23.3.2012

77.	JAFARI Reza	Datëlindja: 1967	Këshilltar në Gjykatën Disiplinore për Gjyqtarët që nga viti 2012. Anëtar i 'Komitetit për Përcaktimin e Përmbajtjes Penale të Uebit', një organ përgjegjës për faqet e internetit dhe censurimin e mediave sociale. Ish Shefi i prokurorisë speciale të krimit kibernetik midis 2007 dhe 2012. Ishte përgjegjës për shtypjen e lirisë së shprehjes, përfshirë përmes arrestimit, ndalimit dhe ndjekjes penale të blogerëve dhe gazetarëve. Personat e arrestuar nën dyshimin e krimit kibernetik u keqtrajtuan dhe iu nënshtruan një procesi të padrejtë gjyqësor.	23.3.2012
78.	RESHTE-AHMADI Bahram		Gjyqtar i një gjykate të zakonshme të Teheranit verior. Ish mbikëqyrës i Zyrës së Prokurorisë Publike në Teheran. Zëvendës Shef i Zyrës për Çështjet e Burgjeve të Provincës Teheran. Ish Zëvendës Prokurori në Teheran deri në 2013. Ai drejtoi qendrën e prokurorisë Evin. Ishte përgjegjës për mohimin e të drejtave, përfshirë vizitat dhe të drejtat e të burgosurve të tjerë, te mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe të burgosurit politikë.	23.3.2012
79.	RASHIDI AGHDAM, Ali Ashraf		Shefi i Burgut të Evin, emëruar në mes të vitit 2012. Që nga emërimi i tij, kushtet në burg u përkeqësuan dhe raportet referuan keqtrajtimit të intensifikuar të të burgosurve. Në tetor 2012, nëntë të burgosura femra hynë në grevë urie në protestë për shkeljen e të drejtave të tyre dhe trajtimin e dhunshëm nga rojet e burgut.	12.3.2013
80.	KIASATI Morteza		Gjykatësi i Gjykatës Revolucionare të Ahwazit, Dega 4, vendosi dënime me vdekje për katër të burgosur politikë arabë, Taha Heidarian, Abbas Heidarian, Abd al-Rahman Heidarian (tre vëllezër) dhe Ali Sharifi. Ata u arrestuan, u torturuan dhe u varën pa procedurën e duhur. Këto raste dhe mungesa e procesit të duhur u referuan në një raport të datës 13 Shtator 2012 nga Raportuesi Special i KB për të drejtat e njeriut në Iran, raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të KB mbi Iranin, i 22 gushtit 2012.	12.3.2013
81.	MOUSSAVI, Seyed Mohammad Bagher		Gjykatësi i Gjykatës Revolucionare Ahwaz, Dega 2, vendosi dënime me vdekje për pesë arabë Ahwazi, Mohammad Ali Amouri, Hashem Sha'bani Amouri, Hadi Rashedi, Sayed Jaber Alboshoka, Sayed Mokhtar Alboshoka, në 17 Mars 2012 për 'aktivitete kundër sigurisë kombëtare' dhe ' armiqësi kundër Zotit '. Dënimet u mbështetën nga Gjykata e Lartë e Iranit në 9 Janar 2013. Të pestë u arrestuan pa akuzë për më shumë se një vit, u torturuan dhe u dënuan pa procedurën e duhur.	12.3.2013
82.	SARAFRAZ Mohammad (Dr) (aka: Haj-agha Sarafraz)	Vendlindja: Tehran Datëlindja: 1963 Vendi i punës: IRIB dhe PressTV Selia, Teheran	Presidenti i Transmetimeve të Republikës Islamike të Iranit (IRIB). Ish Shefi i Shërbimit Botëror të IRIB dhe Press TV, përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. Lidhur ngushtë me aparatin e sigurimit të shtetit. Nën drejtimin e tij Press TV, së bashku me IRIB, ka punuar me	12.3.2013

			shërbimet e sigurimit dhe prokurorët iranianë për të transmetuar rrëfime të detyruara të të arrestuarve, duke përfshirë atë të gazetarit iraniano-kanadez dhe prodhuesit të filmit Maziar Bahari, në programin javor Iran Today '. Rregullatori i pavarur i transmetimit OFCOM gjobiti Press TV në Mbretërinë e Bashkuar 100 000 GBP për transmetimin e rrëfimit të Baharit në 2011, i cili u filmua në burg ndërsa Bahari ishte nën detyrim. Prandaj Sarafraz shoqërohet me shkeljen e së drejtës për proces të rregullt dhe gjykim të drejtë.	
83.	JAFARI, Asadollah		Prokurori i Provincës Mazandaran, përgjegjës për arrestimet e paligjshme dhe shkeljet e të drejtave të të arrestuarve Bahá'í nga arrestimi fillestar deri në mbajtjen e tyre në izolim në Qendrën e Paraburgimit të Inteligjencës. Gjashtë shembuj konkretë të rasteve kur është shkelur procesi i rregullt ligjor janë dokumentuar. Jafari ka ndjekur penalisht çështje që kanë rezultuar në shumë ekzekutime, përfshirë ekzekutime publike.	12.3.2013
85.	HAMLBAR, Rahim		Gjyqtar i Degës I të Gjykatës Revolucionare të Tabrizit. Përgjegjës për dënime të rënda kundër gazetarëve dhe pakicës etnike Azeriane dhe aktivistëve të të drejtave të punëtorëve, duke i akuzuar ata për spiunim, veprime kundër sigurisë kombëtare, propagandë kundër regjimit iranian dhe fyerje të liderit të Iranit. Gjykimet e tij nuk ndoqën procesin e rregullt në shumë raste dhe të paraburgosurit u detyruan të rrëfeheshin rremë. Një rast i profilit të lartë përfshinte 20 punonjës vullnetarë të ndihmës së tërmetit (pas një tërmeti në Iran në gusht 2012) të cilëve ai u dha dënime me burg për përpjekjet e tyre për të ndihmuar viktimat e tërmetit. Gjykata i shpalli punëtorët fajtorë për 'bashkëpunim në mbledhje dhe bashkëpunim për të kryer krime kundër sigurisë kombëtare.'	12.3.2013
86.	MUSAVI- TABAR, Seyyed Reza		Shefi i Prokurorisë Revolucionare të Shirazit. Përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe trajtim të keq të aktivistëve politikë, gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, Bahá'íve dhe të burgosurve të ndërgjegjes, të cilët u ngacmuan, u torturuan, u morën në pyetje dhe u mohua hyrja në avokatë dhe procedurat e rregullta. Musavi-Tabar nënshkroi urdhra gjyqësorë në Qendrën famëkeqe Nr. 100 të Paraburgimit (një burg për burra), duke përfshirë një urdhër për të ndaluar të burgosurën Bahá'í, Raha Sabet, për tre vjet në izolim.	12.3.2013

Entitetet

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	Qendra për Hetimin e Krimit të Organizuar (aka: Zyra e Krimit Kibernetik ose Policia Kibernetike)	Vendndodhja: Teheran (Iran) Faqja e internetit: http://www.cyberpolice.ir	Policia Kibernetike iraniane, e themeluar në Janar 2011, është një njësi e Policisë së Republikës Islamike të Iranit, e cila drejtohet nga Esmail Ahmadi-Moqaddam (i listuar). Ahmadi-Moqaddam nënvizoi se Policia Kibernetike do të merrte grupe anti-revolucionare dhe disidente që përdorën rrjete sociale të bazuara në internet në 2009 për të shkaktuar protesta kundër rizgjedhjes së Presidentit Mahmoud Ahmadinejad. Në janar 2012, Policia Kibernetike lëshoi udhëzime të reja për kafenetë në internet, duke u kërkuar përdoruesve të sigurojnë informacione personale që do të mbaheshin nga pronarët e kafeneve për gjashtë muaj, si dhe një rekord të faqeve në internet që ata vizituan. Rregullat gjithashtu kërkojnë që pronarët e kafeneve të instalojnë kamera televizive me qark të mbyllur dhe të mbajnë regjistrimet për gjashtë muaj. Këto rregulla të reja mund të krijojnë një ditar që autoritetet mund të përdorin për të gjurmuar aktivistë ose këdo që konsiderohet si një kërcënim për sigurinë kombëtare. Në qershor 2012, media iraniane njoftoi se Policia Kibernetike do të niste një goditje në rrjetet private private (VPN). Më 30 tetor 2012, Policia Kibernetike arrestoi blogerin Sattar Beheshti pa një urdhër për 'veprime kundër sigurisë kombëtare në rrjetet sociale dhe Facebook.' Beheshti kishte kritikuar qeverinë iraniane në blogun e tij. Beheshti u gjet i vdekur në qelinë e tij të burgut në 3 nëntor 2012 dhe besohet se ishte torturuar për vdekje nga autoritetet e Policisë Kibernetike.	

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2016/565
i datës 11 prill 2016
që ndryshon Vendimin 2011/235/PPJS për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) (1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/(PPJS).[1]

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2011/235/PPJS, masat shtrënguese e parashikuara në të duhet të ripërtërihen deri më 13 prill 2017.

(3) Këshilli vendosi edhe se të dhënat për disa persona të përfshirë në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS duhet të përditësohen.

(4) Për më tepër, nuk ka më arsye për mbajtjen e dy personave në listën e personave dhe subjekteve që i nënshtrohen masat kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2011/235 / CFSP, dhe për këtë arsye shënimet në lidhje me to duhet të fshihet.

(5) Vendimi 2011/235/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Neni 6, pika 2 e Vendimit 2011/235/PPJS zëvendësohet me pikën më poshtë:

"2. Ky Vendim zbatohet deri më 13 prill 2017 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

Neni 2

Shtojca e Vendimit 2011/235/PPJS ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Luksemburg, më 11 prill 2016.

Për Këshillin
Presidenti
M.H.P. VAN DAM

[1] Vendimi i Këshillit 2011/235/PPJS i datës 12 prill 2011 për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (GZ) L 100, 14.4.2011, fq. 51).

SHTOJCA

(1) Shënimet për personat e mëposhtëm fshihen nga lista e paraqitur në Aneksin e Vendimit 2011/235 / CFSP:

5. HAMEDANI Hussein

71. SHARIFI Malek Ajdar

(2) Shënimet për personat vijues siç përcaktohet në Shtojca e Vendimit 2011/235 / CFSP zëvendësohet me shënimet e mëposhtme:

Personat

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	AHMADI-MOQADDAM Esmail	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1961	Ish-Këshilltar i Lartë për Çështjet e Sigurisë për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shef i Policisë Kombëtare të Iranit nga 2005 deri në fillim të 2015. Gjithashtu Shef i Policisë Kibernetike Iraniane (të listuar) nga janari 2011 deri në fillim të 2015. Forcat nën komandën e tij drejtuan sulme mizore në protesta paqësore dhe një sulm të dhunshëm gjatë natës në konviktet e Universitetit të Teheranit më 15 qershor 2009.	
2	ALLAHKARAM Hossein	Vendlindja: Najafabad (Iran) Datëlindja: 1945	Shefi i Këshillit të Koordinimit Ansar-e Hezbollah dhe ish-gjeneral i IRGC-së. Bashkëthemeloi Ansar-e Hezbollah. Kjo forcë paramilitare ishte përgjegjëse për dhunën ekstreme gjatë shtypjes së protestave të studentëve dhe universiteteve në 1999, 2002 dhe 2009.	
4.	FAZLI Ali		Zëvendëskomandant i Basij, Shef i Korpusit Seyyed al-Shohada të IRGC-së, Provinca e Teheranit (deri në shkurt 2010). Korpusi Seyyed al-Shohada është përgjegjës për sigurinë në provincën Teheran dhe luajti rol kryesor në shtypje mizore të protestuesve në 2009.	
8.	MOTLAGH Bahram Hosseini		Shef i Komandës së Ushtrisë dhe Kolegjit të Shtabit të Përgjithshëm (DAFOOS). Ish-Shef i Korpusit Seyyed al-Shohada të IRGC-së, Provinca e Teheranit. Nën përgjegjësinë e tij, Korpusi Seyyed al-Shohada luajti rol kryesor në organizimin e shtypjes së protestës.	
10.	RADAN Ahmad-Reza	Vendlindja: Isfahan (Iran) Datëlindja: 1963	Shefi i Qendrës për Studime Strategjike të Forcës Iraniane të Zbatimit të Ligjit, një organ i lidhur me Policinë Kombëtare. Zv.Shef i Policisë Kombëtare të Iranit deri në qershor 2014. Si zv.Shef i Policisë	12.4.2011

			Kombëtare nga viti 2008, Radan ishte përgjegjës për rrahjet, vrasjet, dhe arrestimet dhe ndalimet arbitrare të protestuesve nga forcat e policisë.	
14.	SHARIATI Seyeed Hassan		Këshilltar dhe Anëtar i Seksionit të 28-të të Gjykatës Supreme. Shefi i Gjyqësorit të Mashhad deri në shtator 2014. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuar dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	12.4.2011
16.	HADDAD Hassan (alias Hassan ZAREH DEHNAVI)		Ish-zv.Kryetar i Sigurisë i Gjykatës Revolucionare të Teheranit. Ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ishte përgjegjës për çështjet e të paraburgosurve në lidhje me krizat paszgjedhore dhe kërcënonte rregullisht familjet e të paraburgosurve për t'ua mbyllur gojën. Ka qenë vendimtar në lëshimin e urdhrave të paraburgimit në Qendrën e Burgimit në Kahrizak në 2009. Nw nwntor tw 2014, roli i tij në vdekjet e të paraburgosurve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane.	12.4.2011
17.	SOLTANI Hodjatoleslam Seyed Mohammad		Kreu i Organizatës për Propagandë Islame në provincën e Khorasan Razavi. Gjyqtar pranë Gjykatës Revolucionare të Mashhad. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuara dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	
23.	PIR-ABASSI Abbas		Magjistrat i një Kolegji Penal. Ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ka të ngjarë të jetë aktualisht në një proces të rivendosjes në një funksion tjetër. Ishte përgjegjës për çështjet paszgjedhore. Dha dënime të gjata me burg gjatë gjykimeve të padrejta kundër aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe disa dënime me vdekje për protestuesit.	12.4.2011
24.	MORTAZAVI Amir		Zv.Shefi i Njësisë për Çështjet Sociale dhe Parandalimin e Krimit në gjyqësor në provincën e Khorasan-Razavi. Zv.Prokuror i Mashhad. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuara dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	

26.	SHARIFI Malek Adjar		Gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Ish-Shef i Gjyqësorit të Azerbajxhanit Lindor. Ishte përgjegjës për gjyqin e Sakineh Mohammadi-Ashtiani.	
34.	AKBARSHAHI Ali-Reza		Drejtor i Përgjithshëm i Seksionit të Kontrollit të Drogës në Iran (alias Seksioni i Anti-Narkotikëve). Ish-Komandant i Policisë së Teheranit. Nën udhëheqjen e tij, forca policore ishte përgjegjëse për përdorimin e forcës jashtëgjyqësore ndaj të dyshuarve gjatë arrestimit dhe paraburgimit. Policia e Teheranit ishte gjithashtu e implikuar në bastisjet në konviktet e universitetit të Teheranit në qershor 2009 kur, sipas një komisioni Majlis të Iranit, më shumë se 100 studentë u plagosën nga policia dhe Basij.	10.10.2011
40.	HABIBI Mohammad Reza		Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Isfahanit. Bashkëpunëtor në procedura që mohojnë gjykimin e drejtë të të pandehurve – si psh. Abdollah Fathi, ekzekutuar në maj 2011 pasi e drejta për t'u dëgjuar dhe problemet me shëndetin mendor u injoruan nga Habibi gjatë gjykimit të tij në mars 2010. Kështu, ishte bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në një rritje të lartë të ekzekutimeve në vitin 2011.	10.10.2011
43.	JAVANI Yadollah	Vendlindja: Isfahan Datëlindja: 1956	Këshilltar i përfaqësuesit të Udhëheqësit Suprem në IRGC. Ai rregullisht flet në media si përfaqësues i anës së vijës së ashpër të regjimit. Ai ishte një nga zyrtarët e parë të rangut të lartë që kërkoi arrestimin e Moussavi, Karroubi dhe Khatami. Ai ka mbështetur vazhdimisht përdorimin e dhunës dhe taktikave të ashpra të marrjes në pyetje kundër protestuesve pas zgjedhjeve (duke justifikuar rrëfimet e regjistruara në TV), duke përfshirë urdhërimin e keqtrajtimit jashtëgjyqësor të disidentëve përmes botimeve të shpërndara në IRGC dhe Basij.	10.10.2011
50.	OMIDI Mehrdad		Shef i Shërbimeve të Inteligjencës në Policinë Iraniane. Ish-Shef i Njësisë së Krimeve Kompjuterike të Policisë Iraniane. Ka qenë përgjegjës për mijëra hetime dhe padi ndaj reformistëve dhe kundërshtarëve politikë duke përdorur internetin. Po kështu, ka qenë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në shtypjen e personave që flasin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes.	10.10.2011

59.	BAKHTIARI Seyyed Morteza	Vendlindja: Mashhad (Iran) Datëlindja: 1952	Zyrtar i Tribunalit Special Klerikal. Ish Ministri i Drejtësisë nga 2009 në 2013. Gjatë kohës së tij si Ministër i Drejtësisë, kushtet e burgjeve brenda Iranit ranë shumë më poshtë se standardet e pranuara ndërkombëtare dhe kishte keqtrajtim të përhapur të të burgosurve. Për më tepër, ai luajti rol kryesor në kërcënimin dhe frikësimin e diasporës iraniane duke njoftuar krijimin e një gjykate speciale për t'u marrë në mënyrë specifike me iranianët që jetojnë jashtë vendit. Gjithashtu, ka mbikëqyrur rritjen e lartë të numrit të ekzekutimeve në Iran, përfshirë ekzekutime të fshehta që nuk u njoftuan nga qeveria dhe ekzekutime për vepra të lidhura me drogën.	10.10.2011
61.	MOSLEHI Heydar (alias: MOSLEHI Heidar; MOSLEHI Haidar)	Vendlindja: Isfahan (Iran) Datëlindja: 1956	Këshilltar i Jurisprudencës Supreme në IRGC. Shef i organizatës për botime mbi rolin e klerit në luftë. Ish-Ministër i Inteligjencës (2009-2013). Nën udhëheqjen e tij, Ministria e Inteligjencës vazhdoi praktikat e burgimit dhe persekutimit arbitrar të protestuesve dhe disidentëve. Ministria e Inteligjencës drejton Seksionin 209 të Burgut Evin, ku shumë aktivistë janë mbajtur për shkak të aktiviteteve të tyre paqësore kundër qeverisë. Hetuesit e Ministrisë së Inteligjencës kanë rrahur dhe kanë ushtruar abuzim mendor dhe seksual ndaj të burgosurve në Seksionin 209.	10.10.2011
62.	ZARGHAMI Ezzatollah	Vendlindja: Dezful (Iran) Datëlindja: 22 korrik 1959	Anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike dhe Këshillit të Revolucionit Kulturor. Ish Shefi i Transmetimeve të Republikës Islamike të Iranit (IRIB) deri në nëntor 2014. Gjatë mandatit të tij në IRIB, ishte përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. IRIB ka transmetuar pranime të detyruara faji prej të paraburgosurve dhe një seri "gjyqesh të montuara" në gusht 2009 dhe dhjetor 2011. Këto përbëjnë një shkelje të qartë të dispozitave ndërkombëtare për gjykimin e drejtë dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.	23.3.2012
63.	TAGHIPOUR Reza	Vendlindja: Maragheh (Iran) Datëlindja: 1957	Anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike. Anëtar i Këshillit të Qytetit të Teheranit. Ish-Ministër për Informimin dhe Komunikimet (2009-2012). Si Ministër për Informimin, ishte një nga zyrtarët më të lartë të ngarkuar me censurimin dhe kontrollin e veprimtarive të internetit dhe gjithashtu të gjitha llojet e komunikimeve (në veçanti telefonat celular). Gjatë	23.3.2012

			marrjes në pyetje të të paraburgosurve politikë, hetuesit përdorin të dhënat personale të të burgosurve, postën dhe komunikimet. Në disa raste pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2009 dhe gjatë demonstratave në rrugë, linjat celulare dhe mesazhet me tekst u bllokuan, edhe kanalet televizive satelitore dhe interneti në Iran u ndërpre ose të paktën u ngadalësua.	
64.	KAZEMI Toraj		Shefi i divizionit të Teheranit të Madh të Policisë Kibernetike të caktuar nga BE. Në këtë cilësi, ai shpalli një fushatë për rekrutimin e hakerëve qeveritarë në mënyrë që të arrijë kontroll më të mirë të informacionit në internet dhe të sulmojë faqet "e rrezikshme".	23.3.2012
69.	MORTAZAVI Seyyed Solat	Vendlindja: Farsan, Tchar Mahal-o-Bakhtiari (Jug) – (Iran) Datëlindja: 1967	Kryebashkiak i qytetit të dytë më të madh të Iranit, Mashhad, ku ekzekutimet publike ndodhin rregullisht. Ish-zv.Ministër i Brendshëm për Çështjet Politike, i emëruar në 2009. Në këtë cilësi, ai ishte përgjegjës për drejtimin e shtypjes së personave që flisnin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes. Më vonë u emërua Kryetar i Komitetit Zgjedhor Iranian për zgjedhjet parlamentare në 2012 dhe për zgjedhjet presidenciale në 2013.	23.3.2012
73.	FARHADI Ali		Prokuror i Karajt. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjykime në të cilat u dha dënimi me vdekje. Gjatë periudhës kur ishte prokuror, në rajonin Karaj pati një numër të lartë ekzekutimesh.	23.3.2012

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2017/689
i datës 11 prill 2017
që ndryshon Vendimin 2011/235/PPJS për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/(PPJS).[1]

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2011/235/PPJS, masat shtrënguese e parashikuara në të duhet të ripërtërihen deri më 13 prill 2018.

(3) Këshilli vendosi edhe se të dhënat për disa persona të përfshirë në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS duhet të përditësohen.

(4) Vendimi 2011/235/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Neni 6, pika 2 e Vendimit 2011/235/PPJS zëvendësohet me pikën më poshtë:

"2. Ky Vendim zbatohet deri më 13 prill 2018 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

Neni 2

Shtojca e Vendimit 2011/235/PPJS ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 11 prill 2017.

Për Këshillin
Presidenti
L. GRECH

---

[1] Vendimi i Këshillit 2011/235/PPJS i datës 12 prill 2011 për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (GZ) L 100, 14.4.2011, fq. 51).

SHTOJCA

Shënimet e mëposhtme zëvendësojnë shënimet në lidhje me personat e renditur më poshtë, të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2011/235 / CFSP.

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
20.	MOGHISSEH Mohammad (a.k.a. NASSERIAN)		Gjykatës, Shefi i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 28. Gjithashtu konsiderohet përgjegjës për dënimet e anëtarëve të komunitetit Bahá'í. Ai është marrë me çështje paszgjedhore. Ai lëshoi dënime të gjata me burg gjatë gjykimeve të padrejta për aktivistët socialë, politikë dhe gazetarë dhe disa dënime me vdekje për protestuesit dhe aktivistët socialë dhe politikë.	12.4.2011
22.	MORTAZAVI Said	Vendlindja: Meybod, Yazd (Iran) Datëlindja: 1967 Gjinia: mashkull	Ish Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit deri në gusht 2009. Si Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit, ka lëshuar urdhër të përgjithshëm të përdorur për ndalimin e qindra aktivistëve, gazetarëve dhe studentëve. Në janar 2010, një hetim parlamentar e konsideroi përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për ndalimin e tre të burgosurve që vdiqën më pas në paraburgim. U pezullua nga detyra në gusht 2010 pas një hetimi të drejtësisë iraniane për rolin e tij në vdekjen e tre personave të ndaluar me urdhër të tij pas zgjedhjeve. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjet e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane. U shpall i pafajshëm nga Gjykata Iraniane më 19 gusht 2015, nga akuzat lidhur me torturën dhe vdekjen e tre të rinjve në qendrën e paraburgimit të Kahrizak në 2009.	12.4.2011
23.	PIR-ABASSI Abbas	Gjinia: mashkull	Magjistrat i një Kolegji Penal. Ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ishte përgjegjës për çështjet paszgjedhore. Dha dënime të gjata me burg gjatë gjykimeve të padrejta kundër aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe disa dënime me vdekje për protestuesit.	12.4.2011
25.	SALAVATI Abdolghassem	Gjinia: mashkull	Gjyqtar, Kryetari i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 15. Gjyqtar i komanduar në Gjykatën e Teheranit. Kryesoi gjykimin e çështjeve paszgjedhore, në gjyqet e montuara të verës 2009; dënoi me vdekje dy monarkistë. Dënoi mbi njëqind të burgosur politikë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe demonstrues me dënime të gjata me burg.	12.4.2011
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmoud	Gjinia: mashkull	Këshilltar i Këshillit të Iranit për të Drejtat e Njeriut.. Ish-guvernator i Provincës Ilam. Ish-drejtor politik në Ministrinë e Brendshme. Si Kryetar i Komisionit të Nenit 10 të Ligjit për Veprimtaritë e Partive	10.10.2011

			dhe Grupeve Politike, ishte përgjegjës për autorizimin e demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike dhe regjistrimin e partive politike. Në vitin 2010, pezulloi aktivitetet e dy partive politike reformiste të lidhura me Mousavin - Frontin e Pjesëmarrjes në Iranin Islamik dhe Organizatën e Muxhahedinë të Revolucionit Islamik. Nga viti 2009 e më tej, ka ndaluar vazhdimisht të gjitha tubimet joqeveritare, duke mohuar kështu një të drejtë kushtetuese për të protestuar dhe duke çuar në shumë arrestime të demonstruesve paqësorë në kundërshtim me të drejtën për lirinë e tubimit. Në 2009, gjithashtu i mohoi opozitës lejen për ceremoninë e zisë për personat që u vranë në protestat për zgjedhjet presidenciale.	
35.	AKHARIAN Hassan	Gjinia: mashkull	Ish Administrator i seksionit I të burgut Radjaishahr, Karadj. Disa ish të paraburgosur kanë denoncuar se ai përdorte tortura dhe jepte urdhra që u mohonin atyre marrjen e ndihmës mjekësore. Sipas raportimit të një të burgosuri në burgun Radjaishahr, të gjithë rojet e rrihnin rëndë, me dijeninë e plotë të Akharian. Raportohet edhe të paktën një rast rrahjeje e rëndë të një të paraburgosuri që rezultoi në vdekjen e tij, Mohsen Beikvand, nën administrimin e Akharian.	10.10.2011
36.	AVAEE Seyyed Ali-Reza (alias AVAEE Seyyed Alireza, AVAIE Alireza)	Gjinia: mashkull	Drejtor i zyrës të hetimeve të posaçme. Zv.Ministër i Brendshëm dhe Kryetar i Regjistrit Publik deri në korrik 2016. Këshilltar pranë Gjykatës Disiplinore për Gjyqtarët që nga prilli 2014. Ish-Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit. Si Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit, ka qenë përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut, arrestime arbitrare, mohim të të drejtave të të burgosurve si dhe një numër të lartë ekzekutimesh.	10.10.2011
38.	FIRUZABADI Maj-Gen Dr Seyyed Hasan (alias: FIRUZABADI Maj-Gen Dr Seyed Hassan; FIROUZABADI Maj-Gen Dr Seyyed Hasan; FIROUZABADI Maj-Gen Dr Seyed Hassan)		Si ish Shef i Forcave të Armatosura të Iranit ishte komandanti ushtarak më i lartë përgjegjës për të gjitha divizionet dhe politikat ushtarake, përfshirë edhe IRGC-në dhe policinë. Forcat nën zinxhirin e komandës së tij shtypën mizorisht protestuesit paqësorë dhe ndoqën burgime abuzive. Gjithashtu anëtar i Këshillit Suprem të Sigurisë Kombëtare dhe i Këshillit të Përshtatshmërisë.	10.10.2011
39.	GANJI Mostafa Barzegar	Gjinia: Mashkull	Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Qomit. Mundësisht duke marrë një funksion tjetër. Përgjegjës për paraburgimin arbitrar dhe keqtrajtimin e dhjetëra shkelësve në Qom. Ka qenë bashkëpunëtor në një shkelje të rëndë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në	10.10.2011

			dhënien e tepruar dhe në rritje të dënimit me vdekje dhe rritjen e lartë të ekzekutimeve që në fillim të vitit.	
40.	HABIBI Mohammad Reza	Gjinia: mashkull	Kryetar i Zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd. Ish- Zv.Prokuror i Isfahanit. Mundësisht duke marrë një funksion tjetër. Bashkëpunëtor në procedura që mohojnë gjykimin e drejtë të të pandehurve – si psh. Abdollah Fathi, ekzekutuar në maj 2011 pasi e drejta për t'u dëgjuar dhe problemet me shëndetin mendor u injoruan nga Habibi gjatë gjykimit të tij në mars 2010. Kështu, ishte bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në një rritje të lartë të ekzekutimeve në vitin 2011.	10.10.2011
41.	HEJAZI Mohammad	Vendlindja: Ispahan Datëlindja: 1956 Gjinia: mashkull	Gjeneral në Pasdaran, ka luajtur rol kryesor në intimidimin dhe kërcënimin e "armiqve" të Iranit dhe bombardimin e fshatrave irakene kurde. Ish-Shef i Trupave Sarollah të IRGC-së në Teheran dhe ish-Shef i Forcave Basij, luajti rol qendror në shtypjen pas-zgjedhore të protestuesve.	10.10.2011
46.	KAMALIAN Behrouz (alias Hackers Brain, Behrooz_Ice)	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1983 Gjinia: mashkull	Kreu i IRGC- i lidhur me grupin kibernetik 'Ashiyaneh'. Siguria Dixhitale 'Ashiyaneh', themeluar nga Behrouz Kamalian, është përgjegjëse për sulme të shumta kibernetike si ndaj kundërshtarëve vendas, ashtu edhe ndaj reformatorëve dhe institucioneve të huaja. Më 21 qershor 2009, faqja e internetit e Komandës së mbrojtjes kibernetike të rojes revolucionare 32 postoi pamje të fytyrave të 26 personave, që dyshohet se janë marrë gjatë demonstratave paszgjedhore. Bashkangjitur ishte një thirrje për iranianët "për të identifikuar protestuesit".	10.10.2011
49.	MALEKI Mojtaba	Gjinia: mashkull	Zv.Ministër i Drejtësisë në provincën Khorasan Razavi. Ish-prokuror i Kermanshah. Ka luajtur rol në numrin e lartë të dënimeve me vdekje që janë dhënë në Iran, duke përfshirë ndjekjen penale të çështjeve të shtatë të burgosurve të dënuar për trafik droge të cilët u varën në të njëjtën ditë më 3 janar 2010 në burgun qendror të Kermanshah.	10.10.2011
51.	SALARKIA Mahmoud	Gjinia: mashkull Ish-drejtor i klubit të futbollit të Teheranit "Persepolis"	Ish-Shef i Komisionit të Naftës dhe Transportit i qytetit të Teheranit. Zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve gjatë shtypjes së vitit 2009. Si zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve, ishte drejtpërdrejt përgjegjës për shumë urdhra arresti ndaj protestuesve dhe aktivistëve të pafajshëm dhe paqësorë.	10.10.2011

			Shumë raporte nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut tregojnë se pothuajse të gjithë të arrestuarit u burgosën, sipas urdhrave të tij, pa kontaktuar me avokatin dhe familjarët e tyre si dhe pa akuza për periudha të ndryshme, shpesh në kushte që shkonin deri në zhdukje me forcë. Familjet e tyre shpesh nuk janë njoftuar për arrestimin.	
53.	TALA Hossein (alias TALA Hosseyn)	Gjinia: mashkull	Ish-deputet iranian. Ish-Guvernator i Përgjithshëm ('Farmandar') i Provincës Teheran deri në shtator 2010; ishte përgjegjës për ndërhyrjen e forcave të policisë dhe rrjedhimisht për shtypjen e demonstratave. Mori çmim në dhjetor 2010 për rolin e tij në shtypjen e protestave paszgjedhore.	10.10.2011
56.	BAHRAMI Mohammad-Kazem	Gjinia: mashkull	Kryetar i gjykatës së drejtësisë administrative. Ka qenë bashkëpunëtor në shtypjen e demonstruesve paqësorë si kreu i degës së gjyqësorit të forcave të armatosura.	10.10.2011
73.	FARHADI Ali	Gjinia: mashkull	Zv.Shef i Inspektoratit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektimit Publik të Ministrisë së Drejtësisë të Teheranit. Prokuror i Karajt. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjykime në të cilat u dha dënimi me vdekje. Gjatë periudhës kur ishte prokuror, në rajonin Karaj pati një numër të lartë ekzekutimesh.	23.3.2012
74.	REZVANMA-NESH Ali	Gjinia: mashkull	Zëvendës prokuror i provincës Karaj, rajoni i Alborz. Përgjegjës për shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut dhe përfshirje në ekzekutimin e një të mituri.	23.3.2012
76.	SADEGHI Mohamed	Gjinia: mashkull	Kolonel dhe Zëvendës i inteligjencës teknike dhe kibernetike të IRGC-së dhe përgjegjës i qendrës së analizës dhe luftës kundër krimit të organizuar brenda Pasdaran. Përgjegjës për arrestimet dhe torturat e blogerëve / gazetarëve.	23.3.2012
79.	RASHIDI AGHDAM Ali Ashraf	Gjinia: mashkull	Ish-drejtori i burgut Evin i caktuar në mes të 2012. Gjatë mandatit të tij, kushtet në burg u përkeqësuan dhe raportet referuan keqtrajtim të intensifikuar të të burgosurve. Në tetor 2012, nëntë të burgosura femra hynë në grevë urie në protestë për shkeljen e të drejtave të tyre dhe trajtimin e dhunshëm nga rojet e burgut.	12.3.2013
82.	SARAFRAZ Mohammad (Dr.) (alias Haj-agha	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: rreth 1963	Anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike. Ish-Kryetar i Transmetimeve të Republikës Islamike të Iranit (IRIB) Ish-Shef i	12.3.2013

	Sarafraz)	Vendbanimi: Teheran Gjinia: mashkull	Shërbimit Botëror të IRIB dhe Press TV, përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. I lidhur ngushtë me aparatin e sigurimit të shtetit. Nën drejtimin e tij Press TV, së bashku me IRIB, ka punuar me shërbimet e sigurimit dhe prokurorët iranianë për të transmetuar pranime të detyruara faji të të paraburgosurve, përfshirë atë të gazetarit dhe kineastit iraniano-kanadez Maziar Bahari, në programin e përjavshëm të 'Irani Sot'. Rregullatori i pavarur i transmetimit OFCOM gjobiti Press TV në Mbretërinë e Bashkuar 100 000 GBP për transmetimin e rrëfimit të Baharit në 2011, i cili u filmua në burg ndërsa Bahari ishte në burgim të paligjshëm. Prandaj, Sarafraz identifikohet me shkeljen e të drejtës për proces të rregullt ligjor dhe gjykim të drejtë.	
86.	MUSAVI-TABAR Seyyed Reza	Gjinia: mashkull	Ish-kryetar i Prokurorisë Revolucionare të Shirazit. Përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe keqtrajtim të aktivistëve politikë, gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, Baháíve dhe të burgosurve të ndërgjegjes, të cilët u intimiduan, u torturuan, u morën në pyetje dhe iu mohua e drejta për avokat dhe procesi i rregullt ligjor. Musavi-Tabar nënshkroi urdhra gjyqësorë në burgun famëkeq nr. 100 (për burra), përfshirë urdhrin për ta mbajtur të burgosurën Bahai Raha Sabet për tre vjet në izolim.	12.3.2013

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2018/568
i datës 12 prill 2018
që ndryshon Vendimin 2011/235/PPJS për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/(PPJS).[1]

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2011/235/PPJS, masat shtrënguese e parashikuara në të duhet të ripërtërihen deri më 13 prill 2019.

(3) Këshilli vendosi edhe se të dhënat për 29 persona dhe një subjekt të përfshirë në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS duhet të përditësohen.

(4) Vendimi 2011/235/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/235/PPJS ndryshohet si vijon:

(1) Neni 6, pika 2 e Vendimit 2011/235/PPJS zëvendësohet me pikën më poshtë:
"2. Ky Vendim zbatohet deri më 13 prill 2019 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

(2) Shtojca ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Luksemburg, më 12 prill 2018.

Për Këshillin
Presidenti
T. DONCHEV

---

[1] Vendimi i Këshillit 2011/235/PPJS i datës 12 prill 2011 për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (GZ) L 100, 14.4.2011, fq. 51).

SHTOJCA

Shënimet e mëposhtme zëvendësojnë shënimet përkatëse në listën e personave dhe subjekteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2011/235 / CFSP:

Personat

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	AHMADI-MOQADDAM Esmail	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1961	Ish-Këshilltar i Lartë për Çështjet e Sigurisë për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shef i Policisë Kombëtare të Iranit nga 2005 deri në fillim të 2015. Gjithashtu Shef i Policisë Kibernetike Iraniane (të listuar) nga janari 2011 deri në fillim të 2015. Forcat nën komandën e tij drejtuan sulme mizore në protesta paqësore dhe një sulm të dhunshëm gjatë natës në konviktet e Universitetit të Teheranit më 15 qershor 2009. Ish-shef i Shtabit të Iranit në mbështetje të Popullit Jemenas.	12.4.2011
3.	ARAGHI (ERAGHO) Abdollah		Ish Zëvendës Shefi i Forcave Tokësore të IRGC. Ai kishte një përgjegjësi të drejtpërdrejtë dhe personale në goditjen e protestave gjatë gjithë verës së vitit 2009.	12.4.2011
9.	NAQDI Mohammad-Reza	Vendlindja: Najaf (Irak) Datëlindja: rreth 1952	Zëvendës Shefi i IRGC për çështjet kulturore dhe shoqërore. Ish-komandant i Basijit. Si komandant i Forcave Basij të IRGC-së, Naqdi ishte përgjegjës ose bashkëpunëtor në abuzimet e Basij-ut që ndodhën në fund të vitit 2009, duke përfshirë përgjigjen e dhunshme ndaj protestave të Dhjetorit 2009 të Ditës së Ashura, e cila rezultoi në deri në 15 vdekje dhe arrestime të qindra protestuesve. Para emërimit të tij si komandant i Basij-it në tetor 2009, Naqdi ishte kreu i njësisë së inteligjencës së Basij-it përgjegjës për marrjen në pyetje të të arrestuarve gjatë goditjes pas-zgjedhore.	12.4.2011
10.	RADAN Ahmad-Reza	Vendlindja: Isfahan (Iran) Datëlindja: 1963	Shefi i Qendrës për Studime Strategjike të Forcës Iraniane të Zbatimit të Ligjit, një organ i lidhur me Policinë Kombëtare. Zv.Shef i Policisë Kombëtare të Iranit deri në qershor 2014. Si zv.Shef i Policisë Kombëtare nga viti 2008, Radan ishte përgjegjës për rrahjet, vrasjet, dhe arrestimet dhe ndalimet arbitrare të protestuesve nga forcat e policisë. Aktualisht, komandant i IRGC-së i ngarkuar me stërvitjen e forcave "antiterroriste" irakiane.	12.4.2011
11.	RAJABZADEH Azizollah		Shef i Organizatës për Zbutjen e Fatkeqësive Natyrore në Teheran (2010-2013). Si Shef i Policisë së Teheranit deri në janar 2010, ishte përgjegjës për sulmet e dhunshme të policisë ndaj protestuesve dhe	12.4.2011

			studentëve. Si Komandant i Forcave të Zbatimit të Ligjit në Teheranin e Madh, Azizollah Rajabzadeh ishte zyrtari më i lartë i akuzuar për abuzimet në Qendrën e Burgimit të Kahrizak.	
12.	SAJEDI –NIA Hossein		Zëvendëskomandant i Operacioneve të Policisë. Ish shefi i Policisë së Teheranit, ish Zëvendës Shefi i Policisë Kombëtare të Iranit përgjegjës për Operacionet e Policisë Ai është përgjegjës për koordinimin, për Ministrinë e Brendshme, të operacioneve të shtypjes në kryeqytetin iranian.	12.4.2011
13.	TAEB Hossein	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1963	Shefi i Inteligjencës IRGC. Ish Zëvendës komandant i IRGC-së për inteligjencën. Ish Komandanti i Basij-it deri në Tetor 2009. Forcat nën komandën e tij morën pjesë në rrahje masive, vrasje, ndalime dhe tortura të protestuesve paqësorë.	12.4.2011
16.	HADDAD Hassan (alias Hassan ZAREH DEHNAVI)		Ish-zv.Kryetar i Sigurisë i Gjykatës Revolucionare të Teheranit. Ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ishte përgjegjës për çështjet e të paraburgosurve në lidhje me krizat paszgjedhore dhe kërcënonte rregullisht familjet e të paraburgosurve për t'ua mbyllur gojën. Ka qenë vendimtar në lëshimin e urdhrave të paraburgimit në Qendrën e Burgimit në Kahrizak në 2009. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjen e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane.	12.4.2011
21.	MOHSENI-EJEI Gholam-Hossein	Vendlindja: Ejiyeh Datëlindja: rreth 1956	Anëtar i Këshillit të Përshtatshmërisë. Prokurori i Përgjithshëm i Iranit që nga shtatori 2009 dhe Zëvendës Shefi dhe Zëdhënësi i Gjyqësorit. Ish-ministri i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009. Ndërsa ai ishte ministër i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009, agjentët e inteligjencës nën komandën e tij ishin përgjegjës për ndalimin, torturimin dhe nxjerrjen e rrëfimeve të rreme nën presionin e qindra aktivistëve, gazetarëve, disidentëve dhe politikanëve reformistë. Për më tepër, figurat politike u detyruan të bënin rrëfime të rreme nën marrje në pyetje të padurueshme, të cilat përfshinin tortura, abuzime, shantazhe dhe kërcënime ndaj anëtarëve të familjes.	12.4.2011
26.	SHARIFI Malek Adjar (aka: SHARIFI Malek Ajdar)		Gjyqtar në Gjykatën e Lartë, shefi i seksionit të 43-të. Ish Shefi i Gjyqësorit të Azerbajxhanit Lindor. Ai ishte përgjegjës për gjyqin e Sakineh Mohammadi-Ashtiani.	12.4.2011
28.	YASAGHI Ali-Akbar		Gjyqtar i Gjykatës së Lartë, shef i seksionit të 44-të. Zv.Drejtor i Fondacionit Setad-e Dieh. Kryetar i Gjykatës Revolucionare e Mashhad (2001-2011). Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuara dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë.	12.4.2011

			Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	
32.	ZANJIREI Mohammad-Ali		Këshilltar i lartë i Shefit dhe ish Zëvendës Shef i Organizatës së Burgjeve të Iranit, përgjegjës për abuzimet dhe privimin e të drejtave në qendrën e paraburgimit. Ai urdhëroi transferimin e shumë të burgosurve në izolim.	12.4.2011
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmoud		Këshilltar i Këshillit për të Drejtat e Njeriut. Ish sekretari i Këshillit të të Drejtave të Njeriut. Ish guvernatori i Provincës Ilam. Ish-drejtori politik i Ministrisë së Brendshme. Si Shef i Komisionit të Nenit 10 të Ligjit për Aktivitetet e Partive dhe Grupeve Politike ai ishte përgjegjës për autorizimin e demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike dhe regjistrimin e partive politike.	10.10.2011
34.	AKBARSHAHI Ali-Reza		Ish Drejtori i Përgjithshëm i Shtabit të Kontrollit të Barnave në Iran (aka: Shtabi Anti-Narkotik). Ish Komandant i Policisë së Teheranit. Nën udhëheqjen e tij, forca policore ishte përgjegjëse për përdorimin e forcës jashtëgjyqësore ndaj të dyshuarve gjatë arrestimit dhe paraburgimit. Policia e Teheranit ishte gjithashtu e implikuar në bastisjet në konviktet e universitetit të Teheranit në qershor 2009, kur sipas një komisioni të Iranit Majlis, më shumë se 100 studentë u plagosën nga policia dhe Basiji. Aktualisht shef i policisë hekurudhore.	10.10.2011
36.	AVAEE Seyyed Ali-Reza (alias AVAEE Seyyed Alireza, AVAIE Alireza)		Ministër i Drejtësisë. Ish-drejtor i zyrës të hetimeve të posaçme. Zv.Ministër i Brendshëm dhe Kryetar i Regjistrit Publik deri në korrik 2016. Këshilltar pranë Gjykatës Disiplinore për Gjyqtarët që nga prilli 2014. Ish-Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit. Si Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit, ka qenë përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut, arrestime arbitrare, mohim të të drejtave të të burgosurve si dhe një numër të lartë ekzekutimesh.	10.10.2011
40.	HABIBI Mohammad Reza		Kryetar i Zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd. Ish- Zv.Prokuror i Isfahanit. Bashkëpunëtor në procedura që mohojnë gjykimin e drejtë të të pandehurve – si psh. Abdollah Fathi, ekzekutuar në maj 2011 pasi e drejta për t'u dëgjuar dhe problemet me shëndetin mendor u injoruan nga Habibi gjatë gjykimit të tij në mars 2010. Kështu, ishte bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në një rritje të lartë të ekzekutimeve në vitin 2011.	10.10.2011
45.	JOKAR Mohammad Saleh		Zv. për Çështjet Parlamentare të Gardave Revolucionare. Në periudhën 2011 deri 2016, deputet parlamentar për Provincën e Yazd dhe anëtar i	10.10.2011

			Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme. Ish-Komandant i Forcave Studentore të Basijt. Në këtë rol, ishte i përfshirë në mënyrë aktive në shtypjen e protestave dhe indoktrinimin e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim të shtypjes së vazhdueshme të fjalës së lirë dhe disidencës. Si Anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme, mbështeti publikisht shtypjen e opozitës ndaj qeverisë.	
48.	MAHSOULI Sadeq (aka: MAHSULI Sadeq)	Vendlindja: Oroumieh (Iran) Datëlindja: 1959/60	Këshilltar i ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe anëtar aktual i Këshillit të Përvojës dhe Zëvendës Shef i Frontit të Këmbënguljes. Ministër i Mirëqenies dhe Sigurimeve Shoqërore midis 2009 dhe 2011. Ministër i Brendshëm deri në Gusht 2009. Si Ministër i Brendshëm, Mahsouli kishte autorizim mbi të gjitha forcat e policisë, agjentët e sigurimit të ministrisë së brendshme dhe agjentët e rrobave civile. Forcat nën drejtimin e tij ishin përgjegjëse për sulmet ndaj konvikteve të Universitetit të Teheranit në 14 qershor 2009 dhe torturat e studentëve në bodrumin e Ministrisë (niveli famëkeq i bodrumit 4). Protestues të tjerë u abuzuan rëndë në Qendrën e Paraburgimit Kahrizak, e cila operohej nga policia nën kontrollin e Mahsouli.	10.10.2011
50.	OMIDI Mehrdad (alias: Reza; OMIDI Reza)		Shef i seksionit VI të policisë, departamenti i hetimeve. Ish-Shef i Shërbimeve të Inteligjencës në Policinë Iraniane. Ish-Shef i Njësisë së Krimeve Kompjuterike të Policisë Iraniane. Ka qenë përgjegjës për mijëra hetime dhe padi ndaj reformistëve dhe kundërshtarëve politikë duke përdorur internetin. Po kështu, ka qenë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në shtypjen e personave që flasin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes.	10.10.2011
51.	SALARKIA Mahmoud	Gjinia: mashkull Ish-drejtor i klubit të futbollit të Teheranit "Persepolis"	Ish-Shef i Komisionit të Naftës dhe Transportit i qytetit të Teheranit. Zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve gjatë shtypjes së vitit 2009. Si zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve, ishte drejtpërdrejt përgjegjës për shumë urdhra arresti ndaj protestuesve dhe aktivistëve të pafajshëm dhe paqësorë. Shumë raporte nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut tregojnë se pothuajse të gjithë të arrestuarit u burgosën, sipas urdhrave të tij, pa kontaktuar me avokatin dhe familjarët e tyre si dhe pa akuza për periudha të ndryshme, shpesh në kushte që shkonin deri në zhdukje me forcë. Familjet e tyre shpesh nuk janë njoftuar për arrestimin.	10.10.2011
53.	TALA Hossein (aka: TALA Hosseyn)		Kryetari i Komunës së Eslamshahr. Ish deputet iranian. Ish Guvernatori i Përgjithshëm ('Farmandar') i Provincës së Teheranit deri në Shtator 2010, ai ishte përgjegjës për ndërhyrjen e forcave të policisë dhe për këtë arsye për shtypjen e demonstratave. Ai mori një çmim në dhjetor 2010 për rolin e tij në shtypjen paszgjedhore.	10.10.2011

54.	TAMADDON Morteza (alias TAMADON Morteza)	Vendlindja: Shahr Kord-Isfahan (Iran) Datëlindja: 1959	Ish-Shef i Këshillit Provincial të Sigurisë Publike në Teheran. Ish-Guvernator i Përgjithshëm i IRGC-së në Provincën e Teheranit. Në cilësinë e tij si guvernator dhe kryetar i Këshillit të Sigurisë Publike provinciale të Teheranit, mbante përgjegjësi të përgjithshme për të gjitha aktivitetet shtypëse të ndërmarra nga IRGC në provincën e Teheranit, përfshirë shtypjen e protestave politike që nga qershori 2009. Aktualisht anëtar i bordit në Universitetin e Teknologjisë "Nasireddin Tusi".	10.10.2011
55.	ZEBHI Hossein		Gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Ish Zëvendës i Prokurorit të Përgjithshëm të Iranit. Ai është në krye të disa çështjeve gjyqësore të lidhura me protestat pas-zgjedhore.	10.10.2011
59.	BAKHTIARI Seyyed Morteza	Vendlindja: Mashad (Iran) Datëlindja: 1952	Zëvendës kujdestari i tempullit Imam Reza. Ish Zyrtari i Tribunalit Special Klerikal. Ish Ministri i Drejtësisë nga 2009 në 2013. Gjatë kohës së tij si Ministër i Drejtësisë, kushtet e burgjeve brenda Iranit ranë shumë më poshtë se standardet e pranuara ndërkombëtare, dhe kishte keqtrajtim të përhapur ndaj të burgosurve. Për më tepër, ai luajti një rol kryesor në kërcënimin dhe ngacmimin e diasporës iraniane duke njoftuar krijimin e një gjykate speciale për t'u marrë posaçërisht me iranianët që jetojnë jashtë vendit. Ai gjithashtu mbikëqyri një rritje të mprehtë të numrit të ekzekutimeve në Iran, duke përfshirë ekzekutime të fshehta që nuk u njoftuan nga qeveria, dhe ekzekutime për vepra të lidhura me drogën.	10.10.2011
60.	HOSSEINI Dr Mohammad (alias HOSSEYNI, Dr Seyyed Mohammad; Seyed, Sayyed and Sayyid)	Vendlindja: Rafsanjan, Kerman (Iran) Datëlindja: 1961	Këshilltar i ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe zëdhënës i YEKTA, një fraksion politik i vijës së ashpër. Ministër i i Kulturës dhe Direktivave Islamik (2009– 2013). Si ish-IRGC, ishte bashkëpunëtor në shtypjen e gazetarëve.	10.10.2011
69.	MORTAZAVI Seyyed Solat	Vendlindja: Farsan, Tchar Mahal-o-Bakhtiari (Jug) – (Iran) Datëlindja: 1967	Ish kryetari i qytetit të dytë më të madh të Iranit, Mashad, ku ekzekutimet publike ndodhin rregullisht. Ish Zëvendës Ministri i Brendshëm për Çështjet Politike. Ai ishte përgjegjës për drejtimin e shtypjes së personave që flisnin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes. Më vonë u emërua si Kryetar i Komitetit Zgjedhor Iranian për zgjedhjet parlamentare në 2012 dhe për zgjedhjet presidenciale në 2013.	23.3.2012
73.	FARHADI Ali		Zv.Shef i Inspektoratit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektimit Publik të Ministrisë së Drejtësisë të Teheranit. Ish-prokuror i Karajt. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjykime në të cilat u dha dënimi me vdekje. Gjatë periudhës kur ishte prokuror, në rajonin Karaj pati një numër të lartë ekzekutimesh.	23.3.2012

75.	RAMEZANI Gholamhossein		Që nga viti 2011 Shefi i Inteligjencës së Ministrisë së Mbrojtjes; nga nëntori 2009 deri në mars 2011: Komandanti i Inteligjencës së Pasdaranit; nga marsi 2008 deri në nëntor 2009: Zëvendës komandant i Inteligjencës së Pasdaranit; nga prilli 2006 deri në mars 2008: Shefi i Mbrojtjes dhe Inteligjencës së Pasdaranit. Përfshirë në shtypjen e lirisë së shprehjes, përfshirë këtu duke qenë të lidhur me ata që ishin përgjegjës për arrestimet e blogerëve / gazetarëve në 2004, dhe raportuan se kishin një rol në shtypjen e protestave paszgjedhore në 2009.	23.3.2012
82.	SARAFRAZ Mohammad (Dr) (aka: Haj-agha Sarafraz)	Vendlindja: Tehran Datëlindja: 1963 Vendi i punës: IRIB dhe PressTV Selia, Teheran	Ish-anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike. Ish Presidenti i Transmetimeve të Republikës Islamike të Iranit (IRIB). Ish Shefi i Shërbimit Botëror të IRIB dhe Press TV, përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. Lidhur ngushtë me aparatin e sigurimit të shtetit. Nën drejtimin e tij Press TV, së bashku me IRIB, ka punuar me shërbimet e sigurimit dhe prokurorët iranianë për të transmetuar rrëfime të detyruara të të arrestuarve, duke përfshirë atë të gazetarit iraniano-kanadez dhe prodhuesit të filmit Maziar Bahari, në programin javor Iran Today '. Rregullatori i pavarur i transmetimit OFCOM gjobiti Press TV në Mbretërinë e Bashkuar 100 000 GBP për transmetimin e rrëfimit të Baharit në 2011, i cili u filmua në burg ndërsa Bahari ishte nën detyrim. Prandaj Sarafraz shoqërohet me shkeljen e së drejtës për proces të rregullt dhe gjykim të drejtë.	12.3.2013

Subjektet

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	Policia Kibernetike	Vendndodhja: Teheran (Iran) Faqja e internetit: http://www.cyberpolice.ir	Policia Kibernetike iraniane e themeluar në janar 2011, është njësi e Policisë së Republikës Islamike të Iranit, e drejtuar nga Vahid Majid. Nga krijimi deri në fillim të vitit 2015, kryesohej nga Esmail Ahmadi-Moqaddam (i listuar). Ahmadi-Moqaddam theksoi se Policia Kibernetike do të ndiqte grupe antirevolucionare dhe disidente që përdorën rrjete sociale të internetit në 2009 për të nxitur protesta kundër rizgjedhjes së presidentit Mahmoud Ahmadinexhad. Në janar 2012, Policia Kibernetike lëshoi udhëzime të reja për internet-kafetë, duke u kërkuar përdoruesve të japin informacione personale që do të mbaheshin nga pronarët e kafeneve për gjashtë muaj, si dhe listën e faqeve të internetit që kanë vizituar. Rregullat kërkojnë edhe që pronarët e kafeneve të instalojnë kamera televizive me qark të mbyllur dhe të mbajnë	12.3.2013'

			regjistrimet për gjashtë muaj. Këto rregulla të reja mund të krijojnë një regjistër që autoritetet ta përdorin për të gjurmuar aktivistët ose këdo që cilësohet kërcënim për sigurinë kombëtare. Në qershor 2012, media iraniane njoftoi se Policia Kibernetike do të mbyllte rrjetet private virtuale (VPN). Më 30 tetor 2012, Policia Kibernetike arrestoi blogerin Sattar Beheshti pa mandat për 'veprime kundër sigurisë kombëtare në rrjetet sociale dhe Facebook'. Beheshti kishte kritikuar qeverinë iraniane në blogun e tij. Beheshti u gjet i vdekur në qelinë e burgut më 3 nëntor 2012 dhe besohet se është torturuar për vdekje nga autoritetet e Policisë Kibernetike.	

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2019/562
i datës 8 prill 2018
që ndryshon Vendimin 2011/235/PPJS për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/(PPJS).[1]

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2011/235/PPJS, masat shtrënguese e parashikuara në të duhet të ripërtërihen deri më 13 prill 2020.

(3) Këshilli vendosi edhe se të dhënat për 51 persona dhe një subjekt të përfshirë në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS duhet të përditësohen.

(4) Vendimi 2011/235/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/235/PPJS ndryshohet si vijon:

(1) Neni 6, pika 2 e Vendimit 2011/235/PPJS zëvendësohet me pikën më poshtë:
"2. Ky Vendim zbatohet deri më 13 prill 2020 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

(2) Shtojca ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Luksemburg, më 8 prill 2019.

Për Këshillin
Presidenti
F. MOGHERINI

---

[1] Vendimi i Këshillit 2011/235/PPJS i datës 12 prill 2011 për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (GZ) L 100, 14.4.2011, fq. 51).

SHTOJCA

Personat

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	AHMADI-MOQADDAM Esmail	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1961	Ish-Këshilltar i Lartë për Çështjet e Sigurisë për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shef i Policisë Kombëtare të Iranit nga 2005 deri në fillim të 2015. Gjithashtu Shef i Policisë Kibernetike Iraniane (të listuar) nga janari 2011 deri në fillim të 2015. Forcat nën komandën e tij drejtuan sulme mizore në protesta paqësore dhe një sulm të dhunshëm gjatë natës në konviktet e Universitetit të Teheranit më 15 qershor 2009. Ish-shef i Shtabit të Iranit në mbështetje të Popullit Jemenas.	12.4.2011
2	ALLAHKARAM Hossein	Vendlindja: Najafabad (Iran) Datëlindja: 1945	Shefi i Këshillit të Koordinimit Ansar-e Hezbollah dhe ish-gjeneral i IRGC-së. Bashkëthemeloi Ansar-e Hezbollah. Kjo forcë paramilitare ishte përgjegjëse për dhunën ekstreme gjatë shtypjes së protestave të studentëve dhe universiteteve në 1999, 2002 dhe 2009. Mban post të lartë në një organizatë e cila është e gatshme të kryejë shkelje të të drejtave të njeriut kundër publikut, përfshirë nxitjen e agresionit ndaj grave për zgjedhjen e tyre të veshjeve.	12.4.2011
4.	FAZLI Ali		Zëvendëskomandanti i Basijut, Shefi i Korpusit Seyyed al-Shohada të IRGC-së, Provinca e Teheranit (deri në Shkurt 2010). Korpusi Seyyed al-Shohada është përgjegjës për sigurinë në provincën Teheran dhe luajti një rol kryesor në shtypjen brutale të protestuesve në 2009.	12.4.2011
7	KHALILI Ali		Gjenerali i IRGC-së, me rol të lartë brenda Bazës Sarollah. Nënshkroi një letër dërguar Ministrisë së Shëndetësisë më 26 qershor 2009, duke ndaluar dorëzimin e dokumenteve ose të dhënave mjekësore për cilindo të plagosur ose të shtruar në spital gjatë ngjarjeve paszgjedhore.	12.4.2011
8.	MOTLAGH Bahram Hosseini		Pjesëtar i stafit mësimdhënës në Universitetin "Imam Hussein" (Gardianët e Revolucionit). Ish-Shef i Komandës së Ushtrisë dhe Kolegjit të Shtabit të Përgjithshëm (DAFOOS). Ish-Shef i Korpusit Seyyed al-Shohada të IRGC-së, Provinca e Teheranit. Korpusi Seyyed	12.4.2011

			al-Shohada luajti rol kryesor në organizimin e shtypjes së protestës në 2009.	
10.	RADAN Ahmad-Reza	Vendlindja: Isfahan (Iran) Datëlindja: 1963	Shefi i Qendrës për Studime Strategjike të Forcës Iraniane të Zbatimit të Ligjit, një organ i lidhur me Policinë Kombëtare. Zv.Shef i Policisë Kombëtare të Iranit deri në qershor 2014. Si zv.Shef i Policisë Kombëtare nga viti 2008, Radan ishte përgjegjës për rrahjet, vrasjet, dhe arrestimet dhe ndalimet arbitrare të protestuesve nga forcat e policisë. Aktualisht, komandant i IRGC-së i ngarkuar me stërvitjen e forcave "antiterroriste" irakiane.	12.4.2011
11.	RAJABZADEH Azizollah		Ish-Shef i Organizatës për Zbutjen e Fatkeqësive Natyrore në Teheran Si Shef i Policisë së Teheranit deri në janar 2010, ishte përgjegjës për sulmet e dhunshme të policisë ndaj protestuesve dhe studentëve. Si Komandant i Forcave të Zbatimit të Ligjit në Teheranin e Madh, Azizollah Rajabzadeh ishte zyrtari më i lartë i akuzuar për abuzimet në Qendrën e Burgimit të Kahrizak në dhjetor 2009.	12.4.2011
13.	TAEB Hossein	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1963	Shef i organizatës së inteligjencës IRGC që nga tetori 2009. Kompetencat e tij u zgjeruan në maj 2019 me bashkimin e Zyrës së Inteligjencës Strategjike të IRGC me Organizatën e Inteligjencës së IRGC. Komandant i Basij deri në tetor 2009. Forcat nën komandën e tij morën pjesë në rrahjet masive, vrasjet, ndalimet dhe torturimin e protestuesve paqësorë.	12.4.2011
14.	SHARIATI Seyeed Hassan		Këshilltar dhe Anëtar i Seksionit të 28-të të Gjykatës Supreme. Shefi i Gjyqësorit të Mashhad deri në shtator 2014. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuar dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	12.4.2011
15.	DORRI-NADJAFABADI Ghorban-Ali	Vendlindja: Najafabad (Iran) Datëlindja: 1945	Anëtar i Asamblesë së Ekspertëve dhe përfaqësues i Liderit Suprem në Provincën Markazi ('Qendror') dhe Kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative. Prokuror i Përgjithshëm i Iranit deri në shtator 2009, si dhe ish-Ministër i Inteligjencës nën presidencën e Khatamit. Si Prokuror i Përgjithshëm i Iranit, ka urdhëruar dhe mbikëqyrur gjyqet e montuara publike pas protestave të para paszgjedhore, ku të akuzuarve iu mohuan të drejtat për të pasur një avokat.	12.4.2011

16.	HADDAD Hassan (alias Hassan ZAREH DEHNAVI)		Ish-zv.Kryetar i Sigurisë i Gjykatës Revolucionare të Teheranit. Ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ishte përgjegjës për çështjet e të paraburgosurve në lidhje me krizat paszgjedhore dhe kërcënonte rregullisht familjet e të paraburgosurve për t'ua mbyllur gojën. Ka qenë vendimtar në lëshimin e urdhrave të paraburgimit në Qendrën e Burgimit në Kahrizak në 2009. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjen e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane.	12.4.2011
17.	SOLTANI Hodjatoleslam Seyed Mohammad		Kreu i Organizatës për Propagandë Islame në provincën e Khorasan Razavi. Gjyqtar pranë Gjykatës Revolucionare të Mashhad deri në vitin 2013. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuara dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	12.4.2011
18.	HEYDARIFAR Ali-Akbar		Ish-gjyqtar pranë Gjykatës Revolucionare së Teheranit. Mori pjesë në gjyqet e protestuesve. U mor në pyetje nga gjyqësori për abuzimet në Kahrizak. Ishte i rëndësishëm në lëshimin e urdhrave të paraburgimit për dërgimin e të paraburgosurve në Qendrën e Burgimit Kahrizak në 2009. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjen e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane.	12.4.2011
19.	JAFARI-DOLATABADI Abbas	Vendlindja: Yazd (Iran) Datëlindja: 1953	Këshilltar i Gjykatës së Lartë Disiplinore së gjyqtarëve që në 29 prill 2019. Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit (gusht 2009-prill 2019). Zyra e Dolatabadit akuzoi një numër të madh protestuesish, përfshirë individë që morën pjesë në protestat e Ditës së Ashures në dhjetor 2009. Ka urdhëruar mbylljen e zyrës së Karroubit në shtator 2009 dhe arrestimin e disa politikanëve reformistë si dhe ka ndaluar dy parti politike reformiste në qershor 2010. Zyra e tij akuzoi protestuesit për 'Moharebeh', ose 'armiqësi ndaj Zotit', e cila mbart dënim me vdekje, dhe i mohoi procesin e duhur të akuzuarve për dënim me vdekje. Gjithashtu, zyra pati në objektiv dhe arrestoi reformistët, aktivistët për të drejtat e njeriut dhe anëtarët e medias, si pjesë e një goditje të gjerë ndaj opozitës politike. Në tetor 2018, njoftoi në media se katër aktivistë mjedisorë iranianë të arrestuar do të akuzoheshin për 'mbjellje korrupsioni në tokë', akuzë kjo që mbart dënim me vdekje.	12.4.2011

20.	MOGHISSEH Mohammad (a.k.a NASSERIAN)		Gjykatësi, Shefi i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 28. Gjithashtu konsiderohet përgjegjës për dënimet e anëtarëve të komunitetit Bahá'í. Ai është marrë me çështje paszgjedhore. Ai lëshoi dënime të gjata me burg gjatë gjykimeve të padrejta për aktivistët socialë, politikë dhe gazetarë dhe disa dënime me vdekje për protestuesit dhe aktivistët socialë dhe politikë.	12.4.2011
22.	MORTAZAVI Said	Vendlindja: Meybod, Yazd (Iran) Datëlindja: 1967	Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit deri në gusht 2009. Si Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit, ka lëshuar urdhër të përgjithshëm të përdorur për ndalimin e qindra aktivistëve, gazetarëve dhe studentëve. Në janar 2010, një hetim parlamentar e konsideroi përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për ndalimin e tre të burgosurve që vdiqën më pas në paraburgim. U pezullua nga detyra në gusht 2010 pas një hetimi të drejtësisë iraniane për rolin e tij në vdekjen e tre personave të ndaluar me urdhër të tij pas zgjedhjeve. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjet e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane. U shpall i pafajshëm nga Gjykata Iraniane më 19 gusht 2015, nga akuzat lidhur me torturën dhe vdekjen e tre të rinjve në qendrën e paraburgimit të Kahrizak në 2009.	12.4.2011
24.	MORTAZAVI Amir		Zv.Shefi i Njësisë për Çështjet Sociale dhe Parandalimin e Krimit në gjyqësor në provincën e Khorasan-Razavi. Zv.Prokuror i Mashhad deri të paktën 2015. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuara dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	12.4.2011
25.	SALAVATI Abdolghassem		Gjyqtar, Kryetari i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 15. Gjyqtar i komanduar në Gjykatën e Teheranit. Kryesoi gjykimin e çështjeve paszgjedhore, në gjyqet e montuara të verës 2009; dënoi me vdekje dy monarkistë. Dënoi mbi njëqind të burgosur politikë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe demonstrues me dënime të gjata me burg. Në vitin 2018, raportet tregojnë se vazhdoi të jepte dënime të tilla pa respektuar procedurat e procesit të rregullt gjyqësor.	12.4.2011
28.	YASAGHI Ali-Akbar		Gjyqtar i Gjykatës së Lartë, shef i seksionit të 44-të. Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv i Fondacionit Setad-e Dieh. Kryetari i Gjykatës, Gjykata Revolucionare e Mashhad (2001-2011). Gjykimet nën juridiksionin e tij janë kryer në mënyrë të përmbledhur dhe brenda seancave të mbyllura, pa respektimin e të drejtave themelore të të akuzuarit. Ndërsa vendimet	12.4.2011

			e ekzekutimit ishin lëshuar në masë (deri në 550 midis verës 2009 dhe verës 2011), dënimet me vdekje ishin lëshuar pa respektimin e duhur të procedurave të dëgjimit të drejtë.	
30.	ESMAILI Gholam-Hossein		Kryetar i gjyqësorit në Teheran. Ish-Shefi i Organizatës së Burgjeve të Iranit. Në këtë cilësi, ai ishte bashkëpunëtor në arrestimin masiv të protestuesve politikë dhe fshehjen e abuzimeve të kryera në sistemin e burgjeve.	12.4.2011
31.	SEDAQAT (alias Sedaghat) Farajollah		Ndihmës-sekretari i Administratës së Përgjithshme të Burgjeve në Teheran. Shef i burgut Evin në Teheran deri në tetor 2010, kohë gjatë së cilës ndodhën tortura. Ishte drejtor burgu dhe shpesh kërcënonte dhe ushtronte presion mbi të burgosur.	12.4.2011
32.	ZANJIREI Mohammad-Ali		Si këshilltar i Lartë i Shefit dhe Zv.Shefit të Organizatës së Burgjeve të Iranit, ishte përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ndaj të burgosurve. Administroi një sistem në të cilin të burgosurit vuanin abuzime, tortura dhe trajtime çnjerëzore/poshtëruese dhe mbaheshin në kushte shumë të këqija jetese.	12.4.2011
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmoud		Këshilltar i Këshillit të Lartë të Iranit për të Drejtat e Njeriut. Ish-sekretar i Këshillit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Ish-guvernator i Provincës Ilam. Ish-drejtor politik në Ministrinë e Brendshme. Si Kryetar i Komisionit të Nenit 10 të Ligjit për Veprimtaritë e Partive dhe Grupeve Politike, ishte përgjegjës për autorizimin e demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike dhe regjistrimin e partive politike. Në vitin 2010, pezulloi aktivitetet e dy partive politike reformiste të lidhura me Mousavin - Frontin e Pjesëmarrjes në Iranin Islamik dhe Organizatën e Muxhahedinë të Revolucionit Islamik. Nga viti 2009 e më tej, ka ndaluar vazhdimisht të gjitha tubimet joqeveritare, duke mohuar kështu një të drejtë kushtetuese për të protestuar dhe duke çuar në shumë arrestime të demonstruesve paqësorë në kundërshtim me të drejtën për lirinë e tubimit. Në 2009, gjithashtu i mohoi opozitës lejen për ceremoninë e zisë për personat që u vranë në protestat për zgjedhjet presidenciale.	10.10.2011
35.	AKHARIAN Hassan		Administrator i seksionit 1 të burgut Radjaishahr, Karadj deri në korrik 2010. Disa ish të paraburgosur kanë denoncuar se ai përdorte tortura dhe jepte urdhra që u mohonin atyre marrjen e ndihmës mjekësore. Sipas raportimit të një të burgosuri në burgun Radjaishahr, të gjithë rojet e rrihnin rëndë, me dijeninë e plotë të Akharian. Raportohet edhe të paktën një rast rrahjeje e rëndë të një të paraburgosuri që rezultoi në	10.10.2011

			vdekjen e tij, Mohsen Beikvand, nën administrimin e Akharian. Beikvand vdiq në shtator 2010. Sipas të burgosurve të tjerë besohet se ai u vra me udhëzimin e Hassan Akharian.	
36.	AVAEE Seyyed Ali-Reza (alias AVAEE Seyyed Alireza)		Ministër i Drejtësisë. Ish-drejtor i zyrës të hetimeve të posaçme. Zv.Ministër i Brendshëm dhe Kryetar i Regjistrit Publik deri në korrik 2016. Këshilltar pranë Gjykatës Disiplinore për Gjyqtarët që nga prilli 2014. Ish-Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit. Si Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit, ka qenë përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut, arrestime arbitrare, mohim të të drejtave të të burgosurve si dhe një numër të lartë ekzekutimesh.	10.10.2011
37.	BANESHI Jaber		Shefi i Degës 22 të Gjykatës së Apelit të Shirazit nga nëntori 2011. Prokuror i Shirazit deri në tetor 2011. Prokuror i çështjes së bombës në Shiraz në vitin 2008, që regjimi e përdori për të dënuar persona që nuk kishin lidhje me atë ngjarje. Ka proceduar akuza kapitale dhe dënime të tjera të rënda kundër pakicave, të tilla që mes të tjerash përbëjnë shkelje të të drejtave të tyre themelore për proces të rregullt gjyqësor dhe të lirisë së mbrojtjes nga burgimi arbitrar.	10.10.2011
38.	FIRUZABADI Gjen.-Maj. Dr Seyyed Hasan (alias: FIRUZABADI Gjen.-Maj. Dr Seyed Hassan; FIROUZABADI Gjen.-Maj. Dr Seyyed Hasan; FIROUZABADI Gjen.-Maj. Dr Seyed Hassan)	Vendlindja: Mashad Datëlindja: 3.2.1951	Si Shef Shtabi i Forcave të Armatosura të Iranit (1989-2016), ishte komandanti ushtarak më i lartë përgjegjës për të gjitha divizionet dhe politikat ushtarake, përfshirë edhe IRGC-në dhe policinë. Në vitin 2009, forcat nën zinxhirin e komandës së tij shtypën mizorisht protestuesit paqësorë dhe ndoqën burgime abuzive. Aktualisht është këshilltar ushtarak i Liderit Suprem dhe anëtar i Këshillit Suprem të Sigurisë Kombëtare dhe i Këshillit të Përshtatshmërisë.	10.10.2011
39.	GANJI Mostafa Barzegar		Prokuror i Përgjithshëm i Qomit (2008-2017) dhe tani Shef i Drejtorisë së Përgjithshme për burgjet. Përgjegjës për paraburgimin arbitrar dhe keqtrajtimin e dhjetëra shkelësve në Qom. Ka qenë bashkëpunëtor në një shkelje të rëndë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në dhënien e tepruar dhe në rritje të dënimit me vdekje dhe rritjen e lartë të ekzekutimeve në 2009/2010.	10.10.2011
40.	HABIBI Mohammad Reza		Kryetar i Zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd. Ish- Zv.Prokuror i Isfahanit. Bashkëpunëtor në procedura që mohojnë gjykimin e drejtë të të pandehurve – si psh. Abdollah Fathi, ekzekutuar në maj 2011 pasi e drejta për t'u dëgjuar dhe problemet me shëndetin mendor u injoruan nga Habibi gjatë gjykimit të tij në mars 2010. Kështu, ishte bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të të drejtës për proces të rregullt	10.10.2011

			ligjor, duke kontribuar në një rritje të lartë të ekzekutimeve në vitin 2011.	
41.	HEJAZI Mohammad	Vendlindja: Ispahan Datëlindja: 1956	IRGC-i Përgjithshëm, ai ka luajtur një rol kryesor në frikësimin dhe kërcënimin e "armiqve" të Iranit. Ish Shefi i Korpusit Sarollah të IRGC në Teheran dhe ish Shefi i Forcave Basij, ai luajti një rol qendror në shtypjen pas-zgjedhore të protestuesve në 2009.	10.10.2011
43.	JAVANI Yadollah		Komandant i IRGC-së për çështje politike. Ka bërë përpjekje të shumta për të shtypur fjalën e lirë dhe lirinë e shprehjes përmes deklaratave të tij publike që mbështesin arrestimin dhe ndëshkimin e protestuesve dhe disidentëve. Një nga zyrtarët e parë të rangut të lartë që kërkoi në 2009 arrestimin e Moussavi, Karroubi dhe Khatami. Ka mbështetur përdorimin e teknikave që shkelin të drejtat për proces të rregullt ligjor, përfshirë rrëfimet publike të fajit, si dhe ka bërë publike materialet e marrjes në pyetje para gjyqit. Dëshmitë tregojnë edhe se ka dënuar përdorimin e dhunës ndaj protestuesve dhe si anëtar kyç i IRGC-së, ka shumë gjasa të ketë qenë në dijeni të përdorimit të teknikave të ashpra të marrjes në pyetje për të detyruar personat të pranojnë fajin.	10.10.2011
44.	JAZAYERI Massoud		Zëvendës Shefi i Shtabit të Forcave të Përbashkëta të Armatosura të Iranit, i ngarkuar me çështjet kulturore (a.k.a. Shtabi i Publicitetit të Mbrojtjes së Shtetit). Ai bashkëpunoi në mënyrë aktive në shtypjen e protestave të vitit 2009 si zëvendës shef i stafit. Ai paralajmëroi në një intervistë në Kayhan se shumë protestues brenda dhe jashtë Iranit ishin identifikuar dhe do të trajtoheshin në kohën e duhur. Ai ka bërë thirrje të hapur për shtypjen e mediave të huaja dhe opozitës iraniane. Në vitin 2010, ai kërkoi nga qeveria të miratojë ligje më të ashpra kundër iranianëve që bashkëpunojnë me burime të huaja të medias.	10.10.2011
45.	JOKAR Mohammad Saleh		Zv. për Çështjet Parlamentare të Gardave Revolucionare. Në periudhën 2011 deri 2016, deputet parlamentar për Provincën e Yazd dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme. Ish-Komandant i Forcave Studentore të Basijt. Në këtë rol, ishte i përfshirë në mënyrë aktive në shtypjen e protestave dhe indoktrinimin e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim të shtypjes së vazhdueshme të fjalës së lirë dhe disidencës. Si Anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme, mbështeti publikisht shtypjen e opozitës ndaj qeverisë.	10.10.2011
46.	KAMALIAN Behrouz (alias Hackers Brain, Behrooz_Ice)	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1983	Kreu i grupit kibernetik 'Ashiyaneh' i lidhur me regjimin iranian. Siguria Dixhitale 'Ashiyaneh', themeluar nga Behrouz Kamalian, është përgjegjëse për sulme të shumta kibernetike si ndaj kundërshtarëve	10.10.2011

			vendas, ashtu edhe ndaj reformatorëve dhe institucioneve të huaja. Puna e organizatës Ashiyaneh e Kamalianit ka ndihmuar shtypjen e regjimit ndaj opozitës që përfshinte shkelje të shumta dhe të rënda të të drejtave të njeriut.	
49.	MALEKI Mojtaba		Zv.Ministër i Drejtësisë në provincën Khorasan Razavi. Ish-prokuror i Kermanshah. Ka luajtur rol në numrin e lartë të dënimeve me vdekje që janë dhënë në Iran, duke përfshirë ndjekjen penale të çështjeve të shtatë të burgosurve të dënuar për trafik droge të cilët u varën në të njëjtën ditë më 3 janar 2010 në burgun qendror të Kermanshah.	10.10.2011
50.	OMIDI Mehrdad (alias: Reza; OMIDI Reza)		Shef i seksionit VI të policisë, departamenti i hetimeve. Ish-Shef i Shërbimeve të Inteligjencës në Policinë Iraniane. Ish-Shef i Njësisë së Krimeve Kompjuterike të Policisë Iraniane. Ka qenë përgjegjës për mijëra hetime dhe padi ndaj reformistëve dhe kundërshtarëve politikë duke përdorur internetin. Po kështu, ka qenë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në shtypjen e personave që flasin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes, gjatë dhe pas Lëvizjes së Gjelbër në 2009.	10.10.2011
51.	SALARKIA Mahmoud	Gjinia: mashkull Ish-drejtor i klubit të futbollit të Teheranit "Persepolis"	Ish-Shef i Komisionit të Naftës dhe Transportit i qytetit të Teheranit. Zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve gjatë shtypjes së vitit 2009. Si zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve, ishte drejtpërdrejt përgjegjës për shumë urdhra arresti ndaj protestuesve dhe aktivistëve të pafajshëm dhe paqësorë. Shumë raporte nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut tregojnë se pothuajse të gjithë të arrestuarit u burgosën, sipas urdhrave të tij, pa kontaktuar me avokatin dhe familjarët e tyre si dhe pa akuza për periudha të ndryshme, shpesh në kushte që shkonin deri në zhdukje me forcë. Familjet e tyre shpesh nuk janë njoftuar për arrestimin.	10.10.2011
52.	KHODAEI SOURI Hojatollah	Vendlindja: Selseleh (Iran) Datëlindja: 1964	Anëtar i Komitetit të Sigurisë Kombëtare dhe Politikës së Jashtme. Deputet parlamentar për Provincën Lorestan. Anëtar i Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë. Drejtor i burgut Evin deri në 2012. Tortura ishte një praktikë e zakonshme në burgun Evin ndërsa drejtohej nga Souri. Shumë aktivistë u burgosën në seksionin 209 për aktivitetet e tyre paqësore kundër qeverisë.	10.10.2011
54.	TAMADDON Morteza (alias TAMADON Morteza)	Vendlindja: Shahr Kord-Isfahan (Iran) Datëlindja: 1959	Ish-Shef i Këshillit Provincial të Sigurisë Publike në Teheran. Ish-Guvernator i Përgjithshëm i IRGC-së në Provincën e Teheranit. Në cilësinë e tij si guvernator dhe kryetar i Këshillit të Sigurisë Publike provinciale të Teheranit, mbante përgjegjësi të përgjithshme për të	10.10.2011

			gjitha aktivitetet shtypëse të ndërmarra nga IRGC në provincën e Teheranit, përfshirë shtypjen e protestave politike që nga qershori 2009. Aktualisht anëtar i bordit në Universitetin e Teknologjisë "Nasireddin Tusi".	
55.	ZEBHI Hossein		Zv.Këshilltar i Parë i Gjyqësorit dhe gjyqtar i Gjykatës së Lartë (Supreme). Zv.Prokurorit i Përgjithshëm i Iranit (2007-2015). Në këtë rol, ai ishte përgjegjës për çështjet gjyqësore pas protestave paszgjedhore në 2009 të cilat u kryen në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Gjithashtu, në këtë rol, ai ka dhënë dënime tepër të ashpra për veprat penale për drogë.	10.10.2011
56.	BAHRAMI Mohammad-Kazem		Kryetar i gjykatës së drejtësisë administrative. Ka qenë bashkëpunëtor në shtypjen e demonstruesve paqësorë në 2009 si kreu i degës së gjyqësorit të forcave të armatosura.	10.10.2011
57.	HAJMOHAMMADI Aziz		Gjyqtar në Gjykatën Penale të Teheranit. Duke punuar për gjyqësorin që nga viti 1971, ai është i përfshirë në disa gjyqe të demonstruesve, si të Abdol-Reza Ghanbari, mësues i arrestuar në janar 2010 dhe i dënuar me vdekje për aktivitetet e tij politike.	10.10.2011
58.	BAGHERI Mohammad-Bagher		Nënkryetar i administratës gjyqësore të provincës Khorasan Jugore, i ngarkuar me parandalimin e krimit. Përveç pranimit të tij, në qershor 2011, 140 ekzekutime për vepra kapitale midis marsit 2010 dhe marsit 2011, rreth 100 ekzekutime të tjera raportohet të kenë ndodhur në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën provincë të Khorasan Jugore pa u njoftuar qoftë familjet apo avokatët. Prandaj, ka qenë bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuuar në një numër të lartë të dënimeve me vdekje.	10.10.2011
60.	HOSSEINI Dr Mohammad (alias HOSSEYNI, Dr Seyyed Mohammad; Seyed, Sayyed and Sayyid)	Vendlindja: Rafsanjan, Kerman (Iran) Datëlindja: 1961	Këshilltar i ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe zëdhënës i YEKTA, një fraksion politik i vijës së ashpër. Ministër i i Kulturës dhe Direktivave Islamik (2009–2013). Si ish-IRGC, ishte bashkëpunëtor në shtypjen e gazetarëve.	10.10.2011
64.	KAZEMI Toraj		Shefi i divizionit të Teheranit të Madh të Policisë Kibernetike të caktuar nga BE. Në këtë cilësi, ai shpalli një fushatë për rekrutimin e hakerëve qeveritarë në mënyrë që të arrijë kontroll më të mirë të informacionit në internet dhe të sulmojë faqet "e rrezikshme".	23.3.2012

65.	LARIJANI Sadeq	Vendlindja: Najaf (Iraq) Datëlindja: 1960 ose gusht 1961	Emëruar Kryetar i Këshillit të Përshtatshmërisë më 29 dhjetor 2018. Kryetar i Gjyqësorit nga viti 2009; në këtë cilësi, kërkohet që të pajtohet dhe të nënshkruajë çdo *kisas* (ndëshkim), *hodoud* (krim kundër Zotit) dhe *ta'zirat* (krime kundër shteti). Kjo përfshin dënime që përmbajnë dënimin me vdekje, rrahje me kamzhik dhe amputime. Në këtë drejtim, ai personalisht ka nënshkruar dënime të shumta me vdekje, në shkelje të standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë vrasjen me gurë, ekzekutimet me varje, ekzekutimin e të miturve dhe ekzekutimet publike të tilla si ato ku të burgosurit janë varur nga urat përpara turmave me mijëra persona. Prandaj, ai ka kontribuar në një numër të lartë të ekzekutimeve. Gjithashtu, ka lejuar ndëshkime fizike si amputime dhe hedhje acidi me pika në sytë e të dënuarit. Që kur Sadeq Larijani mori detyrën, u rritën ndjeshëm arrestimet arbitrare të të burgosurve politikë, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe pakicave. Sadeq Larijani gjithashtu mban përgjegjësi për mosrespektimin sistematik të të drejtës për gjykim të drejtë nga autoritetet gjyqësore iraniane.	23.3.2012
69.	MORTAZAVI Seyyed Solat	Vendlindja: Farsan, Tchar Mahal-o-Bakhtiari (Jug) – (Iran) Datëlindja: 1967	Ish kryebashkiak i qytetit të dytë më të madh të Iranit, Mashhad, ku ekzekutimet publike ndodhin rregullisht. Ish-zv.Ministër i Brendshëm për Çështjet Politike, i emëruar në 2009. Në këtë cilësi, ai ishte përgjegjës për drejtimin e shtypjes së personave që flisnin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes. Më vonë u emërua Kryetar i Komitetit Zgjedhor Iranian për zgjedhjet parlamentare në 2012 dhe për zgjedhjet presidenciale në 2013.	23.3.2012
73.	FARHADI Ali		Zv.Shef i Inspektoratit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektimit Publik të Ministrisë së Drejtësisë të Teheranit. Ish-prokuror i Karajt. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjykime në të cilat u dha dënimi me vdekje. Gjatë periudhës kur ishte prokuror, në rajonin Karaj pati një numër të lartë ekzekutimesh.	23.3.2012
79.	RASHIDI AGHDAM Ali Ashraf		Ish-kreu i Burgut të Evin, emëruar në mes të 2012. Gjatë mandatit të tij, kushtet në burg u përkeqësuan dhe raportet e referuara keqtrajtimi i intensifikuar i të burgosurve. Në tetor 2012, nëntë të burgosura femra hynë në grevë urie në protestë për shkeljen e të drejtave të tyre dhe trajtimin e dhunshëm nga rojet e burgut.	12.3.2013
83.	JAFARI Asadollah		Si prokuror i Provincës Mazandaran, Jafari ka rekomanduar dhënien e dënimit me vdekje në çështjet që ka proceduar, që rezultuan në shumë ekzekutime, përfshirë ekzekutime publike dhe në rrethana ku dhënia e dënimit me vdekje është në kundërshtim me të drejtat ndërkombëtare të njeriut, përveç se ishte dënim joproporcional dhe i tepërt. Jafari ka	12.3.2013

			qenë gjithashtu përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe shkelje të të drejtave të të arrestuarve Bahái nga arrestimi fillestar deri në mbajtjen e tyre në izolim në Qendrën e Paraburgimit të Inteligjencës.	
85.	HAMLBAR Rahim		Gjyqtar i Degës 1 të Gjykatës Revolucionare të Tabrizit. Përgjegjës për dënime të rënda kundër pakicës etnike azere dhe aktivistëve të të drejtave të punëtorëve, duke i akuzuar ata për spiunim, veprime kundër sigurisë kombëtare, propagandë kundër regjimit iranian dhe fyerje të liderit të Iranit. Një rast i profilit të lartë përfshinte 20 punonjës vullnetarë të ndihmës ndaj tërmetit (pas një tërmeti në Iran në gusht 2012) të cilëve ai u dhanë dënime me burg për përpjekjet e tyre për të ndihmuar viktimat e tërmetit. Gjykata i shpalli punëtorët fajtorë për 'bashkëpunim në tubime dhe për të kryer krime kundër sigurisë kombëtare'.	12.3.2013

Subjektet

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	Policia Kibernetike	Vendndodhja: Teheran (Iran) Faqja e internetit: http://www.cyberpolice.ir	Policia Kibernetike iraniane e themeluar në janar 2011, është një si e Policisë së Republikës Islamike të Iranit, e drejtuar nga Vahid Majid. Nga krijimi deri në fillim të vitit 2015, kryesohej nga Esmail Ahmadi-Moqaddam (i listuar). Ahmadi-Moqaddam theksoi se Policia Kibernetike do të ndiqte grupe antirevolucionare dhe disidente që përdorën rrjete sociale të internetit në 2009 për të nxitur protesta kundër rizgjedhjes së presidentit Mahmoud Ahmadinexhad. Në janar 2012, Policia Kibernetike lëshoi udhëzime të reja për internet-kafetë, duke u kërkuar përdoruesve të japin informacione personale që do të mbaheshin nga pronarët e kafeneve për gjashtë muaj, si dhe listën e faqeve të internetit që kanë vizituar. Rregullat kërkojnë edhe që pronarët e kafeneve të instalojnë kamera televizive me qark të mbyllur dhe të mbajnë regjistrimet për gjashtë muaj. Këto rregulla të reja mund të krijojnë një regjistër që autoritetet ta përdorin për të gjurmuar aktivistët ose këdo që cilësohet kërcënim për sigurinë kombëtare.	12.3.2013'

			Në qershor 2012, media iraniane njoftoi se Policia Kibernetike do të mbyllte rrjetet private virtuale (VPN). Më 30 tetor 2012, Policia Kibernetike arrestoi blogerin Sattar Beheshti pa mandat për 'veprime kundër sigurisë kombëtare në rrjetet sociale dhe Facebook'. Beheshti kishte kritikuar qeverinë iraniane në blogun e tij. Beheshti u gjet i vdekur në qelinë e burgut më 3 nëntor 2012 dhe besohet se është torturuar për vdekje nga autoritetet e Policisë Kibernetike..	

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2020/512
i datës 7 prill 2020
që ndryshon Vendimin 2011/235/PPJS për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/(PPJS).[1]

(2) Bazuar në rishikimin e Vendimit 2011/235/PPJS, masat shtrënguese e parashikuara në të duhet të ripërtërihen deri më 13 prill 2021.

(3) Këshilli vendosi edhe se të dhënat për 82 persona të përfshirë në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS duhet të përditësohen.

(4) Vendimi 2011/235/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/235/PPJS ndryshohet si vijon:

(1) Neni 6, pika 2 e Vendimit 2011/235/PPJS zëvendësohet me pikën më poshtë:
"2. Ky Vendim zbatohet deri më 13 prill 2021 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

(2) Shtojca ndryshohet siç paraqitet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Miratuar në Bruksel, më 7 prill 2020.

Për Këshillin
Presidenti
G. GRLIĆ-RADMAN

---

[1] Vendimi i Këshillit 2011/235/PPJS i datës 12 prill 2011 për masat shtrënguese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (GZ) L 100, 14.4.2011, fq. 51).

SHTOJCA

Regjistrimet për personat vijues të përcaktuar në Aneksin e Vendimit 2011/235 / CFSP zëvendësohen me sa vijon:

Personat

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	AHMADI-MOQADDAM Esmail	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1961 Gjinia: mashkull	Ish-Këshilltar i Lartë për Çështjet e Sigurisë për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shef i Policisë Kombëtare të Iranit nga 2005 deri në fillim të 2015. Gjithashtu Shef i Policisë Kibernetike Iraniane (të listuar) nga janari 2011 deri në fillim të 2015. Forcat nën komandën e tij drejtuan sulme mizore në protesta paqësore dhe një sulm të dhunshëm gjatë natës në konviktet e Universitetit të Teheranit më 15 qershor 2009. Ish-shef i Shtabit të Iranit në mbështetje të Popullit Jemenas.	12.4.2011
2	ALLAHKARAM Hossein	Vendlindja: Najafabad (Iran) Datëlindja: 1945 Gjinia: mashkull	Shefi i Këshillit të Koordinimit Ansar-e Hezbollah dhe ish-gjeneral i IRGC-së. Bashkëthemeloi Ansar-e Hezbollah. Kjo forcë paramilitare ishte përgjegjëse për dhunën ekstreme gjatë shtypjes së protestave të studentëve dhe universiteteve në 1999, 2002 dhe 2009. Mban post të lartë në një organizatë e cila është e gatshme të kryejë shkelje të të drejtave të njeriut kundër publikut, përfshirë nxitjen e agresionit ndaj grave për zgjedhjen e tyre të veshjeve.	12.4.2011
3	ARAGHI (ERAGHI) Abdollah	Gjinia: Mashkull Titulli: Gjeneral Brigade	Gjeneral brigade në IRGC. Shef i Departamentit të Sigurisë së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ish zv.Shef i Forcave Tokësore të IRGC-së. Mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë dhe personale në shtypjen e protestave gjatë gjithë verës së vitit 2009.	12.4.2011
4.	FAZLI Ali	Gjinia: mashkull Titulli: Gjeneral Brigade	Shefi i Kolegjit Kadet të Imam Hussein (që nga viti 2018). Ish zëvendës komandant i Basij (2009-2018), Shef i Korpusit Seyyed al-Shohada të IRGC, Provinca Teheran (deri në Shkurt 2010). Korpusi Seyyed al-Shohada është përgjegjës për sigurinë në provincën Teheran dhe luajti një rol kryesor në shtypjen brutale të protestuesve në 2009.	12.4.2011
6	JAFARI Mohammad-Ali (alias 'Aziz Jafari')	Vendlindja: Yazd (Iran) Datëlindja: 1.9.1957 Gjinia: mashkull	Drejtori i Bazës Sociale dhe Kulturore Hazret-e Baqiatollah. Ish-Komandant i IRGC-së (shtator 2007 - prill 2019). IRGC dhe Baza e Sarollahut e komanduar nga Gjenerali Mohammad-Ali (Aziz) Jafari	

			kanë luajtur rol kryesor në ndërhyrjen e paligjshme në Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2009, në arrestimin dhe ndalimin e aktivistëve politikë, si dhe në përplasjen me protestuesit në rrugë.	
7	KHALILI Ali	Gjinia: mashkull	Gjenerali i IRGC-së, me rol të lartë brenda Bazës Sarollah. Nënshkroi një letër dërguar Ministrisë së Shëndetësisë më 26 qershor 2009, duke ndaluar dorëzimin e dokumenteve ose të dhënave mjekësore për cilindo të plagosur ose të shtruar në spital gjatë ngjarjeve paszgjedhore.	12.4.2011
8.	MOTLAGH Bahram Hosseini	Gjinia: mashkull	Ish shefi i Komandës së Ushtrisë dhe Kolegjit të Shtabit të Përgjithshëm (DAFOOS). Ish Shefi i Korpusit Seyyed al-Shohada të IRGC-së, Provinca e Teheranit. Trupat Seyyed al-Shohada luajtën një rol kryesor në organizimin e shtypjes së protestave në 2009.	12.4.2011
9.	NAQDI Mohammad-Reza	Vendlindja: Najaf (Irak) Datëlindja: afërsisht 1952 Gjinia: mashkull Titulli: Gjeneral Brigade	Zv.Koordinator i Trupave të Gardës së Revolucionit Islamik (IRGC). Ish zv.Shef i IRGC-së për çështje kulturore dhe shoqërore. Ish-Komandant i Basijut (2009-2016). Si komandant i Forcave Basij të IRGC-së, Naqdi ishte përgjegjës ose bashkëpunëtor në abuzimet e Basij-ut që ndodhën në fund të vitit 2009, duke përfshirë përgjigjen e dhunshme ndaj protestave të dhjetorit 2009 në Ditën e Ashures, që rezultoi deri në 15 vdekje dhe arrestime të qindra protestuesve. Para emërimit të tij si komandant i Basij në tetor 2009, Naqdi ishte kreu i njësitit të inteligjencës të Basij përgjegjës për marrjen në pyetje të të arrestuarve gjatë shtypjes së protestave paszgjedhore.	12.4.2011
10.	RADAN Ahmad-Reza	Vendlindja: Isfahan (Iran) Datëlindja: 1963 Gjinia: mashkull	Shefi i Qendrës për Studime Strategjike të Forcës Iraniane të Zbatimit të Ligjit, një organ i lidhur me Policinë Kombëtare. Zv.Shef i Policisë Kombëtare të Iranit deri në qershor 2014. Si zv.Shef i Policisë Kombëtare nga viti 2008, Radan ishte përgjegjës për rrahjet, vrasjet, dhe arrestimet dhe ndalimet arbitrare të protestuesve nga forcat e policisë. Aktualisht, komandant i IRGC-së i ngarkuar me stërvitjen e forcave "antiterroriste" irakiane.	12.4.2011
11.	RAJABZADEH Azizollah	Gjinia: mashkull	Këshilltar i kryebashkiakut të Teheranit. Ish-Shef i Organizatës për Zbutjen e Fatkeqësive Natyrore në Teheran (2010-2013). Si Shef i Policisë së Teheranit deri në janar 2010, ishte përgjegjës për sulmet e dhunshme të policisë ndaj protestuesve dhe studentëve. Si Komandant i Forcave të Zbatimit të Ligjit në Teheranin e Madh, Azizollah Rajabzadeh ishte zyrtari më i lartë i akuzuar për abuzimet në Qendrën e Burgimit të Kahrizak në dhjetor 2009.	12.4.2011

12.	SAJEDI-NIA Hossein	Gjinia: mashkull	Zv.Komandant i Operacioneve të Policisë. Ish-Shefi i Policisë së Teheranit, ish-zv.Shef i Policisë Kombëtare të Iranit përgjegjës për Operacionet e Policisë. Përgjegjës për koordinimin pranë Ministrisë s Brendshme, të operacioneve të shtypjes së protestave në kryeqytetin iranian.	12.4.2011
13.	TAEB Hossein	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1963 Gjinia: mashkull	Shef i organizatës së inteligjencës IRGC që nga tetori 2009. Kompetencat e tij u zgjeruan në maj 2019 me bashkimin e Zyrës së Inteligjencës Strategjike të IRGC me Organizatën e Inteligjencës së IRGC. Komandant i Basij deri në tetor 2009. Forcat nën komandën e tij morën pjesë në rrahjet masive, vrasjet, ndalimet dhe torturimin e protestuesve paqësorë.	12.4.2011
14.	SHARIATI Seyeed Hassan	Gjinia: mashkull	Këshilltar dhe Anëtar i Seksionit të 28-të të Gjykatës Supreme. Shefi i Gjyqësorit të Mashhad deri në shtator 2014. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuar dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	12.4.2011
15.	DORRI-NADJA-FABADI Ghorban-Ali	Vendlindja: Najafabad (Iran) Datëlindja: 1945 Gjinia: mashkull	Anëtar i Asamblesë së Ekspertëve dhe përfaqësues i Liderit Suprem në Provincën Markazi ('Qendror') dhe Kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative. Prokuror i Përgjithshëm i Iranit deri në shtator 2009, si dhe ish-Ministër i Inteligjencës nën presidencën e Khatamit. Si Prokuror i Përgjithshëm i Iranit, ka urdhëruar dhe mbikëqyrur gjyqet e montuara publike pas protestave të para paszgjedhore, ku të akuzuarve iu mohuan të drejtat për të pasur një avokat.	12.4.2011
16.	HADDAD Hassan (alias Hassan ZAREH DEHNAVI)	Gjinia: mashkull	Ish-zv.Kryetar i Sigurisë i Gjykatës Revolucionare të Teheranit. Ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ishte përgjegjës për çështjet e të paraburgosurve në lidhje me krizat paszgjedhore dhe kërcënonte rregullisht familjet e të paraburgosurve për t'ua mbyllur gojën. Ka qenë vendimtar në lëshimin e urdhrave të paraburgimit në Qendrën e Burgimit në Kahrizak në 2009. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjen e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane.	12.4.2011
17.	SOLTANI Hodjatoleslam Seyed Mohammad	Gjinia: mashkull	Kreu i Organizatës për Propagandë Islame në provincën e Khorasan Razavi. Gjyqtar pranë Gjykatës Revolucionare të Mashhad deri në vitin 2013. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuara dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të	12.4.2011

			akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	
18.	HEYDARIFAR Ali-Akbar	Gjinia: mashkull	Ish-gjyqtar pranë Gjykatës Revolucionare së Teheranit. Mori pjesë në gjyqet e protestuesve. U mor në pyetje nga gjyqësori për abuzimet në Kahrizak. Ishte i rëndësishëm në lëshimin e urdhrave të paraburgimit për dërgimin e të paraburgosurve në Qendrën e Burgimit Kahrizak në 2009. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjen e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane.	12.4.2011
19.	JAFARI-DOLA-TABADI Abbas	Vendlindja: Yazd (Iran) Datëlindja: 1953 Gjinia: mashkull	Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit (gusht 2009-prill 2019). Zyra e Dolatabadit akuzoi një numër të madh protestuesish, përfshirë individë që morën pjesë në protestat e Ditës së Ashures në dhjetor 2009. Ka urdhëruar mbylljen e zyrës së Karroubit në shtator 2009 dhe arrestimin e disa politikanëve reformistë si dhe ka ndaluar dy parti politike reformiste në qershor 2010. Zyra e tij akuzoi protestuesit për 'Moharebeh', ose 'armiqësi ndaj Zotit', e cila mbart dënim me vdekje, dhe i mohoi procesin e duhur të akuzuarve për dënim me vdekje. Gjithashtu, zyra pati në objektiv dhe arrestoi reformistët, aktivistët për të drejtat e njeriut dhe anëtarët e medias, si pjesë e një goditje të gjerë ndaj opozitës politike. Në tetor 2018, njoftoi në media se katër aktivistë mjedisorë iranianë të arrestuar do të akuzoheshin për 'mbjellje korrupsioni në tokë', akuzë kjo që mbart dënim me vdekje.	12.4.2011
20.	MOGHISSEH Mohammad (a.k.a NASSERIAN)	Gjinia: mashkull	Gjykatësi, Shefi i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 28. Gjithashtu konsiderohet përgjegjës për dënimet e anëtarëve të komunitetit Bahá'í. Ai është marrë me çështje paszgjedhore. Ai lëshoi dënime të gjata me burg gjatë gjykimeve të padrejta për aktivistët socialë, politikë dhe gazetarë dhe disa dënime me vdekje për protestuesit dhe aktivistët socialë dhe politikë.	12.4.2011
21.	MOHSENI-EJEI Gholam-Hossein	Vendlindja: Ejiyeh (Iran) Datëlindja: rreth 1956 Gjinia: mashkull	Anëtar i Këshillit të Përshtatshmërisë. Prokuror i Përgjithshëm i Iranit nga shtator 2009 deri në vitin 2014. Ish Zv.Kryetar dhe zëdhënës shtypi i Gjyqësorit. Ish-Ministër i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009. Kur ishte Ministër i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009, agjentët e inteligjencës nën komandën e tij ishin përgjegjës për ndalimin, torturimin dhe nxjerrjen e rrëfimeve të rreme nën presionin e qindra aktivistëve, gazetarëve, disidentëve dhe politikanëve reformistë. Gjithashtu, figurat politike u detyruan të jepnin rrëfime të rreme gjatë	12.4.2011

			marrjes së padurueshme në pyetje, ku përfshiheshin tortura, abuzime, shantazhe dhe kërcënime ndaj familjarëve.	
22.	MORTAZAVI Said	Vendlindja: Meybod, Yazd (Iran) Datëlindja: 1967 Gjinia: mashkull	Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit deri në gusht 2009. Si Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit, ka lëshuar urdhër të përgjithshëm të përdorur për ndalimin e qindra aktivistëve, gazetarëve dhe studentëve. Në janar 2010, një hetim parlamentar e konsideroi përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për ndalimin e tre të burgosurve që vdiqën më pas në paraburgim. U pezullua nga detyra në gusht 2010 pas një hetimi të drejtësisë iraniane për rolin e tij në vdekjen e tre personave të ndaluar me urdhër të tij pas zgjedhjeve. Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjet e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane. U shpall i pafajshëm nga Gjykata Iraniane më 19 gusht 2015, nga akuzat lidhur me torturën dhe vdekjen e tre të rinjve në qendrën e paraburgimit të Kahrizak në 2009.	12.4.2011
23.	PIR-ABASSI Abbas	Gjinia: mashkull	Magjistrat i një Kolegji Penal. Ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ishte përgjegjës për çështjet paszgjedhore. Dha dënime të gjata me burg gjatë gjykimeve të padrejta kundër aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe disa dënime me vdekje për protestuesit.	12.4.2011
24.	MORTAZAVI Amir	Gjinia: mashkull	Zv.Shefi i Njësisë për Çështjet Sociale dhe Parandalimin e Krimit në gjyqësor në provincën e Khorasan-Razavi. Zv.Prokuror i Mashhad deri të paktën 2015. Gjykimet nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë gjykime të shkurtuara dhe me dyer të mbyllura, pa respektuar të drejtat themelore të të akuzuarit, si dhe bazuar në pranim krimi nën presion dhe torturë. Vendimet e ekzekutimit janë lëshuar në masë, ndërsa dënimet me vdekje janë dhënë pa respektuar procedurat e procesit të rregullt ligjor.	12.4.2011
25.	SALAVATI Abdolghassem	Gjinia: mashkull	Gjyqtar, Kryetari i Gjykatës Revolucionare të Teheranit, dega 15. Gjyqtar i komanduar në Gjykatën e Teheranit. Kryesoi gjykimin e çështjeve paszgjedhore, në gjyqet e montuara të verës 2009; dënoi me vdekje dy monarkistë. Dënoi mbi njëqind të burgosur politikë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe demonstrues me dënime të gjata me burg. Në vitin 2018, raportet tregojnë se vazhdoi të jepte dënime të tilla pa respektuar procedurat e procesit të rregullt gjyqësor.	12.4.2011
26.	SHARIFI Malek Adjar (alias: SHARIFI Malek Ajdar)	Gjinia: mashkull	Gjyqtar në Gjykatën e Lartë, shefi i seksionit të 43-të. Ish-Shef i Gjyqësorit të Azerbajxhanit Lindor. Ishte përgjegjës për gjyqin e Sakineh Mohammadi-Ashtiani.	12.4.2011

27.	ZARGAR Ahmad	Gjinia: mashkull	Gjyqtar në Degën e 2-të të Gjykatës Speciale të Korrupsionit Ekonomik. Shef i "Organizatës për Ruajtjen e Moralit". Ish gjykatësi, Gjykata e Apelit në Teheran, dega 36. Ai konfirmoi urdhër-burgimet afatgjata dhe urdhrat e vdekjes kundër protestuesve.	12.4.2011
28.	YASAGHI AliAkbar	Gjinia: mashkull	Gjyqtar i Gjykatës së Lartë, shef i seksionit të 44-të. Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv i Fondacionit Setad-e Dieh. Kryetari i Gjykatës, Gjykata Revolucionare e Mashhad (2001-2011). Gjykimet nën juridiksionin e tij janë kryer në mënyrë të përmbledhur dhe brenda seancës së mbyllur, pa respektimin e të drejtave themelore të të akuzuarit. Ndërsa vendimet e ekzekutimit ishin lëshuar në masë (deri në 550 midis verës 2009 dhe verës 2011), dënimet me vdekje ishin lëshuar pa respektimin e duhur të procedurave të dëgjimit të drejtë.	12.4.2011
29.	BOZORGNIA Mostafa	Gjinia: mashkull	Drejtor i seksionit 350 në burgun Evin. Në mjaft raste ka ushtruar dhunë proporcionale ndaj të burgosurve.	12.4.2011
30.	ESMAILI Gholam-Hossein	Gjinia: mashkull	Zëdhënës i gjyqësorit që nga prilli 2019. Ish-kryetar i gjyqësorit në Teheran. Ish-Shefi i Organizatës së Burgjeve të Iranit. Në këtë cilësi, ai ishte bashkëpunëtor në arrestimin masiv të protestuesve politikë dhe fshehjen e abuzimeve të kryera në sistemin e burgjeve.	12.4.2011
31.	SEDAQAT (alias Sedaghat) Fara-jollah	Gjinia: mashkull	Ndihmës-sekretari i Administratës së Përgjithshme të Burgjeve në Teheran. Shef i burgut Evin në Teheran deri në tetor 2010, kohë gjatë së cilës ndodhën tortura. Ishte drejtor burgu dhe shpesh kërcënonte dhe ushtronte presion mbi të burgosur.	12.4.2011
32.	ZANJIREI Mohammad-Ali	Gjinia: mashkull	Si këshilltar i Lartë i Shefit dhe Z.Shefit të Organizatës së Burgjeve të Iranit, ishte përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ndaj të burgosurve. Administroi një sistem në të cilin të burgosurit vuanin abuzime, tortura dhe trajtime çnjerëzore/poshtëruese dhe mbaheshin në kushte shumë të këqija jetese.	12.4.2011
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmoud	Gjinia: mashkull	Këshilltar i Këshillit të Lartë të Iranit për të Drejtat e Njeriut. Ish-sekretar i Këshillit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Ish-guvernator i Provincës Ilam. Ish-drejtor politik në Ministrinë e Brendshme. Si Kryetar i Komisionit të Nenit 10 të Ligjit për Veprimtaritë e Partive dhe Grupeve Politike, ishte përgjegjës për autorizimin e demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike dhe regjistrimin e partive politike. Në vitin 2010, pezulloi aktivitetet e dy partive politike reformiste të lidhura me Mousavin - Frontin e Pjesëmarrjes në Iranin Islamik dhe Organizatën e Muxhahedinë të Revolucionit Islamik. Nga viti 2009 e më tej, ka ndaluar vazhdimisht të gjitha tubimet joqeveritare, duke	10.10.2011

			mohuar kështu një të drejtë kushtetuese për të protestuar dhe duke çuar në shumë arrestime të demonstruesve paqësorë në kundërshtim me të drejtën për lirinë e tubimit. Në 2009, gjithashtu i mohoi opozitës lejen për ceremoninë e zisë për personat që u vranë në protestat për zgjedhjet presidenciale.	
34.	AKBARSHAHI Ali-Reza	Gjinia: mashkull	Ish Drejtori i Përgjithshëm i Shtabit të Kontrollit të Barnave në Iran (aka: Shtabi Anti-Narkotik). Ish Komandant i Policisë së Teheranit. Nën udhëheqjen e tij, forca policore ishte përgjegjëse për përdorimin e forcës jashtëgjyqësore ndaj të dyshuarve gjatë arrestimit dhe paraburgimit. Policia e Teheranit ishte gjithashtu e implikuar në bastisjet në konviktet e universitetit të Teheranit në qershor 2009, kur sipas një komisioni të Iranit Majlis, më shumë se 100 studentë u plagosën nga policia dhe Basiji. Aktualisht shef i policisë hekurudhore.	10.10.2011
35.	AKHARIAN Hassan	Gjinia: mashkull	Administrator i seksionit 1 të burgut Radjaishahr, Karadj deri në korrik 2010. Disa ish të paraburgosur kanë denoncuar se ai përdorte tortura dhe jepte urdhra që u mohonin atyre marrjen e ndihmës mjekësore. Sipas raportimit të një të burgosuri në burgun Radjaishahr, të gjithë rojet e rrihnin rëndë, me dijeninë e plotë të Akharian. Raportohet edhe të paktën një rast rrahjeje e rëndë të një të paraburgosuri që rezultoi në vdekjen e tij, Mohsen Beikvand, nën administrimin e Akharian. Beikvand vdiq në shtator 2010. Sipas të burgosurve të tjerë besohet se ai u vra me udhëzimin e Hassan Akharian.	10.10.2011
36.	AVAEE Seyyed Ali-Reza (alias AVAEE Seyyed Alireza, AVAIE Alireza)	Gjinia: mashkull	Ministër i Drejtësisë. Ish-drejtor i zyrës të hetimeve të posaçme. Zv.Ministër i Brendshëm dhe Kryetar i Regjistrit Publik deri në korrik 2016. Këshilltar pranë Gjykatës Disiplinore për Gjyqtarët që nga prilli 2014. Ish-Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit. Si Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit, ka qenë përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut, arrestime arbitrare, mohim të të drejtave të të burgosurve si dhe një numër të lartë ekzekutimesh.	10.10.2011
37.	BANESHI Jaber	Gjinia: mashkull	Shefi i Degës 22 të Gjykatës së Apelit të Shirazit nga nëntori 2011. Prokuror i Shirazit deri në tetor 2011. Prokuror i çështjes së bombës në Shiraz në vitin 2008, që regjimi e përdori për të dënuar persona që nuk kishin lidhje me atë ngjarje. Ka proceduar akuza kapitale dhe dënime të tjera të rënda kundër pakicave, të tilla që mes të tjerash përbëjnë shkelje të të drejtave të tyre themelore për proces të rregullt gjyqësor dhe të lirisë së mbrojtjes nga burgimi arbitrar.	10.10.2011

38.	FIRUZABADI Maj-Gen Dr Seyyed Hasan (alias: FIRUZABADI Maj- Gen Dr Seyed Hassan; FIROUZABADI Maj-Gen Dr Seyyed Hasan; FIROUZABADI Maj-Gen. Dr Seyed Hassan)		Si Shef Shtabi i Forcave të Armatosura të Iranit (1989-2016), ishte komandanti ushtarak më i lartë përgjegjës për të gjitha divizionet dhe politikat ushtarake, përfshirë edhe IRGC-në dhe policinë. Në vitin 2009, forcat nën zinxhirin e komandës së tij shtypën mizorisht protestuesit paqësorë dhe ndoqën burgime abuzive. Aktualisht është këshilltar ushtarak i Liderit Suprem dhe anëtar i Këshillit Suprem të Sigurisë Kombëtare dhe i Këshillit të Përshtatshmërisë.	10.10.2011
39.	GANJI Mostafa Barzegar	Gjinia: Mashkull	Prokurori i Përgjithshëm i Qomit (2008-2017), tani shef i drejtorisë së përgjithshme për burgjet. Ai ishte përgjegjës për ndalimin arbitrar dhe keqtrajtimin e dhjetëra shkelësve në Qom. Ai ishte bashkëpunëtor në një shkelje të rëndë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në përdorimin e tepruar dhe në rritje të dënimit me vdekje dhe një rritje të mprehtë të ekzekutimeve në 2009/2010.	10.10.2011
40.	HABIBI Mohammad Reza	Gjinia: mashkull	Prokurori i Përgjithshëm i Isfahanit. Ish shefi i zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd. Ish Zëvendës Prokurori i Isfahanit. E ndërlikuar në procedurat që u mohojnë të pandehurve një gjykim të drejtë - të tillë si Abdollah Fathi, ekzekutuar në maj 2011 pasi e drejta e tij për t'u dëgjuar dhe çështjet e shëndetit mendor u injoruan nga Habibi gjatë gjykimit të tij në mars 2010. Ai ishte, pra, bashkëpunëtor në një shkelje të e drejta për proces të rregullt, duke kontribuar në një rritje të mprehtë të ekzekutimeve në 2011.	10.10.2011
41.	HEJAZI Mohammad	Vendlindja: Ispahan Datëlindja: 1956 Gjinia: mashkull	IRGC-i Përgjithshëm, ai ka luajtur një rol kryesor në frikësimin dhe kërcënimin e "armiqve" të Iranit. Ish Shefi i Korpusit Sarollah të IRGC në Teheran dhe ish Shefi i Forcave Basij, ai luajti një rol qendror në shtypjen pas-zgjedhore të protestuesve në 2009.	10.10.2011
43.	JAVANI Yadollah	Gjinia: mashkull	Zëvendës komandant i IRGC-së për çështje politike. Ka bërë përpjekje të shumta për të shtypur fjalën e lirë dhe ligjërimin e lirë përmes deklaratave të tij publike që mbështesin arrestimin dhe ndëshkimin e protestuesve dhe disidentëve. Një nga zyrtarët e parë të rangut të lartë që kërkoi në 2009 arrestimin e Moussavi, Karroubi dhe Khatami. Ka mbështetur përdorimin e teknikave që shkelin të drejtat për një gjykim të drejtë duke përfshirë rrëfimet publike dhe ai ka lëshuar përmbajtjen e pyetjeve para gjyqit. Dëshmitë gjithashtu tregojnë se ai ka hedhur poshtë përdorimin e dhunës ndaj protestuesve dhe si një anëtar integral i IRGC ai ka shumë të ngjarë të ketë qenë në dijeni të përdorimit të teknikave të ashpra të marrjes në pyetje për të detyruar rrëfimet.	10.10.2011
44.	JAZAYERI Massoud	Gjinia: mashkull Titulli: Gjeneral Brigade	Brenda stafit të përbashkët ushtarak të Forcave të Armatosura të Iranit, Gjeneral Brigade Massoud Jazayeri ishte nënkryetari i shtabit për çështjet kulturore dhe mediatike (a.k.a. Shtabi i Publikimit i Mbrojtjes së Shtetit). Ai bashkëpunoi në mënyrë aktive në shtypjen e protestave	10.10.2011

			të vitit 2009 si zëvendës shef i shtabit. Ai paralajmëroi në një intervistë në Kayhan se shumë protestues brenda dhe jashtë Iranit ishin identifikuar dhe do të trajtoheshin në kohën e duhur. Ai ka bërë thirrje të hapur për shtypjen e mediave të huaja dhe opozitës iraniane. Në vitin 2010, ai kërkoi nga qeveria të miratojë ligje më të ashpra kundër iranianëve që bashkëpunojnë me burime të huaja të medias.	
45.	JOKAR Mohammad Saleh	Gjinia: Mashkull	Zëvendës për Çështjet Parlamentare të Gardave Revolucionare. Nga 2011 deri në 2016 deputet parlamentar për Provincën Yazd dhe Anëtar i Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme. Ish Komandanti i Forcave Studentore të Besimit Në këtë rol ai ishte i përfshirë në mënyrë aktive në shtypjen e protestave dhe indoktrinimin e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim të shtypjes së vazhdueshme të fjalës së lirë dhe disidencës. Si anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme ai përkrahu publikisht shtypjen e opozitës ndaj qeverisë.	10.10.2011
46.	KAMALIAN Behrouz (alias Hackers Brain, Behrooz_Ice)	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1983 Gjinia: mashkull	Kreu i grupit kibernetik 'Ashiyaneh' i lidhur me regjimin iranian. Siguria Dixhitale 'Ashiyaneh', themeluar nga Behrouz Kamalian, është përgjegjëse për sulme të shumta kibernetike si ndaj kundërshtarëve vendas, ashtu edhe ndaj reformatorëve dhe institucioneve të huaja. Puna e organizatës Ashiyaneh e Kamalianit ka ndihmuar shtypjen e regjimit ndaj opozitës që përfshinte shkelje të shumta dhe të rënda të të drejtave të njeriut.	10.10.2011
47.	KHALILOLLAHI Moussa (alias: KHALILOLLAHI Mousa, ELAHI Mousa Khalil)	Gjinia: mashkull	Prokuror i Tabrizit. I përfshirë në çështjen e Sakineh Mohammadi-Ashtiani dhe është bashkëpunëtor në shkeljet e rënda të së drejtës për proces të rregullt ligjor.	10.10.2011
48.	MAHSOULI Sadeq (alias MAHSULI Sadeq)	Vendlindja: Oroumieh (Iran) Datëlindja: 1959/60 Gjinia: mashkull	Këshilltar i ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe anëtar aktual i Këshillit të Përshtatshmërisë dhe zv.Shef i Frontit të Rezistencës. Ministër i Mirëqenies dhe Sigurimeve Shoqërore gjatë 2009-2011. Ministër i Brendshëm deri në gusht 2009. Si Ministër i Brendshëm, Mahsouli kishte autoritet mbi të gjitha forcat e policisë, agjentët e sigurimit të ministrisë së brendshme dhe agjentët civilë. Forcat nën drejtimin e tij ishin përgjegjëse për sulmet ndaj konvikteve të Universitetit të Teheranit më 14 qershor 2009 dhe torturat e studentëve në bodrumin e Ministrisë (bodrumi famëkeq i nivelit 4). Shumë protestues janë keqtrajtuar rëndë në Burgun Kahrizak që drejtohej nga policia nën kontrollin e Mahsoulit.	10.10.2011

49.	MALEKI Mojtaba	Gjinia: mashkull	Zv.Ministër i Drejtësisë në provincën Khorasan Razavi. Ish-prokuror i Kermanshah. Ka luajtur rol në numrin e lartë të dënimeve me vdekje që janë dhënë në Iran, duke përfshirë ndjekjen penale të çështjeve të shtatë të burgosurve të dënuar për trafik droge të cilët u varën në të njëjtën ditë më 3 janar 2010 në burgun qendror të Kermanshah.	10.10.2011
50.	OMIDI Mehrdad (alias: Reza; OMIDI Reza)	Gjinia: mashkull	Shef i seksionit VI të policisë, departamenti i hetimeve. Ish-Shef i Shërbimeve të Inteligjencës në Policinë Iraniane. Ish-Shef i Njësisë së Krimeve Kompjuterike të Policisë Iraniane. Ka qenë përgjegjës për mijëra hetime dhe padi ndaj reformistëve dhe kundërshtarëve politikë duke përdorur internetin. Po kështu, ka qenë përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në shtypjen e personave që flasin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes, gjatë dhe pas Lëvizjes së Gjelbër në 2009.	10.10.2011
51.	SALARKIA Mahmoud	Gjinia: mashkull Ish-drejtor i klubit të futbollit të Teheranit "Persepolis"	Ish-Shef i Komisionit të Naftës dhe Transportit i qytetit të Teheranit. Zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve gjatë shtypjes së vitit 2009. Si zv.Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit për Çështjet e Burgjeve, ishte drejtpërdrejt përgjegjës për shumë urdhra arresti ndaj protestuesve dhe aktivistëve të pafajshëm dhe paqësorë. Shumë raporte nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut tregojnë se pothuajse të gjithë të arrestuarit u burgosën, sipas urdhrave të tij, pa kontaktuar me avokatin dhe familjarët e tyre si dhe pa akuza për periudha të ndryshme, shpesh në kushte që shkonin deri në zhdukje me forcë. Familjet e tyre shpesh nuk janë njoftuar për arrestimin. Tani punon si avokat.	10.10.2011
52.	KHODAEI SOURI Hojatollah	Vendlindja: Selseleh (Iran) Datëlindja: 1964 Gjinia: mashkull	Anëtar i Komitetit të Sigurisë Kombëtare dhe Politikës së Jashtme. Deputet parlamentar për Provincën Lorestan. Anëtar i Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë. Drejtor i burgut Evin deri në 2012. Tortura ishte një praktikë e zakonshme në burgun Evin ndërsa drejtohej nga Souri. Shumë aktivistë u burgosën në seksionin 209 për aktivitetet e tyre paqësore kundër qeverisë.	10.10.2011
53.	TALA Hossein (alias TALA Hosseyn)	Gjinia: mashkull	Kryebashkiak i Eslamshahr. Ish-deputet iranian. Ish-Guvernator i Përgjithshëm ('Farmandar') i Provincës Teheran deri në shtator 2010; ishte përgjegjës për ndërhyrjen e forcave të policisë dhe rrjedhimisht për shtypjen e demonstratave. Mori çmim në dhjetor 2010 për rolin e tij në shtypjen e protestave paszgjedhore.	10.10.2011

54.	TAMADDON Morteza (alias TAMADON Morteza)	Vendlindja: Shahr Kord-Isfahan Datëlindja: 1959 Gjinia: mashkull	Kreu i grupit kibernetik "Ashiyaneh" i lidhur me regjimin iranian. Siguria Dixhitale "Ashiyaneh", e themeluar nga Behrouz Kamalian, është përgjegjëse për sulmet intensive kibernetike si ndaj kundërshtarëve vendas, ashtu edhe ndaj reformatorëve dhe institucioneve të huaja. Puna e organizatës Ashiyaneh e Kamalian ka ndihmuar goditjen e regjimit kundër opozitës e cila ka përfshirë shkelje të shumta serioze të të drejtave të njeriut.	10.10.2011
55.	ZEBHI Hossein	Gjinia: mashkull	Zv.Këshilltar i Parë i Gjyqësorit dhe gjyqtar i Gjykatës së Lartë (Supreme). Zv.Prokurorit i Përgjithshëm i Iranit (2007-2015). Në këtë rol, ai ishte përgjegjës për çështjet gjyqësore pas protestave paszgjedhore në 2009 të cilat u kryen në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Gjithashtu, në këtë rol, ai ka dhënë dënime tepër të ashpra për veprat penale për drogë.	10.10.2011
56.	BAHRAMI MohammadKazem	Gjinia: mashkull	Kryetar i gjykatës së drejtësisë administrative. Ka qenë bashkëpunëtor në shtypjen e demonstruesve paqësorë në 2009 si kreu i degës së gjyqësorit të forcave të armatosura.	10.10.2011
57.	HAJMOHAM-MADI Aziz (alias Aziz Hajmohammadi, Noorollah Azizmohammadi)	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1948 Gjinia: mashkull	Gjyqtar në Gjykatën Penale të Teheranit. Duke punuar për gjyqësorin që nga viti 1971, ai është i përfshirë në disa gjyqe të demonstruesve, si të Abdol-Reza Ghanbari, mësues i arrestuar në janar 2010 dhe i dënuar me vdekje për aktivitetet e tij politike.	10.10.2011
58.	BAGHERI Mohammad-Bagher	Gjinia: mashkull	Gjyqtar në Gjykatën e Lartë që nga dhjetori 2015. Ish-nënkryetar i administratës gjyqësore të provincës Khorasan Jugore, i ngarkuar me parandalimin e krimit. Përveç pranimit të tij, në qershor 2011, 140 ekzekutime për vepra kapitale midis marsit 2010 dhe marsit 2011, rreth 100 ekzekutime të tjera raportohet të kenë ndodhur në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën provincë të Khorasan Jugore pa u njoftuar qoftë familjet apo avokatët. Prandaj, ka qenë bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuuar në një numër të lartë të dënimeve me vdekje.	10.10.2011
59.	BAKHTIARI Seyyed Morteza	Vendlindja: Mashhad (Iran) Datëlindja: 1952 Gjinia: mashkull	President i Fondacionit të Ndihmës Imam Khomeini (që nga korriku 2019). Ish-zëvendës kujdestari i faltores Imam Reza. Ish Zyrtari i Tribunalit Special Klerikal. Ish Ministri i Drejtësisë nga 2009 në 2013. Gjatë kohës së tij si Ministër i Drejtësisë, kushtet e burgjeve brenda Iranit ranë shumë më poshtë se standardet e pranuara ndërkombëtare, dhe kishte keqtrajtim të gjerë ndaj të burgosurit. Për më tepër, ai luajti një rol kryesor në kërcënimin dhe ngacmimin e diasporës iraniane duke njoftuar krijimin e një gjykate speciale për t'u marrë posaçërisht me	10.10.2011

			iranianët që jetojnë jashtë vendit. Ai gjithashtu mbikëqyri një rritje të mprehtë të numrit të ekzekutimeve në Iran, duke përfshirë ekzekutime të fshehta që nuk u njoftuan nga qeveria, dhe ekzekutime për vepra të lidhura me drogën.	
60.	HOSSEINI Dr Mohammad (alias HOSSEYNI, Dr Seyyed Mohammad; Seyed, Sayyed and Sayyid)	Vendlindja: Rafsanjan, Kerman Datëlindja: 1961 Gjinia: mashkull	Këshilltar i ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe zëdhënës i YEKTA, një fraksion politik i vijës së ashpër. Ministër i i Kulturës dhe Direktivave Islamik (2009– 2013). Si ish-IRGC, ishte bashkëpunëtor në shtypjen e gazetarëve.	10.10.2011
61.	MOSLEHI Heydar (alias: MOSLEHI Heidar; MOSLEHI Haidar)	Vendlindja: Isfahan (Iran) Datëlindja: 1956 Gjinia: mashkull	Përfaqësues i Byrosë Ideologjike-Politike të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Iranit (që nga viti 2018). Ish këshilltar i Jurisprudencës Supreme në IRGC. Shef i organizatës për botime mbi rolin e klerit në luftë. Ish-Ministri i Inteligjencës (2009-2013). Nën udhëheqjen e tij, Ministria e Inteligjencës vazhdoi praktikat e ndalimit dhe persekutimit arbitrar të protestuesve dhe disidentëve. Ministria e Inteligjencës drejton Repartin 209 të Burgut Evin, ku shumë aktivistë janë mbajtur për shkak të aktiviteteve të tyre paqësore në kundërshtim me qeverinë në pushtet. Hetuesit nga Ministria e Inteligjencës i kanë nënshtruar të burgosurit në Repartin 209 të rrahjeve dhe abuzimit mendor dhe seksual.	10.10.2011
62.	ZARGHAMI Ezzatollah	Vendlindja: Dezful (Iran) Datëlindja: 22 korrik 1959 Gjinia: mashkull	Anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike dhe Këshillit të Revolucionit Kulturor. Ish Shefi i Transmetimeve të Republikës Islamike të Iranit (IRIB) deri në nëntor 2014. Gjatë mandatit të tij në IRIB, ishte përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. IRIB ka transmetuar pranime të detyruara faji prej të paraburgosurve dhe një seri "gjyqesh të montuara" në gusht 2009 dhe dhjetor 2011. Këto përbëjnë një shkelje të qartë të dispozitave ndërkombëtare për gjykimin e drejtë dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.	23.3.2012
63.	TAGHIPOUR Reza	Vendlindja: Maragheh (Iran) Datëlindja: 1957 Gjinia: mashkull	Anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike. Anëtar i Këshillit të Qytetit të Teheranit. Ish-Ministër për Informimin dhe Komunikimet (2009-2012). Si Ministër për Informimin, ishte një nga zyrtarët më të lartë të ngarkuar me censurimin dhe kontrollin e veprimtarive të internetit dhe gjithashtu të gjitha llojet e komunikimeve (në veçanti telefonat celular). Gjatë marrjes në pyetje të të paraburgosurve politikë, hetuesit përdorin të dhënat personale të të burgosurve, postën dhe komunikimet. Në disa raste pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2009 dhe gjatë demonstratave në rrugë, linjat celulare dhe mesazhet me tekst u bllokuan, edhe kanalet	23.3.2012

			televizive satelitore dhe interneti në Iran u ndërpre ose të paktën u ngadalësua.	
64.	KAZEMI Toraj	Gjinia: mashkull	Shefi i divizionit të Teheranit të Madh të Policisë Kibernetike të caktuar nga BE. Në këtë cilësi, ai shpalli një fushatë për rekrutimin e hakerëve qeveritarë në mënyrë që të arrijë kontroll më të mirë të informacionit në internet dhe të sulmojë faqet "e rrezikshme".	23.3.2012
65.	LARIJANI Sadeq	Vendlindja: Najaf (Iraq) Datëlindja: 1960 ose gusht 1961 Gjinia: mashkull	Emëruar Kryetar i Këshillit të Përshtatshmërisë më 29 Dhjetor 2018. Shef i Gjyqësorit nga viti 2009. Nga Shefi i Gjyqësorit kërkohet që të pajtohet dhe të nënshkruajë çdo kisas (ndëshkim), hodoud (krime kundër Zotit) dhe ta'zirat (krime kundër shteti) dënimi. Kjo përfshin dënime që përmbajnë dënimin me vdekje, rrahje me kamzhik dhe amputime. Në këtë drejtim, ai personalisht ka nënshkruar dënime të shumta me dënime me vdekje, duke kundërshtuar standardet ndërkombëtare, përfshirë gurëzimin, ekzekutimet me mbytje pezullimi, ekzekutimin e të miturve dhe ekzekutimet publike të tilla si ato ku të burgosurit janë varur nga urat përpara turmave të mijëra. Prandaj, ai ka kontribuar në një numër të lartë të ekzekutimeve. Ai gjithashtu ka lejuar dënime fizike si amputime dhe pikim acidi në sytë e të dënuarit. Që kur Sadeq Larijani mori detyrën, arrestimet arbitrare të të burgosurve politikë, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe pakicat janë rritur ndjeshëm. Sadeq Larijani gjithashtu mban përgjegjësi për dështimet sistematike në procesin gjyqësor iranian për të respektuar të drejtën për një gjykim të drejtë.	23.3.2012
66.	MIRHEJAZI Ali	Gjinia: mashkull	Pjesë e rrethit të ngushtë të Udhëheqësit Suprem, një nga ata që janë përgjegjës për planifikimin e shtypjes së protestave që nga viti 2009 dhe identifikohet me ata që janë përgjegjës për shtypjen e protestave.	23.3.2012
67.	SAEEDI Ali	Gjinia: mashkull	Përfaqësues i Zyrës së Direktivave për Pasdaran që nga 1995 pasi kaloi tërë karrierën e tij brenda institucionit të ushtrisë, dhe konkretisht në shërbimin e inteligjencës Pasdaran. Ky rol zyrtar e bën atë figurën kryesore në përcjelljen e urdhrave nga Zyra e Direktivave për aparatin shtypës në Pasdaran.	23.3.2012
68.	RAMIN Mohammad-Ali	Vendlindja: Dezful (Iran) Datëlindja: 1954 Gjinia: mashkull	Sekretari i Përgjithshëm i Fondacionit Botëror të Holokaustit, i themeluar në Konferencën Ndërkombëtare për Rishikimin e Vizionit Global të Holokaustit në 2006, ku Ramin ishte përgjegjës për organizimin në emër të Qeverisë iraniane. Figura kryesore përgjegjëse për censurimin si zv.Ministër i ngarkuar me shtypin deri në dhjetor 2013, duke qenë drejtpërdrejt përgjegjës për mbylljen e shumë gazetave	23.3.2012

			reformuese (Etemad, Etemad-e Melli, Shargh, etj.), mbylljen e Sindikatës së Pavarur të Shtypit dhe frikësimin apo arrestimin e gazetarëve.	
69.	MORTAZAVI Seyyed Solat	Vendlindja: Farsan, Tchar Mahal-o-Bakhtiari (Jug) – (Iran) Datëlindja: 1967 Gjinia: mashkull	Deri në nëntor 2019, Drejtor i degës së Teheranit të Fondacionit "Astan Qods Razavi". Ish kryebashkiak i qytetit të dytë më të madh të Iranit, Mashhad, ku ekzekutimet publike ndodhin rregullisht. Ish-zv.Ministër i Brendshëm për Çështjet Politike, i emëruar në 2009. Në këtë cilësi, ai ishte përgjegjës për drejtimin e shtypjes së personave që flisnin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes. Më vonë u emërua Kryetar i Komitetit Zgjedhor Iranian për zgjedhjet parlamentare në 2012 dhe për zgjedhjet presidenciale në 2013.	23.3.2012
73.	FAHRADI Ali	Gjinia: mashkull	Zv.Shef i Inspektoratit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektimit Publik të Ministrisë së Drejtësisë të Teheranit. Ish-prokuror i Karajt. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjykime në të cilat u dha dënimi me vdekje. Gjatë periudhës kur ishte prokuror, në rajonin Karaj pati një numër të lartë ekzekutimesh.	23.3.2012
74.	REZVANMA-NESH Ali	Gjinia: mashkull	Zëvendës prokuror i provincës Karaj, rajoni i Alborz. Përgjegjës për shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut dhe përfshirje në ekzekutimin e një të mituri.	23.3.2012
75.	RAMEZANI Gholamhossein	Gjinia: mashkull	Që nga viti 2011, Shefi i Inteligjencës së Ministrisë së Mbrojtjes; nga nëntori 2009 deri në mars 2011: Komandanti i Inteligjencës së Pasdaranit; nga marsi 2008 deri në nëntor 2009: zv.komandant i Inteligjencës së Pasdaranit; nga prilli 2006 deri në mars 2008: Shef i Mbrojtjes dhe Inteligjencës së Pasdaranit. I përfshirë në shtypjen e lirisë së shprehjes, lidhje me personat përgjegjës për arrestimet e blogerëve/gazetarëve në 2004, si dhe raportohet se luajti rol në shtypjen e protestave paszgjedhore në 2009.	23.3.2012
76.	SADEGHI Mohamed	Gjinia: mashkull	Kolonel dhe Zëvendës i inteligjencës teknike dhe kibernetike të IRGC-së dhe përgjegjës i qendrës së analizës dhe luftës kundër krimit të organizuar brenda Pasdaran. Përgjegjës për arrestimet dhe torturat e blogerëve / gazetarëve.	23.3.2012
77.	JAFARI Reza	Datëlindja: 1967 Gjinia: mashkull	Këshilltar në Gjykatën Disiplinore për Gjyqtarët që nga viti 2012. Anëtar i Komisionit për Përcaktimin e Përmbajtjes Penale të Internetit', një organ përgjegjës për faqet e internetit dhe censurimin e mediave sociale. Ish Shef i prokurorisë së posaçme të krimit kibernetik midis 2007 dhe 2012. Ishte përgjegjës për shtypjen e lirisë së shprehjes,	23.3.2012

			përfshirë përmes arrestimit, ndalimit dhe ndjekjes penale të blogerëve dhe gazetarëve. Personat e arrestuar nën dyshimin e krimit kibernetik u keqtrajtuan dhe iu nënshtruan një procesi të padrejtë gjyqësor.	
78.	RESHTE-AHMADI Bahram	Gjinia: mashkull	Gjyqtar i një gjykate të zakonshme të Teheranit verior. Ish-mbikëqyrës i Zyrës së Prokurorisë Publike në Teheran. Zëvendës Shef i Zyrës për Çështjet e Burgjeve të Provincës Teheran. Ish Zëvendës Prokuror në Teheran deri në 2013. Drejtoi qendrën e prokurorisë Evin. Ishte përgjegjës për mohimin e të drejtave, përfshirë vizitat dhe të drejtat e të burgosurve të tjerë, në dëm të mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe të burgosurve politikë.	23.3.2012
79.	RASHIDI AGHDAM Ali Ashraf	Gjinia: mashkull	Ish-kreu i Burgut të Evin, emëruar në mes të vitit 2012. Gjatë mandatit të tij, kushtet në burg u përkeqësuan dhe raportet e referuara keqtrajtimi i intensifikuar i të burgosurve. Në tetor 2012, nëntë të burgosura femra hynë në grevë urie në protestë për shkeljen e të drejtave të tyre dhe trajtimin e dhunshëm nga rojet e burgut.	12.3.2013
80.	KIASATI Morteza	Gjinia: mashkull	Gjyqtar i Gjykatës Revolucionare të Ahvazit, Dega 4, dha dënime me vdekje për katër të burgosur politikë arabë, Taha Heidarian, Abbas Heidarian, Abd al Rahman Heidarian (tre vëllezër) dhe Ali Sharifi. Ata u arrestuan, u torturuan dhe u varën pa procesin e duhur ligjor. Këto raste dhe mungesa e procesit të duhur ligjor u referuan në një raport të datës 13 shtator 2012 nga Raportuesi I Posaçëm i OKB-së për të drejtat e njeriut në Iran, raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Iranin, i datës 22 gusht 2012.	12.3.2013
81.	MOUSSAVI Seyed Mohammad Bagher	Gjinia: mashkull	Gjyqtar i Gjykatës Revolucionare të Ahvazit, Dega 2, dha dënime me vdekje për pesë arabë, Mohammad Ali Amouri, Hashem Sha'bani Amouri, Hadi Rashedi, Sayed Jaber Alboshoka, Sayed Mokhtar Alboshoka, më 17 mars 2012, për "veprimtari kundër sigurisë kombëtare" dhe "armiqësi ndaj Zotit". Dënimet me vdekje u mbajtën në fuqi nga Gjykata Supreme e Iranit më 9 janar 2013. Pesë personat u mbajtën nën arrest pa akuza për më shumë se një vit, u torturuan dhe u dënuan pa proces të rregullt ligjor.	12.3.2013
82.	SARAFRAZ Mohammad (Dr.) (alias Haj-agha Sarafraz)	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: rreth 1963 Vendbanimi: Teheran Gjinia: mashkull	Ish-anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike. Ish-Kryetar i Transmetimeve të Republikës Islamike të Iranit (IRIB) (2014-2016). Ish-Shef i Shërbimit Botëror të IRIB dhe Press TV, përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. I lidhur ngushtë me aparatin e sigurimit të shtetit. Nën drejtimin e tij Press TV, së bashku me IRIB, ka punuar	12.3.2013

			me shërbimet e sigurimit dhe prokurorët iranianë për të transmetuar pranime të detyruara faji të të paraburgosurve, përfshirë atë të gazetarit dhe kineastit iraniano-kanadez Maziar Bahari, në programin e përjavshëm të 'Irani Sot'. Rregullatori i pavarur i transmetimit OFCOM gjobiti Press TV në Mbretërinë e Bashkuar 100 000 GBP për transmetimin e rrëfimit të Baharit në 2011, i cili u filmua në burg ndërsa Bahari ishte në burgim të paligjshëm. Prandaj, Sarafraz identifikohet me shkeljen e të drejtës për proces të rregullt ligjor dhe gjykim të drejtë.	
83.	JAFARI Asadollah	Gjinia: mashkull	Si prokuror i Provincës Mazandaran, Jafari ka rekomanduar dhënien e dënimit me vdekje në çështjet që ka proceduar, që rezultuan në shumë ekzekutime, përfshirë ekzekutime publike dhe në rrethana ku dhënia e dënimit me vdekje është në kundërshtim me të drejtat ndërkombëtare të njeriut, përveç se ishte dënim joproporcional dhe i tepërt. Jafari ka qenë gjithashtu përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe shkelje të të drejtave të të arrestuarve Bahái nga arrestimi fillestar deri në mbajtjen e tyre në izolim në Qendrën e Paraburgimit të Inteligjencës.	12.3.2013
84.	EMADI Hamid Reza (alias Hamid-reza Emadi)	Vendlindja: Hamedan Datëlindja: rreth 1973 Vendbanimi: Teheran Vendi i punës: Press TV, selia qendrore, Teheran Gjinia: mashkull	Drejtori informacioni i Press TV. Ish-kryeproducent i Press TV. Përgjegjës për prodhimin dhe transmetimin e pranimeve të detyruara të fajit nga të arrestuarit përfshirë gazetarë, aktivistë politikë dhe persona që u përkasin pakicave kurde dhe arabe, duke shkelur të drejtat e njohura ndërkombëtarisht për një gjykim të drejtë dhe proces të rregullt ligjor. Rregullatori i pavarur i transmetimit OFCOM gjobiti Press TV në Mbretërinë e Bashkuar 100 000 GBP për transmetimin e pranimit të detyruar të fajit nga gazetari iraniano-kanadez dhe kineastit Maziar Bahari në 2011, i cili u filmua në burg ndërsa Bahari ishte në burgim të paligjshëm. OJF-të kanë raportuar raste të tjera pranimi të detyruar faji në televizor nga Press TV. Prandaj, Emadi identifikohet me shkeljen e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe gjykim të drejtë.	12.3.2013
85.	HAMLBAR Rahim	Gjinia: mashkull	Gjyqtar i Degës 1 të Gjykatës Revolucionare të Tabrizit. Përgjegjës për dënime të rënda kundër pakicës etnike azere dhe aktivistëve të të drejtave të punëtorëve, duke i akuzuar ata për spiunim, veprime kundër sigurisë kombëtare, propagandë kundër regjimit iranian dhe fyerje të liderit të Iranit. Një rast i profilit të lartë përfshinte 20 punonjës vullnetarë të ndihmës ndaj tërmetit (pas një tërmeti në Iran në gusht 2012) të cilëve ai u dhanë dënime me burg për përpjekjet e tyre për të ndihmuar viktimat e tërmetit. Gjykata i shpalli punëtorët fajtorë për 'bashkëpunim në tubime dhe për të kryer krime kundër sigurisë kombëtare'.	12.3.2013

86.	MUSAVI-TABAR Seyyed Reza	Gjinia: mashkull	Ish-kryetar i Prokurorisë Revolucionare të Shirazit. Përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe keqtrajtim të aktivistëve politikë, gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, Baháíve dhe të burgosurve të ndërgjegjes, të cilët u intimiduan, u torturuan, u morën në pyetje dhe iu mohua e drejta për avokat dhe procesi i rregullt ligjor. Musavi-Tabar nënshkroi urdhra gjyqësorë në burgun famëkeq nr. 100 (për burra), përfshirë urdhrin për ta mbajtur të burgosurën Bahai Raha Sabet për tre vjet në izolim.	12.3.2013
87.	KHORAMABADI Abdolsamad	Kryetar i "Komisionit për Përcaktimin e Përmbajtjes Kriminale". Gjinia: mashkull	Zv.Drejtor për Mbikëqyrjen Gjyqësore (që nga 13 tetori 2018). Ish kreu i 'Komisionit për Përcaktimin e Përmbajtjes Kriminale', një organizatë qeveritare e ngarkuar me censurimin e internetit dhe me krimin kibernetik. Nën udhëheqjen e tij, Komisioni e përkufizoi 'krimin kibernetik 'me disa kategori të paqarta që kriminalizojnë krijimin dhe publikimin e përmbajtjes që konsiderohet e papërshtatshme nga regjimi. Ai është përgjegjës për shtypjen dhe bllokimin e faqeve të shumta të opozitës, gazetave elektronike, blogeve, faqeve të OJF-ve të të drejtave të njeriut dhe Google dhe Gmail që nga shtatori 2012. Ai dhe Komisioni kontribuan në mënyrë aktive në vdekjen në paraburgim të blogerit Sattar Beheshti në nëntor 2012. Kështu, Komisioni që ai drejton është drejtpërdrejt përgjegjës për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut, në veçanti duke ndaluar dhe filtruar faqet e internetit për publikun e gjerë dhe duke bllokuar herëpashere hyrjen në internet.	12.3.2013

VENDIME

VENDIMI ZBATUES I KËSHILLIT 2021/585/PPJS
i datës 12 prill 2021
që zbaton Vendimin 2011/235/PPJS për masat kufizuese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 31(2) të tij,

Duke pasur parasysh Vendimin e Këshillit 2011/235/PPJS të datës 12 prill 2011 për masat kufizuese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran([1]) dhe në veçanti nenin 31(1) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/PPJS.

2) Më 8 dhjetor 2019, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë nxori një deklaratë në emër të BE-së ku dënon përdorimin e përhapur dhe joproporcional të forcës nga forcat e sigurisë iraniane, që rezultoi në numër të lartë vdekjesh dhe plagosjesh gjatë përgjigjes ndaj demonstratave të nëntorit 2019. Deklarata theksonte edhe se BE-ja pret që të gjithë përgjegjësit e dhunës të japin llogari dhe i bënte thirrje autoriteteve iraniane të garantojnë hetime transparente dhe të besueshme për të sqaruar numrin e vdekjeve dhe të arrestuarve, si edhe t'u siguronte proces të rregullt gjyqësor të gjithë të ndaluarve. Për më tepër, si reagim ndaj vendimit të Iranit për të hequr aksesin në internet për rrjetet globale për më shumë se një javë, duke penguar komunikimin dhe qarkullimin e lirë të informacionit për qytetarët iranianë, deklarata theksonte se të drejtat themelore, si liria e shprehjes dhe e tubimit, duhet të respektohen gjithmonë.

3) Në këtë kontekst dhe në pajtim me përkushtimin e BE-së për të adresuar të gjitha çështjet shqetësuese me Iranin, përfshirë situatën e të drejtave të njeriut, tetë persona dhe tetë subjekte duhet të përfshihen në listën e personave dhe subjekteve që iu nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS.

4) Shtojca e Vendimit 2011/235/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit 2011/235/PPJS ndryshohet siç përcaktohet në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian;*

Miratuar në Bruksel, më 12 prill 2021.

Për Këshillin
Presidenti
A. P. ZACARIAS

---

[1] GZ L 100, 14.4.2011, f. 51.

SHTOJCA

Personat dhe subjektet më poshtë shtohen në listën e personave dhe subjekteve të përcaktuar në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS:

Personat

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"88.	SOLEIMANI Gholamreza	Vendlindja: Farsan (Iran) Datëlindja: 1343 (kalendari iranian Hijri), 1964 ose 1965 (kalendari gregorian) Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Pozicioni: Kryetar i Basij Organizata e Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC)	Gholamreza Soleimani është kryetar i Organizatës Basij. Kjo organizatë përdori forcë vdekjeprurëse për të shtypur protestat e nëntorit 2019 në Iran, duke vrarë dhe plagosur protestues të paarmatosur dhe civilë të tjerë në shumë qytete në mbarë vendin. Si kryetar i Organizatës Basij, Gholamreza Soleimani mban përgjegjësi për shtypjen e dhunshme të protestave dhe dhunimin e rëndë të të drejtave të njeriut në Iran.	12.4.2021
89.	SALAMI Hossein (alias SALAMI Hussain)	Vendlindja: Vaneshan, Golpayegan (Iran) Datëlindja: 1339 (Kalendari iranian Hijri) 1960 ose 1961 (Kalendari gregorian) Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Pozicioni: Komandant i Përgjithshëm i Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) Rangu: Gjeneral-Major	Hossein Salami ka qenë Komandant i Përgjithshëm i IRGC-së që nga prilli 2019, që përfshin milicinë Basij, si dhe është anëtar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Forcat e rregullta të IRGC-së dhe milicia Basij përdorën forcë vdekjeprurëse për të shtypur protestat e nëntorit 2019 në Iran, duke vrarë dhe plagosur protestues të paarmatosur dhe civilë të tjerë në shumë qytete në mbarë vendin. Si anëtar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Hossein Salami mori pjesë në mbledhjet që rezultuan në urdhra për përdorimin e forcës vdekjeprurëse për shtypjen e protestave të nëntorit 2019. Prandaj, Hossein Salami mban përgjegjësi për dhunimin e rëndë të të drejtave të njeriut në Iran.	12.4.2021
90.	KARAMI Hassan	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Pozicioni: Komandant i Njësive Speciale të Policisë Iraniane	Hassan Karami është komandant i Njësive Speciale të Policisë Iraniane. Njësitë Speciale përdorën forcë vdekjeprurëse për të shtypur protesat e nëntorit 2019 në Iran, duke vrarë dhe plagosur protestues të paarmatosur dhe civilë të tjerë në shumë qytete në mbarë vendin. Si komandant i Njësive Speciale që kanë shkaktuar vrasjet dhe plagosjet e protestuesve të paarmatosur dhe civilëve të tjerë, Hassan Karami mban përgjegjësi për dhunimin e rëndë të të drejtave të njeriut në Iran.	12.4.2021

91.	PAKPOUR Mohammad (alias PAKPUR Mohammad)	Vendlindja: Arak (Iran) Datëlindja: 1340 (kalendari iranian hijri), 1961 (kalendari gregorian) Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Pozicioni: Komandant i Përgjithshëm i Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), Forcat Tokësore Rangu: Gjeneral Brigade	Mohammad Pakpour ka qenë komandant i përgjithshëm i Forcave Tokësore të IRGC-së që në mars 2010. Forcat Tokësore të IRGC-së përdorën forcë vdekjeprurëse për të shtypur protesat e nëntorit 2019 në Iran, duke vrarë dhe plagosur protestues të paarmatosur dhe civilë të tjerë në shumë qytete në mbarë vendin. Si komandant i përgjithshëm i Forcave Tokësore të IRGC-së që kanë shkaktuar vrasjet dhe plagosjet e protestuesve të paarmatosur dhe civilëve të tjerë, Mohammad Pakpour mban përgjegjësi për dhunimin e rëndë të të drejtave të njeriut në Iran.	12.4.2021
92.	ASHTARI Hossein	Vendlindja: Isfahan (alias Esfahan, Ispahan) Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Pozicioni: Komandant i Përgjithshëm i Policisë Iraniane	Hossein Ashtari ka qenë komandant i përgjithshëm i Policisë Iraniane që në mars 2015 dhe është anëtar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Policia përfshin njësitë Emdad dhe njësitë speciale. Forcat e zakonshme policore, njësitë Emdad dhe njësitë speciale, përdorën forcë vdekjeprurëse për të shtypur protesat e nëntorit 2019 në Iran, duke vrarë dhe plagosur protestues të paarmatosur dhe civilë të tjerë në shumë qytete në mbarë vendin. Si anëtar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Hossein Ashtari mori pjesë në mbledhjet që rezultuan në urdhrat për të përdorur forcë vdekjeprurëse për shtypjen e protestave të nëntorit 2019. Prandaj, Hossein mban përgjegjësi për dhunimin e rëndë të të drejtave të njeriut në Iran.	12.4.2021
93.	ZIAEI Gholamreza	Gjinia: mashkull Pozicioni: ish-Drejtor i burgut Evin; ish-drejtor i qendrave të tjera të paraburgimit	Midis korrikut 2019 dhe qershorit 2020, Gholamreza Ziaei ishte drejtor i burgut Evin, ku kushtet e vështira për të burgosurit u përkeqësuan më tej gjatë mandatit të tij. Të burgosurave femra iu refuzohej kontakti telefonik me fëmijët e tyre. Të burgosurve politikë iu mohuan vizitat javore nga të afërmit, të cilat lejoheshin vetëm çdo dy muaj. Gjatë protestave të vitit 2009, Ziaei drejtonte Qendrën e Paraburgimit në Kahrizak, ku të paktën pesë të paraburgosur që ishin ndaluar lidhur me protestat masive në rrugët e Teheranit në 2009, vdiqën pasi u torturuan. Nga 2017 në 2019, para se të merrte drejtimin e burgut Evin në Teheran, Ziaei ishte drejtor i burgut Rajaee Shahr në Karaj, në perëndim të Teheranit, ku ka pasur protesta të shumta nga të burgosurit politikë ndaj abuzimeve dhe kushteve çnjerëzore të jetesës.	12.4.2021
94.	SHAHVARPOUR Hassan	Vendlindja: Safi Abad, jugu i Dezful, Khuzestan (Iran) Gjinia: mashkull	Si komandant i IRGC-së në Khuzestan që në vitin 2009, Hassan Shahvarpour mban përgjegjësi sepse urdhëroi forcat që përdorën mitraloza ndaj protestuesve dhe civilëve të tjerë në qytetin Mahshahr gjatë protestave të nëntorit 2019. Nën komandën e tij, 148 persona u vranë nga IRGC-ja që i qëlloi me mitraloza të rëndë	12.4.2021

		Numri i pasaportës: 2001624001 (numri i letërnjoftimit kombëtar) Pozicioni: Trupat e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), Komandant i trupave Vali Asr të provincës Khuzestan Rangu: Gjeneral Brigade	nga blindat që rrethuan protestuesit që po fshiheshin në kënetat aty pranë.	
95.	VASEGHI Leyla (alias VASEQI Layla, VASEGHI Leila, VASEGHI Layla)	Vendlindja: Sari, Mazandaran Province (Iran) Datëlindja 1352 (kalendari iranian hijri), 1972 or 1973 (kalendari gregorian) Gjinia: femër Pozicioni: Guvernatore e Shahr-e Qods dhe kryetare i Këshillit të Sigurisë së Qytetit	Si guvernator e Shahr-e Qods dhe kryetare e Këshillit të Sigurisë së Qytetit që nga shtatori 2019, Leyla Vaseghi urdhëroi policinë dhe forcat e tjera të armatosura që të përdorin mjete vdekjeprurëse gjatë protestave të nëntorit 2019 duke vrarë dhe plagosur protestuesit e paarmatosur dhe civilë të tjerë. Si guvernatore e Shahr-e Qods dhe kryetare e Këshillit të Sigurisë së Qytetit, Leyla Vaseghi mban përgjegjësi për dhunimin e rëndë të të drejtave të njeriut në Iran.	12.4.2021

Subjektet

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"2.	Burgu Evin	Adresa: Provinca Teheran, Teheran, Distrikti 2, Dasht-e Behesht (Iran)	Burgu Evin është një qendër burgimi ku mbaheshin të burgosurit politikë dhe abuzimi me të drejtat e njeriut dhe torturat kanë ndodhur vazhdimisht në vitet dhe dekadat e fundit. Protestuesit e nëntorit 2019 janë burgosur dhe ende disa mbahen në burgun Evin si të burgosur politikë. Të burgosurit atje privohen nga të drejtat procedurale bazë dhe ndonjëherë mbahen në izolim apo në qeli të mbipopulluara me kushte higjienike të këqija. Ekzistojnë raporte të detajuara për tortura fizike dhe psikologjike. Të burgosurve u ndalohet kontakti me familjarët dhe avokatët, si edhe privohen nga trajtimi shëndetësor adekuat.	12.4.2021
3.	Burgu Fashafouyeh (alias Burgu Qendror i Teheranit, Burgu Hasanabad-e Qom)	Adresa: Provinca Teheran, Hasanabad, Zona Industriale Bijin, Teheran, Rruga e Vjetër Qom (Iran) Telefon: +98 21 5625 8050	Burgu Fashafouyeh është qendër burgimi e ideuar fillimisht për krimet lidhur me drogën, por së fundmi mbahen edhe të burgosur politike; madje, këta të fundit në disa raste detyrohen të ndajnë qelinë me persona të varur nga droga. Kushtet e jetesës dhe higjienike janë shumë të këqija, mungojnë nevojat bazë si uji i pijshëm i pastër. Gjatë protestave të nëntorit 2019, disa protestues u burgosën në Burgun Fashafouyeh, përfshirë disa të mitur. Raportet tregojnë se protestuesit e nëntorit 2019 i janë nënshtruar torturave dhe trajnimit çnjerëzor në Burgun Fashafouyeh, p.sh. duke i dëmtuar qëllimisht me ujë të vluar dhe mohimit të trajtimit mjekësor. Sipas raportit të *Amnesty*	12.4.2021

			International për shtypjen e protestave të nëntorit 2019, adoleshentë të vegjël deri 15 vjeç janë burgosur me të rriturit në Burgun Fashafouyeh. Tre protestues të nëntorit 2019 që po mbahen në Burgun Fashafouyeh janë dënuar me vdekje nga një gjykatë në Teheran.	
4.	Burgu Rajaee Shahr (alias Burgu Rajai, Rajaishahr, Raja'i Shahr, Reja'i Shahr, Rajayi Shahr, Burgu Gorhardasht, Burgu Gohar Dasht)	Adresa: Provinca Alborz, Karaj, Gohardasht, Blvd Moazzen (Iran) Telefon: +98 26 3448 9826	Burgu Rajaee Shahr njihet për mohimin e të drejtave të njeriut, përfshirë torturat e rënda fizike dhe psikologjike të të burgosurve politikë dhe të burgosurve të ndërgjegjes, si edhe ekzekutimet masive pa gjykim të drejtë, që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979. Qindra të burgosur, përfshirë fëmijë, janë keqtrajtuar rëndë në Burgun Rajaee Shahr pas protestave të nëntorit 2019. Raporte të besueshme tregojnë për raste të shumta torture dhe formave të tjera të ndëshkimit mizor, përfshirë këtu edhe të miturit.	12.4.2021"

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2021/595

i datës 12 prill 2021

që ndryshon Vendimin 2011/7235/PPJS për masat kufizuese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/PPJS([1]).

2) Mbi bazën e rishikimit të Vendimit 2011/235/CFSP, Këshilli vlerëson se masat kufizuese të përcaktuara aty duhet të ripërtërihen deri më 13 prill 2022.

3) Një person i përfshirë në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS ka ndërruar jetë, prandaj emri i tij duhet të hiqet nga Shtojca. Këshilli vlerëson edhe se emrat e 34 personave dhe një subjekti të përfshirë në Shtojcën e Vendimit 2011/235/PPJS duhet të përditësohen.

4) Vendimi 2011/235/PPJS duhet të ndryshohet rrjedhimisht.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/235/PPJS ndryshohet si vijon:

(1) Në nenin 6, pika 2 zëvendësohet me fjalinë më poshtë:
"2. Ky Vendim zbatohet deri më 13 prill 2022 dhe rishikohet në mënyrë konstante. Vendimi ripërtërihet ose ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivi i tij nuk është përmbushur".

(2) shtojca ndryshohet siç përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian;*

Miratuar në Bruksel, më 12 prill 2021.

Për Këshillin
Presidenti
A. P. ZACARIAS

---

[1] Vendimi i Këshillit 2011/235/PPJS i datës 12 prill 2011 për masat kufizuese ndaj personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (GZ) L 100, 14.4.2011, f. 51).

SHTOJCA

Shtojca e Vendimit 2011/235/PPJS ("Lista e personave dhe subjekteve të përcaktuara në nenet 1 dhe 2) ndryshohet si vijon:

(1) emërtimi 16 (për HADDAD Hassan (alias Hassan ZAREH DEHNAVI) në listën me titull "Personat" fshihet.
(2) emërtimet për 34 persona dhe një subjekt zëvendësohen si më poshtë:

A. Personat

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	AHMADI-MOQADDAM Esmail	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1961 Gjinia: mashkull	Ish-Këshilltar i Lartë për Çështjet e Sigurisë pranë Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shefi i Policisë Kombëtare të Iranit në periudhën 2005 deri në fillim të 2015. Gjithashtu, Shef i Policisë Kibernetike Iraniane (listuar) nga janar 2011 deri në fillim të 2015. Forcat nën komandën e tij ndërmorën sulme mizore ndaj protestuesve paqësore dhe sulm të dhunshëm në konviktet e Universitetit të Teheranit gjatë natës më 15 qershor 2009. Ish-Shef i Shtabit të Iranit në mbështetje të popullit jemenas.	12.4.2011
4.	ZLI Ali	Gjinia: Mashkull Titulli: Gjeneral Brigade	Ish-Shef i Kolegjit Imam Hossein Cadet (2018-qershor 2020). Ish-Zv.Komandant i Basij (2009-2018), Shef i Trupave Seyyed al-Shohada të Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC-së), në Provincën e Teheranit (deri në shkurt 2010). Trupa Seyyed al-Shohada është përgjegjëse për sigurinë në provincën e Teheranit dhe ka luajtur rol kryesor në shtypjen mizore të protestuesve në 2009.	12.4.2011
8.	MOTLAGH Bahram Hosseini	Gjinia: Mashkull	Anëtar i stafit mësimdhënës të Universitetit Imam Hossein (Gardianët e Revolucionit). Ish-Shef i Komandës së Ushtrisë dhe Kolegjit të Shtabit të Përgjithshëm (DAFOOS). Ish-Shef i Trupave Seyyed al-Shohada të Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC-së), në Provincën e Teheranit (deri në shkurt 2010). Trupa Seyyed al-Shohada ka luajtur rol kryesor në organizimin e shtypjes së protestave në 2009.	12.4.2011
11.	RAJABZADEH Azizollah	Gjinia: Mashkull	Komandant i Shtabit të Rendit Urban që nga viti 2014. Ish-Kreu i Organizatës së Teheranit për Zbutjen e Fatkeqësive (2010-2013). Si Shef i Policisë së Teheranit deri në janar 2010, ishte përgjegjës për sulmet e dhunshme të policisë ndaj protestuesve dhe studentëve. Si Komandant i Forcave Ligjzbatuese në Teheranin e Madh, ishte i akuzuari me gradën më të lartë në çështjen e abuzimeve në Qendrën e Paraburgimit Kahrizak në dhjetor 2009.	12.4.2011

15.	DORRI-NADJAFABADI Ghorban-Ali	Vendlindja: Najafabad (Iran) Datëlindja: 3.12.1950 Gjinia: Mashkull	Anëtar i Asamblesë së Ekspertëve dhe përfaqësues i Udhëheqësit Suprem në Provincën Markazi ('Qendror') dhe Kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative. Prokuror i Përgjithshëm i Iranit deri në shtator 2009, si dhe ish-Ministër i Inteligjencës nën presidencën e Khatamit. Si Prokuror i Përgjithshëm i Iranit, ka urdhëruar dhe mbikëqyrur gjyqet e montuara publike pas protestave të para paszgjedhore, ku të akuzuarve iu mohuan të drejtat për të pasur avokat.	12.4.2011
19.	JAFARI-DOLATABADI Abbas	Vendlindja: Yazd (Iran) Datëlindja: 1953 Gjinia: Mashkull	Këshilltar i Gjykatës së Lartë Disiplinore së gjyqtarëve që në 29 prill 2019. Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit (gusht 2009-prill 2019). Zyra e Dolatabadit akuzoi një numër të madh protestuesish, përfshirë individë që morën pjesë në protestat e Ditës së Ashures në dhjetor 2009. Ka urdhëruar mbylljen e zyrës së Karroubi -t në shtator 2009 dhe arrestimin e disa politikanëve reformistë si dhe ka ndaluar dy parti politike reformiste në qershor 2010. Zyra e tij akuzoi protestuesit për 'Moharebeh', ose 'armiqësi ndaj Zotit', e cila mbart dënim me vdekje, dhe i mohoi procesin e rregullt ligjor të akuzuarve për dënim me vdekje. Gjithashtu, zyra pati në objektiv dhe arrestoi reformistët, aktivistët për të drejtat e njeriut dhe anëtarët e medias, si pjesë e një goditje të gjerë ndaj opozitës politike. Në tetor 2018, ai njoftoi në media se katër aktivistë mjedisorë iranianë të arrestuar do të akuzoheshin për 'mbjellje korrupsioni në tokë', akuzë kjo që mbart dënim me vdekje.	12.4.2011
21.	MOHSENI-EJEI Gholam-Hossein	Vendlindja: Ejiyeh (Iran) Datëlindja: rreth 1956 Gjinia: Mashkull	Anëtar i Këshillit të Përshtatshmërisë. Prokuror i Përgjithshëm i Iranit nga shtator 2009 deri në vitin 2014. Ish-Zv. Kryetar dhe Zëdhënës për Shtyp i Gjyqësorit. Ish-Ministër i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009. Kur ishte Ministër i Inteligjencës gjatë zgjedhjeve të vitit 2009, agjentët e inteligjencës nën komandën e tij ishin përgjegjës për ndalimin, torturimin dhe nxjerrjen e rrëfimeve të rreme nën presionin e qindra aktivistëve, gazetarëve, disidentëve dhe politikanëve reformistë. Gjithashtu, figurat politike u detyruan të jepnin rrëfime të rreme gjatë marrjes së padurueshme në pyetje, ku përfshiheshin tortura, abuzime, shantazhe dhe kërcënime ndaj familjarëve.	12.4.2011
22.	MORTAZAVI Said	Vendlindja: Meybod, Yazd (Iran) Datëlindja: 1967 Gjinia: Mashkull	Shef i Sistemit të Mirëqenies në periudhën 2011 deri 2013. Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit deri në gusht 2009. Si Prokuror i Përgjithshëm i Teheranit, ka lëshuar urdhër të përgjithshëm të përdorur për ndalimin e qindra aktivistëve, gazetarëve dhe studentëve. Në janar 2010, një hetim parlamentar e konsideroi përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për ndalimin e tre të burgosurve që vdiqën më pas në paraburgim. U pezullua nga detyra në gusht 2010 pas një hetimi të drejtësisë iraniane për rolin e tij në vdekjen e tre personave të ndaluar me urdhër të tij pas zgjedhjeve.	12.4.2011

			Në nëntor 2014, roli i tij në vdekjet e të arrestuarve u njoh zyrtarisht nga autoritetet iraniane. U shpall i pafajshëm nga Gjykata Iraniane në 19 gusht 2015, nga akuzat lidhur me torturën dhe vdekjen e tre të rinjve në qendrën e paraburgimit të Kahrizak në 2009. Është dënuar me burg në 2017 dhe liruar në shtator 2019.	
27.	ZARGAR Ahmad	Gjinia: Mashkull	Gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe Shef i Gjykatës Revolucionare të Teheranit. Kryetar i 'Organizatës për Ruajtjen e Moralit'. Ish-gjyqtar pranë Degës së 2-të të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin Ekonomik. Ish-gjyqtar, Gjykata e Apelit në Teheran, Dega 36. Konfirmoi urdhër-burgimet afatgjata dhe urdhër-vdekjet kundër protestuesve.	12.4.2011
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmoud	Gjinia: Mashkull	Deputet që në shkurt 2020. Ish-këshilltar i Këshillit të Lartë të Iranit për të Drejtat e Njeriut (deri në vitin 2019). Ish-sekretar i Këshillit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Ish-guvernator i Provincës Ilam. Ish-drejtor politik në Ministrinë e Brendshme. Si Kryetar i Komisionit të Nenit 10 të Ligjit për Veprimtaritë e Partive dhe Grupeve Politike, ishte përgjegjës për autorizimin e demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike dhe regjistrimin e partive politike. Në vitin 2010, pezulloi aktivitetet e dy partive politike reformiste të lidhura me Mousavin - Frontin e Pjesëmarrjes në Iranin Islamik dhe Organizatën e Muxhahedinë të Revolucionit Islamik. Nga viti 2009 e më tej, ka ndaluar vazhdimisht të gjitha tubimet joqeveritare, duke mohuar kështu një të drejtë kushtetuese për të protestuar dhe duke çuar në shumë arrestime të demonstruesve paqësorë në kundërshtim me të drejtën për lirinë e tubimit. Në 2009, gjithashtu i mohoi opozitës lejen për ceremoninë e zisë për personat që u vranë në protestat për zgjedhjet presidenciale.	10.10.2011
34.	AKBARSHAHI Ali-Reza	Gjinia: Mashkull	Ish-Drejtor i Përgjithshëm i Seksionit të Kontrollit të Drogës në Iran (alias Seksioni i Anti-Narkotikëve). Ish-Komandant i Policisë së Teheranit. Nën udhëheqjen e tij, forca policore ishte përgjegjëse për përdorimin e forcës jashtëgjyqësore ndaj të dyshuarve gjatë arrestimit dhe paraburgimit. Policia e Teheranit ishte gjithashtu e implikuar në bastisjet në konviktet e universitetit të Teheranit në qershor 2009 kur, sipas një komisioni Majlis të Iranit, më shumë se 100 studentë u plagosën nga policia dhe Basij. Shef i policisë hekurudhore deri në vitin 2018.	10.10.2011
36.	AVAEE Seyyed Ali-Reza (alias AVAEE Seyyed Alireza, AVAIE Alireza)	Vendlindja: Dezful (Iran) Datëlindja: 20.5.1956 Gjinia: Mashkull	Ministër i Drejtësisë. Ish-drejtor i zyrës të hetimeve të posaçme. Zv.Ministër i Brendshëm dhe Kryetar i Regjistrit Publik deri në korrik 2016. Këshilltar pranë Gjykatës Disiplinore për Gjyqtarët që nga prilli 2014. Ish-Kryetar i Gjyqësorit	10.10.2011

			të Teheranit. Si Kryetar i Gjyqësorit të Teheranit, ka qenë përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut, arrestime arbitrare, mohim i të drejtave të të burgosurve si dhe një numër të lartë ekzekutimesh.	
39.	GANJI Mostafa Barzegar	Gjinia: Mashkull	Drejtor i Përgjithshëm i Mbikëqyrjes së Inspektimit dhe Vlerësimit të Performancës së Gjykatave që në qershor 2020. Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Qomit (2008-2017) dhe ish-Shef i Drejtorisë së Përgjithshme për burgjet. Përgjegjës për paraburgimin arbitrar dhe keqtrajtimin e dhjetëra shkelësve në Qom. Ka qenë bashkëpunëtor në një shkelje të rëndë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në dhënien e tepruar dhe në rritje të dënimit me vdekje dhe rritjen e lartë të ekzekutimeve në 2009/2010.	10.10.2011
40.	HABIBI Mohammad Reza	Gjinia: Mashkull	Kryetar i Drejtësisë së Isfahanit. Ish-Prokuror i Përgjithshëm i Isfahanit. Ish-Kryetar i Zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd. Ish- zv.Prokuror i Isfahanit. Bashkëpunëtor në procedura që mohojnë gjykimin e drejtë të të pandehurve – si psh. Abdollah Fathi, ekzekutuar në maj 2011 pasi e drejta për t'u dëgjuar dhe problemet me shëndetin mendor u injoruan nga Habibi gjatë gjykimit të tij në mars 2010. Kështu, ishte bashkëpunëtor në shkelje të rëndë të të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në një rritje të lartë të ekzekutimeve në vitin 2011.	10.10.2011
41.	HEJAZI Mohammad	Vendlindja: Ispahan (Iran) Datëlindja: 1956 Gjinia: Mashkull	Zv.Komandant i Forcës Quds të Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) që nga viti 2020 si rezultat i riorganizimit të zinxhirit të saj komandues pas vrasjes së gjeneralit Qasem Soleimani. Si Gjeneral i IRGC-së, ka luajtur rol kryesor në intimidimin dhe kërcënimin e "armiqve" të Iranit. Ish-Shef i Trupave Sarollah të IRGC-së në Teheran dhe ish-Shef i Forcave Basij, luajti rol qendror në shtypjen pas-zgjedhore të protestuesve në vitin 2009.	10.10.2011
44.	JAZAYERI Massoud	Gjinia: Mashkull Titulli: Gjeneral Brigade	Këshilltar Kulturor i Shefit të Përbashkët të Shtabit të Forcave të Armatosura të Iranit që në prill 2018. Në shtabin e përbashkët ushtarak të Forcave të Armatosura të Iranit, Gjeneral Brigade Massoud Jazayeri ishte Zv.Shef i Shtabit për çështjet kulturore dhe mediatike (alias Sektori i Publikimit i Mbrojtjes së Shtetit). Si Zv.Shef i Shtabit, bashkëpunoi në mënyrë aktive në shtypjen e protestave të vitit 2009. Në një intervistë në Kayhan, paralajmëroi se shumë protestues brenda dhe jashtë Iranit ishin identifikuar dhe do të trajtoheshin në kohën e duhur. Ka bërë thirrje të hapur për shtypjen e masmediave të huaja dhe opozitës iraniane. Në vitin 2010, i kërkoi qeverisë që të miratojë ligje më të ashpra kundër iranianëve që bashkëpunonin me burime të huaja mediatike.	10.10.2011

45.	JOKAR Mohammad Saleh	Vendlindja: Yazd (Iran) Datëlindja: 1957 Gjinia: Mashkull	Deputet për Provincën e Yazd. Ish-Zv. për Çështjet Parlamentare të Gardave Revolucionare. Në periudhën 2011 deri 2016, deputet parlamentar për Provincën e Yazd dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme. Ish-Komandant i Forcave Studentore të Basijt. Në këtë rol, ishte i përfshirë në mënyrë aktive në shtypjen e protestave dhe indoktrinimin e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim të shtypjes së vazhdueshme të fjalës së lirë dhe disidencës. Si Anëtar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme, mbështeti publikisht shtypjen e opozitës ndaj qeverisë.	10.10.2011
46.	KAMALIAN Behrouz (alias Hackers Brain, Behrooz_Ice)	Vendlindja: Teheran (Iran) Datëlindja: 1983 Gjinia: Mashkull	Kreu i grupit kibernetik 'Ashiyaneh' i lidhur me regjimin iranian. Siguria Dixhitale 'Ashiyaneh', themeluar nga Behrouz Kamalian, është përgjegjëse për sulme të shumta kibernetike si ndaj kundërshtarëve vendas, ashtu edhe ndaj reformatorëve dhe institucioneve të huaja. Puna e organizatës 'Ashiyaneh' e Kamalianit ka ndihmuar në rrëzimin e regjimit kundër opozitës, e cila ka përfshirë shkelje të shumta të rënda të të drejtave të njeriut në vitin 2009. Grupi kibernetik Kamalian dhe 'Ashiyaneh' kanë vazhduar aktivitetet e tyre deri të paktën në janar 2020.	10.10.2011
47.	KHALILOLLAHI Moussa (alias KHALILOLLAHI Mousa, ELAHI Mousa Khalil)	Vendlindja: Tabriz (Iran) Datëlindja: 1963 Gjinia: Mashkull	Prokuror në Tabriz gjatë periudhës 2010 deri 2019. I përfshirë në çështjen e Sakineh Mohammadi-Ashtiani dhe bashkëpunëtor në shkeljet e rënda të së drejtës për proces të rregullt ligjor.	10.10.2011
48.	MAHSOULI Sadeq (alias MAHSULI Sadeq)	Vendlindja: Oroumieh (Iran) Datëlindja: 1959/1960 Gjinia: Mashkull	Zv.Sekretar i Përgjithshëm i Frontit Paydari (Fronti i Stabilitetit Islam). Ish-këshilltar i Ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad, ish-anëtar i Këshillit të Përshtatshmërisë dhe ish-Zv.Shef i Frontit të Rezistencës. Ministër i Mirëqenies dhe Sigurimeve Shoqërore gjatë 2009-2011. Ministër i Brendshëm deri në gusht 2009. Si Ministër i Brendshëm, Mahsouli kishte autoritet mbi të gjitha forcat e policisë, agjentët e sigurimit të ministrisë së brendshme dhe agjentët civilë. Forcat nën drejtimin e tij ishin përgjegjëse për sulmet ndaj konvikteve të Universitetit të Teheranit më 14 qershor 2009 dhe torturat e studentëve në bodrumin e Ministrisë (bodrumi famëkeq i nivelit 4). Shumë protestues të tjerë janë keqtrajtuar rëndë në Qendrën e Paraburgimit Kahrizak që drejtohej nga policia nën kontrollin e Mahsoulit.	10.10.2011
53.	TALA Hossein (alias TALA Hosseyn)	Vendlindja: Tehran (Iran) Datëlindja: 1969 Gjinia: Mashkull	Kryebashkiak i Eslamshahr. Ish-deputet iranian. Ish-Guvernator i Përgjithshëm ('Farmandar') i Provincës së Teheranit deri në shtator 2010; ishte përgjegjës për ndërhyrjen e forcave të policisë dhe rrjedhimisht për shtypjen e demonstratave. Mori çmim në dhjetor 2010 për rolin e tij në shtypjen e protestave paszgjedhore.	10.10.2011
54.	TAMADDON Morteza (alias TAMADON Morteza)	Vendlindja: Shahr Kord-Isfahan (Iran)	Ish-Kryetar i Këshillit Provincial të Sigurisë Publike në Teheran. Ish-Guvernator i Përgjithshëm i IRGC-së në Provincën e Teheranit. Në cilësinë e	10.10.2011

		Datëlindja: 1959 Gjinia: Mashkull	tij si guvernator dhe kryetar i Këshillit të Sigurisë Publike provinciale të Teheranit, mbante përgjegjësi të përgjithshme për të gjitha aktivitetet shtypëse të ndërmarra nga IRGC në provincën e Teheranit, përfshirë shtypjen e protestave politike që nga qershori 2009. Aktualisht anëtar i bordit në Universitetin e Teknologjisë "Nasireddin Tusi".	
60.	HOSSEINI Dr Mohammad (alias HOSSEYNI Dr Seyyed Mohammad; Seyed, Sayyed and Sayyid)	Vendlindja: Rafsanjan, Kerman (Iran) Datëlindja: 23.7.1961 Gjinia: mashkull	Këshilltar i ish-Presidentit Mahmoud Ahmadinejad dhe zëdhënës i YEKTA, një fraksion politik i vijës së ashpër. Ministër i i Kulturës dhe Direktivave Islamike (2009– 2013). Si ish-IRGC, ishte bashkëpunëtor në shtypjen e gazetarëve.	10.10.2011
63.	TAGHIPOUR Reza	Vendlindja: Maragheh (Iran) Datëlindja: 1957 Gjinia: Mashkull	Anëtar i parlamentit të 11-të iranian (elektoratit të Teheranit). Anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike. Ish-Anëtar i Këshillit të Qytetit të Teheranit. Ish-Ministër për Informimin dhe Komunikimet (2009-2012). Si Ministër për Informimin, ishte një nga zyrtarët më të lartë të ngarkuar me censurimin dhe kontrollin e veprimtarive të internetit si dhe të gjitha llojeve të komunikimeve (në veçanti telefonat celulare). Gjatë marrjes në pyetje të të paraburgosurve politikë, hetuesit përdorin të dhënat personale të të burgosurve, postën dhe komunikimet. Në disa raste pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2009 dhe gjatë demonstratave në rrugë, linjat celulare dhe mesazhet me tekst u bllokuan, edhe kanalet televizive satelitore dhe interneti në Iran u ndërpre ose të paktën u ngadalësua.	23.3.2012
65.	LARIJANI Sadeq	Vendlindja: Najaf (Irak) Datëlindja: 1960 ose gusht 1961 Gjinia: Mashkull	Emëruar Kryetar i Këshillit të Përshtatshmërisë më 29 dhjetor 2018. Ish-Kryetar i Gjyqësorit (2009-2019); në këtë cilësi, kërkohet që të pajtohet dhe të nënshkruajë çdo *kisas* (ndëshkim), *hodoud* (krim kundër Zotit) dhe *ta'zirat* (krime kundër shteti). Kjo përfshin dënime që përmbajnë dënimin me vdekje, rrahje me kamxhik dhe amputime. Në këtë drejtim, ai personalisht ka nënshkruar dënime të shumta me vdekje, në shkelje të standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë vrasjen me gurë, ekzekutimet me varje, ekzekutimin e të miturve dhe ekzekutimet publike të tilla si ato ku të burgosurit janë varur nga urat përpara turmave me mijëra persona. Prandaj, ka kontribuar në një numër të lartë ekzekutimesh. Gjithashtu, ka lejuar ndëshkime fizike si amputime dhe hedhje acidi me pika në sytë e të dënuarit. Që kur Sadeq Larijani mori detyrën, u rritën ndjeshëm arrestimet arbitrare të të burgosurve politikë, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe pakicave. Sadeq Larijani gjithashtu mban përgjegjësi për mosrespektimin sistematik të të drejtës për gjykim të drejtë nga autoritetet gjyqësore iraniane.	23.3.2012

66.	MIRHEJAZI Ali	Gjinia: Mashkull	Pjesë e rrethit të ngushtë të Udhëheqësit Suprem, një nga ata që janë përgjegjës për planifikimin e shtypjes së protestave që nga viti 2009 dhe identifikohet me ata që janë përgjegjës për shtypjen e protestave. Gjithashtu, ishte përgjegjës për planifikimin e shtypjes së trazirave publike në dhjetor 2017/2018 dhe nëntor 2019.	23.3.2012
67.	SAEEDI Ali	Gjinia: Mashkull	Shef i zyrës së ideologjisë politike të Udhëheqësit Suprem. Ish-Përfaqësues i Udhëheqësit Suprem për Pasdaran (1995-2020) pasi kaloi tërë karrierën e tij në institucionin e ushtrisë, dhe konkretisht në shërbimin e inteligjencës pasdaran. Ky rol zyrtar e bën atë figurën kryesore në përcjelljen e urdhrave nga Zyra e Udhëheqësit Suprem për aparatin shtypës në Pasdaran.	23.3.2012
69.	MORTAZAVI Seyyed Solat	Vendlindja: Farsan, Tchar Mahal-o-Bakhtiari (Jug) – (Iran) Datëlindja: 1967 Gjinia: Mashkull	Që në 16 shtator 2019, kreu i degës së pasurive të patundshme të Fondacionit Mostazafan, i drejtuar drejtpërdrejt nga Udhëheqësi Suprem Khamenei. Deri në nëntor 2019, Drejtor i degës së Teheranit të Fondacionit "Astan Qods Razavi". Ish kryebashkiak i qytetit të dytë më të madh të Iranit, Mashhad, ku ekzekutimet publike ndodhin rregullisht. Ish-zv.Ministër i Brendshëm për Çështjet Politike, i emëruar në 2009. Në këtë cilësi, ishte përgjegjës për drejtimin e shtypjes së personave që flisnin në mbrojtje të të drejtave të tyre legjitime, përfshirë lirinë e shprehjes. Më vonë u emërua Kryetar i Komisionit Zgjedhor Iranian për zgjedhjet parlamentare në 2012 dhe për zgjedhjet presidenciale në 2013.	23.3.2012
73.	FARHADI Ali	Gjinia: Mashkull	Zv.Shef i Inspektoratit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektimit Publik të Ministrisë së Drejtësisë të Teheranit. Ish-prokuror i Karajt. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjykime në të cilat u dha dënimi me vdekje. Gjatë periudhës kur ishte prokuror, në rajonin Karaj pati një numër të lartë ekzekutimesh.	23.3.2012
79.	RASHIDI AGHDAM Ali Ashraf	Gjinia: Mashkull	Ish-drejtori i burgut Evin (2012-2015). Gjatë mandatit të tij, kushtet në burg u përkeqësuan dhe raportet referuan keqtrajtim të intensifikuar të të burgosurve. Në tetor 2012, nëntë të burgosura femra hynë në grevë urie në protestë për shkeljen e të drejtave të tyre dhe trajtimin e dhunshëm nga rojet e burgut.	12.3.2013
82.	SARAFRAZ Mohammad (Dr.) (alias Haj-agha Sarafraz)	Vendlindja: Tehran (Iran) Datëlindja: rreth 1963 Vendbanimi: Tehran Gjinia: Mashkull	Ish-anëtar i Këshillit Suprem të Hapësirës Kibernetike. Ish-Kryetar i Transmetimeve të Republikës Islamike të Iranit (IRIB) (2014-2016). Ish-Shef i Shërbimit Botëror të IRIB dhe Press TV, përgjegjës për të gjitha vendimet e programimit. I lidhur ngushtë me aparatin e sigurimit të shtetit. Nën drejtimin e tij Press TV, së bashku me IRIB, ka punuar me shërbimet e sigurimit dhe prokurorët iranianë për të transmetuar pranime të detyruara faji të të	12.3.2013

			paraburgosurve, përfshirë atë të gazetarit dhe kineastit iraniano-kanadez Maziar Bahari, në programin e përjavshëm të 'Irani Sot'. Rregullatori i pavarur i transmetimit OFCOM gjobiti Press TV në Mbretërinë e Bashkuar 100 000 GBP për transmetimin e rrëfimit të Baharit në 2011, i cili u filmua në burg ndërsa Bahari ishte në burgim të paligjshëm. Prandaj, Sarafraz identifikohet me shkeljen e të drejtës për proces të rregullt ligjor dhe gjykim të drejtë.	
84.	EMADI Hamid Reza (alias Hamidreza Emadi)	Vendlindja: Hamedan (Iran) Datëlindja: rreth 1973 Vendbanimi: Teheran Vendi i punës: Press TV, selia qendrore, Teheran Gjinia: Mashkull	Drejtori informacioni i Press TV. Ish-kryeproducent i Press TV. Përgjegjës për prodhimin dhe transmetimin e pranimeve të detyruara të fajit nga të arrestuarit përfshirë gazetarë, aktivistë politikë dhe persona që u përkasin pakicave kurde dhe arabe, duke shkelur të drejtat e njohura ndërkombëtarisht për një gjykim të drejtë dhe proces të rregullt ligjor. Rregullatori i pavarur i transmetimit OFCOM gjobiti Press TV në Mbretërinë e Bashkuar 100 000 GBP për transmetimin e pranimit të detyruar të fajit nga gazetari iraniano-kanadez dhe kineastit Maziar Bahari në 2011, i cili u filmua në burg ndërsa Bahari ishte në burgim të paligjshëm. OJF-të kanë raportuar raste të tjera pranimi të detyruar faji në televizor nga Press TV. Prandaj, Emadi identifikohet me shkeljen e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe gjykim të drejtë.	12.3.2013
86.	MUSAVI-TABAR Seyyed Reza	Vendlindja: Jahrom (Iran) Datëlindja: 1964 Gjinia: Mashkull	Ish-kryetar i Prokurorisë Revolucionare të Shirazit. Përgjegjës për arrestime të paligjshme dhe keqtrajtim të aktivistëve politikë, gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, Baháíve dhe të burgosurve të ndërgjegjes, të cilët u intimiduan, u torturuan, u morën në pyetje dhe iu mohua e drejta për avokat dhe procesi i rregullt ligjor. Musavi-Tabar nënshkroi urdhra gjyqësorë në burgun famëkeq nr 100 (për burra), përfshirë urdhrin për ta mbajtur të burgosurën Bahai Raha Sabet për tre vjet në izolim.	12.3.2013
87.	KHORAMABADI Abdolsamad	Gjinia: Mashkull	Zv.Drejtor për Mbikëqyrjen Gjyqësore (që nga 13 tetori 2018). Ish kreu i 'Komisionit për Përcaktimin e Përmbajtjes Kriminale', një organizatë qeveritare e ngarkuar me censurimin e internetit dhe me krimin kibernetik. Nën udhëheqjen e tij, Komisioni e përkufizoi 'krimin kibernetik 'me disa kategori të paqarta që kriminalizojnë krijimin dhe publikimin e përmbajtjes që konsiderohet e papërshtatshme nga regjimi. Është përgjegjës për shtypjen dhe bllokimin e faqeve të shumta të opozitës, gazetave elektronike, blogeve, faqeve të OJF-ve të të drejtave të njeriut dhe Google dhe Gmail që nga shtatori 2012. Ai dhe Komisioni kontribuan në mënyrë aktive në vdekjen në paraburgim të blogerit Sattar Beheshti në nëntor 2012. Kështu, Komisioni që ai drejton është drejtpërdrejt përgjegjës për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut, në veçanti duke ndaluar dhe filtruar faqet e internetit për publikun e gjerë dhe duke bllokuar herëpashere hyrjen në internet.	12.3.2013

B. Subjektet

	Emri	Informacioni identifikues	Arsyet	Data e listimit
"1.	Policia Kibernetike	Vendndodhja: Teheran (Iran) Faqja e internetit: http://www.cyberpolice.ir	Policia Kibernetike iraniane e themeluar në janar 2011, është njësi e Policisë së Republikës Islamike të Iranit, e drejtuar nga Vahid Majid. Nga krijimi deri në fillim të vitit 2015, kryesohej nga Esmail Ahmadi-Moqaddam (i listuar). Ahmadi-Moqaddam theksoi se Policia Kibernetike do të ndiqte grupe antirevolucionare dhe disidente që përdorën rrjete sociale të internetit në 2009 për të nxitur protesta kundër rizgjedhjes së presidentit Mahmoud Ahmadinejad. Në janar 2012, Policia Kibernetike lëshoi udhëzime të reja për internet-kafetë, duke u kërkuar përdoruesve të japin informacione personale që do të mbaheshin nga pronarët e kafeneve për gjashtë muaj, si dhe listën e faqeve të internetit që kanë vizituar. Rregullat kërkojnë edhe që pronarët e kafeneve të instalojnë kamera televizive me qark të mbyllur dhe të mbajnë regjistrimet për gjashtë muaj. Këto rregulla të reja mund të krijojnë një regjistër që autoritetet ta përdorin për të gjurmuar aktivistët ose këdo që cilësohet kërcënim për sigurinë kombëtare. Në qershor 2012, media iraniane njoftoi se Policia Kibernetike do të mbyllte rrjetet private virtuale (VPN). Më 30 tetor 2012, Policia Kibernetike arrestoi blogerin Sattar Beheshti pa mandat për 'veprime kundër sigurisë kombëtare në rrjetet sociale dhe Facebook'. Beheshti kishte kritikuar qeverinë iraniane në blogun e tij. Beheshti u gjet i vdekur në qelinë e burgut më 3 nëntor 2012 dhe besohet se është torturuar për vdekje nga autoritetet e Policisë Kibernetike. Policia Kibernetike është përgjegjëse për shumë arrestime të Administratorëve të Grupit Telegram në lidhje me protestat mbarëkombëtare të nëntorit 2019.	12.3.2013'